

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

**BRAKTISJA E SHKOLLIMIT  
NË ARSIMIN E MESËM  
PROFESIONAL NË KOSOVË**

Prishtinë 2011

*Instituti Pedagogjik i Kosovës*

**Botues**

**INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS**

*Ekipi hulumtues:*

- 1. Mr.Sc.Hajrije Devetaku - Gojani*
- 2. M.Sc. Selim Mehmeti*
- 3. M.Sc. Ismet Potera*
- 4. Haxhere Zylfiu*
- 5. Binak Gerguri*
- 6. Luljeta Shala*

**BRAKTISJA E SHKOLLIMIT NË ARSIMIN E MESËM  
PROFESIONAL NË KOSOVË**

**HULUMTIM**

**Janar, 2011  
Prishtinë**

Përgatitjen për botim e bëri ekipi hulumtues i IPK-së.

### ***Falënderim***

*Falënderojmë Fondacionin Evropian për Trajnime (ETF) për përkrahje në ngritjen e kapaciteteve të hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës, përkrahje e cila rezultoi me realizimin e hulumtimit për dukurinë e braktisjes së shkollimit në shkollat profesionale të Kosovës. Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të falënderojmë znj. Lida Kita dhe z. Borhen Chakrou, të cilët vlerësuan mundësitë dhe kapacitetet e IPK-së për hulumtimin e një dukurie kaq të ndjeshme, siç është braktisja e shkollimit.*

*Po ashtu, në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të falënderojmë znj. Froukje Wartenbergh për ofrimin e ekspertizës gjatë procesit të hulumtimit dhe gjatë përpunimit të të dhënave.*

*Ky hulumtim nuk do të mund të realizohej me sukses pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e drejtorëve të shkollave, mësimitdhënësve, nxënësve dhe të zyrtarëve arsimorë të përfshirë në këtë hulumtim. Me këtë rast, shprehim falënderim për të gjithë ata që e përkrahën dhe e mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij hulumtimi.*

**P ë r m b a j t j a**

Shkurtesat e përdorura .....	7
Tabelat dhe figurat .....	8
Përmbledhje .....	10
Summary .....	13
Hyrje .....	15
Ideja për hulumtim.....	15
Objekti dhe qëllimi i hulumtimit.....	16
Realizimi i hulumtimit.....	17
Pastrimi i të dhënave/kontrolli i kualitetit.....	20
Përkufizimi i nocionit braktisje.....	22
Përmbledhje e shkurtër e raportit.....	23
Hulumtimi kabinetik.....	25
Statistikat për braktisjen.....	25
Analiza e masave politike për parandalimin e braktisjes.....	35
Përkrahja e donatorëve për parandalimin e braktisjes.....	38
Gjetjet nga hulumtimet tjera.....	40
Të dhënat hyrëse për nxënës dhe mësimdhënës të përfshirë në hulumtim	44
Nxënësit.....	44
Mësimdhënësit.....	47
Shkalla e kënaqësisë së nxënësve dhe mësimdhënësve me shkollën .....	51
Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me përzgjedhjen e shkollës dhe profilin arsimor.....	51
Shkalla e kënaqësisë me aspekte të procesit mësimor.....	54
Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me raportet me mësimdhënës.....	56
Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me procesin e vlerësimit të arritjeve .....	57
Shkalla e kënaqësisë së mësimdhënësve me procesin mësimor.....	58
Mësimdhënia dhe stilet e mësimdhënies.....	60
Pritjet e nxënësve.....	60
Afërsia e mësimdhënësve me nxënës.....	62
Alternativat e komunikimit .....	63
Mënyrat e menaxhimit të detyrave të shtëpisë.....	64
Bashkëpunimi me prindër .....	65
Treguesit e braktisjes .....	68
Informata nga komuna dhe administrata e shkollës .....	68
Treguesit e braktisjes sipas nxënësve.....	70
Shpeshësia e ikjes së nxënësve nga orët mësimore .....	70

Arsyet e ikjes nga orët e mësimimit .....	71
Masat edukative dhe disiplinore ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit	73
Numri i nxënësve që e kanë braktisur në klasën e 10 (2009/2010) dhe arsyet e braktisjes - sipas nxënësve të klasës.....	74
Veprimet e ndërmarra nga shkolla kundër braktisjes.....	76
Çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore? .....	77
Treguesit e braktisjes sipas mësimdhënësve .....	78
Identifikimi i nxënësve potencialë për braktisje të shkollës.....	78
Diskutimi i pasojave të braktisjes .....	79
Arsyet e braktisjes sipas mësimdhënësve.....	80
Sa shpesh mësimdhënësit mbajnë takime për parandalimin e braktisjes dhe çka diskutojnë në takime? .....	81
Parashikimi dhe parandalimi i braktisjes .....	83
Cilët nxënës janë më së shumti në rrezik për ta braktisur shkollën.....	83
Cilat stile të mësimdhënies e rrisin rrezikun për braktisje? .....	87
Çka bëjnë shkollat për parandalimin e braktisjes?.....	89
Përfundime dhe rekomandime .....	91
Vlerësimi i hulumtimit .....	92
Gjetjet më të rëndësishme nga hulumtimi.....	94
Përfundime .....	99
Rekomandime .....	100
Hulumtimet në të ardhmen në fushën e parandalimit të braktisjes.....	101
Referencat.....	103

## Shkurtesat e përdorura në raport

<b>AAPK</b>	Arsimi dhe Aftësimi Profesional në Kosovë
<b>CESES</b>	Qendra Evropiane për Shkollë, Edukim dhe Shoqëri
<b>DACUM</b>	Developing a Curriculum- Zhvillimi i Kurrikulit
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>DANIDA</b>	Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>ETF</b>	Fondacionin Evropian për Trajnime
<b>GTZ</b>	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>KEC</b>	Qendra për Arsim e Kosovës
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin
<b>PPPA</b>	Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim
<b>RAE</b>	Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian
<b>SWISS CONTACT</b>	Fondacioni Zvicëran për Bashkëpunim Teknik
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UNESKO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UNICEF</b>	Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara

## Tabelat dhe figurat

Tabela 1.1:	Shkollat e përfshira në hulumtim dhe numri i nxënësve
Tabela 2.1:	Numri i nxënësve 2005/2006 – 2008/2009 që e kanë mbaruar klasën e 9-të dhe numri i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të
Tabela 2.2:	Raporti gjinor i nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010)
Tabela 2.3:	Shkalla e (mos) përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të - viti shkollor 2009/2010
Tabela 2.4:	Shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 11-të në klasën e 12-të - viti shkollor 2009/2010
Tabela 2.5:	Klasa e 13-të (2009/2010) - shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të
Tabela 2.6:	Klasa 13 (2009/2010) - shkalla e mospërfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të
Tabela 2.7:	Raporti gjinor i përfshirjes së nxënësve në klasën e 11-të, 2009/2010 - në shkallë vendi
Tabela 2.8:	Raporti gjinor i përfshirjes së nxënësve në klasën e 11-të, 2009/2010 - në shkollat e përfshira në hulumtim
Tabela 2.9:	Pasqyra e braktisjes në arsimin e mesëm të lartë – klasa e 11-të, 12-të dhe 13-të
Tabela 3.1:	Profilët arsimore të nxënësve të përfshirë në hulumtim, numri i nxënësve /përqindja
Tabela 3.2:	Mosha dhe gjinia e nxënësve të përfshirë në hulumtim
Tabela 3.3:	Shkalla e arsimimit dhe e punësimit të prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim
Tabela 3.4:	Distanca e udhëtimit të nxënësve për në shkollë
Tabela 3.5:	Gjinia, mosha dhe kualifikimi i mësimitdhënësve
Tabela 3.6:	Përvoja e punës dhe mosha e mësimitdhënësve
Tabela 3.7:	Gjinia, mosha dhe kualifikimi i mësimitdhënësve
Tabela 4.1:	Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës dhe profilin arsimor
Tabela 4.2:	Shkallës e kënaqësisë së nxënësve me profilin dhe shkollën në raport me mënyrën e zgjedhjes
Tabela 4.3:	Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të lidhura me procesin mësimor
Tabela 4.4:	Shkalla e vlerësimit të nxënësve për raportet e tyre me mësimitdhënës
Tabela 4.5:	Aspektet e lidhura me vlerësimin dhe shkalla e kënaqësisë së nxënësve
Tabela 4.6:	Aspektet e lidhura me procesin mësimor dhe shkalla e kënaqësisë së mësimitdhënësve
Tabela 5.1:	Pritjet e nxënësve nga shkolla dhe mësimitdhënës
Tabela 5.1:	Pritjet e nxënësve nga shkolla - që kanë deklaruar se asnjëherë nuk ikin nga orët e mësimit
Tabela 5.2:	Vlerësimi i mësimitdhënësve për aspektet dhe shkallën e afërsisë së tyre me nxënës
Tabela 5.3:	Mënyrat e menaxhimit të detyrave të shtëpisë
Tabela 5.4:	Format e bashkëpunimit të mësimitdhënësve me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës
Tabela 6.1:	Suksesi pozitiv i nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë

Tabela 6.2: Suksesi i pamjaftueshëm i nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë

Tabela 6.3: Mungesat e nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë

Tabela 6.4: Shpeshhtësia e ikjes së nxënësve nga orët mësimore

Tabela 6.5: Arsyet e ikjes nga orët e mësimimit - sipas nxënësve

Tabela 6.6: Ndërlidhja e shpeshhtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes

Tabela 6.7: Shpeshhtësia e marrjes së masave ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit

Tabela 6.8: Opinioni i nxënësve për arsyet e braktisjes së shkollës nga nxënësit e klasës së tyre

Tabela 6.9: Opinioni i nxënësve për atë se çfarë ka bërë shkolla për parandalimin e braktisjes

Tabela 6.10: Çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore.

Tabela 6.11: Treguesit në bazë, sipas të cilëve mësimdhënësit i kanë identifikuar nxënësit potencialë për të braktisur shkollën

Tabela 6.12: Shpeshhtësia e diskutimit të mësimdhënësve me nxënës për pasojat e braktisjes

Tabela 6.13: Opinioni i mësimdhënësve për arsyet e braktisjes së shkollës

Tabela 6.14: Shpeshhtësia e takimeve të mësimdhënësve me kolegë/mësimdhënës në funksion të parandalimit të braktisjes

Tabela 6.15: Temat e takimeve të mësimdhënësve për parandalimin e braktisjes dhe shpeshhtësia e takimeve

Tabela 7.1: Ndërlidhja e përgjigjeve të nxënësve që vlerësojnë raportet me mësimdhënës me deklaratimet e tyre për atë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore.

Figura 2.1: Përqindjet dhe numrin e nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 10-të nga viti 2006/2007 deri në vitin 2009/2010

Figura 2.2: Raporti i (mos) përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të - 2009/2010

Figura 2.3: Shkalla e përqindjes së nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 11-të dhe të 12-të

Figura 2.4: Pasqyra e braktisjes në arsimin profesional- klasat 11-ta, 12-ta dhe 13-ta

Figura 5.2: Shpeshhtësia e përdorimit të mënyrave alternative të komunikimit me nxënës që kanë problem në mësim

Figura 5.2: Bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindër

Figura 7.1: Ndërlidhja e përgjigjeve të nxënësve që i vlerësojnë raportet me mësimdhënës, me deklaratimet e tyre për atë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore.

## 1. Përmbledhje

Ideja për hulumtimin dhe trajtimin e dukurisë së braktisjes së shkollës nga nxënësit e shkollave profesionale ishte pjesë e programit të punës së IPK-së dhe fatmirësisht gjeti përkrahjen për realizim nga ETF-i në funksion të ngritjes së kapaciteteve të Institutit Pedagogjik të Kosovës në fushën e hulumtimeve.

Një hulumtim i bërë në Kosovë, dhe i mbështetur nga ana e MASHT-it, përfshin vetëm nivelin e shkollimit të detyrueshëm. Treguesit e dalë nga ky hulumtim merren me rezervë nga ana e hulumtuesve të IPK-së, sidomos mungesa e të dhënave zyrtare për braktisjen e shkollimit dhe mungesa e konsultimit të dokumentacionit përkatës për trajtimin e kësaj dukurie.

Përcaktimi për të trajtuar dukurinë e braktisjes në klasat e 10-ta në arsimin profesional u bë duke shqyrtuar burime të ndryshme, sidomos statistikat e MASHT-it dhe të komunave për dukurinë e regjistrimit të nxënësve në këto klasa dhe për mosvijueshmërinë apo ndërprerjen e shkollimit në këtë fazë të shkollimit.

Në bashkëpunim të plotë me ETF-in dhe IPK-në, u formua grupi hulumtues i përbërë prej 6 hulumtuesve të IPK-së, i cili hartoi projektin dhe planin për zbatimin e tij.

Ekipi u dakordua për mostrën dhe për metodologjinë e hulumtimit. Procesi i realizimit të hulumtimit kaloi nëpër faza të zakonshme të një hulumtimi. Për mostër përzgjedhëm nxënësit e klasave të 10-ta, në pesë shkolla profesionale, në katër komuna të Kosovës. Pjesën e dytë të mostrës e përbëjnë kujdestarët e klasave dhe mësimdhënësit që realizojnë mësim në ato klasa dhe në klasa të tjera të shkollave të përfshira në hulumtim. Indeksit e paraleleve e përcaktuam sipas parimit për të gjitha shkollat indeksi i njëjtë.

Krahas përcaktimit të metodologjisë hulumtuese, hartuam edhe instrumentin kryesor për hulumtim. U përcaktuam për dy pyetësorë, për të dy shtresat e mostrës. Pas pilotimit të pyetësorit caktuam kalendarin e hulumtimit në terren, si dhe kalendarin e përpunimit të të dhënave, detyrimet e anëtarëve të ekipit, si dhe monitorimin e secilës fazë të hulumtimit dhe të përpunimit të të dhënave dhe hartimit të raportit final për hulumtimin.

Ekipi i formuar për hulumtim funksionoi mirë, ndërsa ndihma e ekspertëve të angazhuar nga ETF-i ofroi mbështetje profesionale, sidomos në pastrimin e të dhënave dhe në përpunimin statistikor të rezultateve të grumbulluara.

Hipoteza jonë se klasa e 10-të është specifike dhe se ekziston shkallë e lartë e braktisjes në këtë klasë, me theks të veçantë në shkollat profesionale, doli e saktë. Puna më me përkushtim e ekipit hulumtues ishte hartimi i strukturës dhe përmbajtjes së instrumentit për hulumtim. Gjetja e faktorëve të braktisjes shpesh nuk mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, prandaj në raste të caktuara duhej kërkuar në mënyrë të tërthortë.

Nga hulumtimi del se edhe faktori mësimdhënës është njëri ndër faktorët i cili ndikon në rritjen e shkallës së braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve. Kjo shihet nga përqindja e lartë e nxënësve të cilët kanë kërkesa tjetërfare, si për mësimdhënie ashtu edhe për komunikim më të hapur me mësuesit e tyre. Mungesa e mbështetjes dhe e inkurajimit të nxënësve për tejkalimin e problemeve dhe sfidave në mjedisin e ri social në klasën e 10-të mund të jetë njëra ndër arsyt ose shkaktarët që nxënësi të braktisë shkollimin dhe të kërkojë mbështetje e përkrahje në rrugë të tjera.

Kjo shihet edhe në deklaratat e mësimdhënësve për shkallën dhe cilësinë e bashkëpunimit me prindër dhe me kolegët e tjerë në funksion të parandalimit, por edhe për identifikimin e nxënësve potencialë ose në rrezik për të braktisur shkollimin.

Problemin e braktisjes, si në prezantimin statistikor ashtu edhe në atë narrativ, e kemi trajtuar në të gjitha aspektet e përmendura, duke bazuar në strukturën e instrumentit hulumtues të zbatuar për grumbullimin e të dhënave relevante për objektin e hulumtimit.

Përpunimin statistikor e kemi bërë duke shfrytëzuar format më të lexueshme dhe më reprezentuese të të dhënave. Hulumtimi është bërë për qëllime praktike, të gjetjes së prezencës së braktisjes dhe gjetjes së shkaqeve më reprezentuese që kanë ndikuar në braktisjen e shkollimit. Gjetja dhe përpunimi statistikor i këtyre dy elementeve të braktisjes do të jetë me rëndësi si për politikëbërësit e arsimit, për shkollat, nxënësit dhe prindërit. Por, sidoqoftë, parandalimi dhe kthimi i atyre që e kanë braktisur shkollimin ka vlerë individuale dhe shoqërore. Besojmë se leximi si duhet i të dhënave të dala nga ky hulumtim do të ofrojë ndihmesë për të gjitha palët e interesuara për zbutjen e problemit të braktisjes së shkollimit.

Bazuar në trajtimin një nga një të aspekteve të kërkuara me pyetësorë dhe në rezultatet e gjetjeve nga përpunimi statistikor i të dhënave, kemi nxjerr dhe propozuar rekomandime dhe përfundime për institucionet relevante.

Gjithashtu, duke i shqyrtuar gjetjet më reprezentuese nga hulumtimi, gjykojmë se këto janë një bazë e mirë për të vazhduar hulumtimin edhe të aspekteve të tjera të shkaqeve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e klasës së 10-të në arsimin profesional. Pra, hulumtimi i kësaj natyre, gjetja e shkaqeve të braktisjes së shkollimit në këtë nivel dhe analiza e tyre, paraqesin një bazë të mirë për hulumtimin e kësaj dukurie edhe në klasa dhe në nivele të tjera të shkollimit në Kosovë.

## 1. Summary

The idea of researching dropout in vocational schools was part of KPI's work plan and thankfully support was found from ETF for putting this idea into practice as part of the capacity building for research at the Kosovo Pedagogical Institute.

Research done in Kosovo by MEST included only the compulsory levels of schooling. The findings from this research were viewed with some reservations by the KPI's researchers, particularly in the absence of official data on dropout and in the absence of consultation of the relevant documentation dealing with this issue.

The decision to deal with the issue of dropout in year 10 of vocational education was taken with reference to a variety of sources, in particular the statistics of MEST and municipalities on the issue of pupil registration in year 10 and on absence or dropout from school in this phase.

In full collaboration with ETF and KPI, a research group was formed, made up of 6 KPI researchers, who planned the project and its phases of implementation. The team agreed on the research sample as well as on the research methodology. The research process went through the phases common to research. We selected pupils from year 10 as a sample from five vocational schools in four municipalities. The second part of the sample was made up of teachers who either taught the pupils in the sample or were their class tutors. We selected the classes on the same principle in all schools.

Alongside the work to specify the research methodology, we also drafted the main instrument for the research. We decided on two questionnaires for the two parts of the sample. After piloting the questionnaire we set a schedule for the fieldwork and for data processing, the roles of team members and the monitoring of each phase of the research and the data processing, as well as drafting the final research report.

The research team worked well, and we were helped enormously by experts commissioned by ETF, especially in data cleaning and the statistical processing of the results once gathered.

Our hypothesis that year 10 was special and that there was a high level of dropout in this year group, particularly in vocational school, turned out to be accurate.

The most demanding part of the research team's work was drafting the structure of the research instrument. It was often the case that it was not

possible to find the factors for school dropout by direct means, so there were cases when more roundabout ways were required.

One of the research findings was that teachers are one of the factors that may have an impact on the level of pupil dropout. This was evident from the high percentage of pupils who were asking for other forms of teaching as well as for more open communication with their teachers. It may be that a lack of support or encouragement for pupils in overcoming problems and challenges in the new social context of year 10 might be one of the reasons or causes for dropping out of school and asking for support of other kinds.

This can also be seen in the statements made by teachers on the level of quality of collaboration with parents and with other colleagues in preventing - or even identifying pupils at risk of - dropout.

We dealt with all aspects of the problems with the statistical and narrative presentation of dropout, and based on the structure of the research instrument used for the collection of data relevant to the research objective.

We processed the statistics using the most readable and easily represented forms of the data. The research was carried out with the practical aim of identifying the presence of school dropout and finding the most representative causes impacting on school dropout. Identifying and processing the statistics for these two elements of dropout will be important both for education policy-makers and for schools, pupils and parents. Nevertheless, prevention and the return to school of those who have dropped out has significance for the individual and for society. We believe that an appropriate reading of the data resulting from this research will offer help to all stakeholders in mitigating the problem of school dropout.

As well as dealing with one of the aspects about which responses were sought in the questionnaire, and the results of the findings from the statistical processing of the data, we also made some recommendations and drew some conclusions for the relevant institutions.

Reviewing the most representative findings of the research, we also judged that these represent a good base for continuing research of a range of aspects of the causes of school dropout among pupils in year 10 in vocational education. Similarly, research of this kind – the finding and analysis of the reasons for school dropout at this level - represents a good basis for researching this issue in other year groups and at other levels of schooling in Kosovo.



## I. Hyrje

Instituti Pedagogjik i Kosovës, pas përfundimit me sukses të hulumtimeve të para nga fushën e Arsimit Parauniversitar në Kosovë dhe publikimit të tyre në “Kërkime Pedagogjike - përmbledhje punimesh”<sup>1</sup>, vazhdon me projekte të tjera hulumtuese. Braktisja e shkollimit në arsimin profesional është projekt hulumtues i realizuar në bashkëpunim me Fondacionin Evropian për Trajnime (ETF), në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale të hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Dukuria e braktisjes së shkollimit në arsimin e mesëm profesional është shumë e shprehur. Kjo është një ndër çështjet mjaft të ndjeshme shoqërore dhe individuale si dhe mjaft shqetësuese në Kosovë, por edhe në vendet e tjera, megjithëse shkaqet e braktisjes ndryshojnë nga vendi në vend. Verifikimi i shkaqeve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e shkollave profesionale të Kosovës ka qenë arsyeja kryesore për realizimin e këtij hulumtimi, me qëllim të dhënies së ndihmës për orientimin e politikave dhe të aktiviteteve që janë në funksion të parandalimit të kësaj dukurie, të dëmshme për individin dhe shoqërinë.

### 1.1. Ideja për hulumtim

Arsimi dhe Aftësimi Profesional në Kosovë ( AAPK) është pjesë e arsimit të mesëm të lartë, në kuadër të të cilit janë të përfshira drejtime të ndryshme të arsimit dhe aftësimin profesional. Menaxhimi i arsimit profesional në Kosovë bëhet në mbështetje të Ligjit për Arsimin Profesional (Nr.02/L-42 prill 2006) dhe ligjeve të tjera që ndërlidhen me Arsimin Parauniversitar në Kosovë. Përveç mbështetjes ligjore, AAPK-ja ka ofruar mbështetje edhe në hartimin e strategjisë dhe të dokumenteve të tjera relevante që ndihmojnë zhvillimin e AP-së, si dhe harmonizimin e tij me standardet e Bashkimit Evropian, si Strategjia Kombëtare për Arsim dhe Aftësim për Ndërmarrësi, Standardet për Kualifikime në Mësimin e Ndërmarrësisë, Zbatimi i Deklaratës së Kopenhagës në Kosovë dhe Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2007-2017.

<sup>1</sup> Botimi i Institutit Pedagogjik të Kosovës “Kërkime Pedagogjike – përmbledhje punimesh” Prishtinë, 2010, përmbledh 21 punime të llojeve të ndryshme, hulumtime dhe analiza profesionale të hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Struktura e AAPK-së ndahet në tri nivele të kualifikimit. Niveli i parë përfshin klasën e 10-të dhe klasën e 11-të dhe ofron kualifikim bazik, duke mundësuar përfshirje në tregun e punës si punëtor gjysmë i kualifikuar. Niveli i dytë përfshin nivelin e parë (klasat 10 dhe 11) dhe klasën e 12-të dhe ofron përfshirje në tregun e punës si punëtor i kualifikuar. Niveli i tretë përfshin dy nivelet e para dhe klasën e 13-të. Nxënësit që marrin nivelin e tretë, përveç mundësisë për punësim, sigurojnë të drejtën për studime universitare dhe për shkollim në shkallën IV, shkallë e cila siguron kualifikimin për titullin Teknik. Arsimi profesional përfshin mbi 56% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë. Aktualisht, arsimi i mesëm i lartë në Kosovë nuk është i obligueshëm, mirëpo vazhdimisht bëhen përpjekje për përfshirjen sa më të madhe të nxënësve në këtë nivel të shkollimit. Përkundrajt përfshirjes më të madhe të nxënësve në klasën e 10-të, statistikave të arsimit në Kosovë tregojnë për një përfshirje a kalim të nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të, si dhe në klasat vijuese. Në Kosovë mungojnë hulumtimet për braktisjen e shkollimit për këtë nivel të arsimit, veçmas për arsimin profesional. Mbi bazën e këtyre arsyeve, Instituti Pedagogjik i Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me ETF-in, ndërmori iniciativën për hulumtimin e braktisjes së shkollimit në arsimin profesional, me fokus nga nxënësit e klasës së 10-të të shkollave profesionale të Kosovës, sepse kjo është klasë e fillimit të nivelit të ri të shkollimit dhe nxënësit vijnë nga nivele të ndryshme sociale etj. Hulumtimi i përgjigjet aktualitetit, veçanërisht tani kur bëhen përpjekje për ta bërë të obligueshëm arsimin e mesëm të lartë. Hulumtimet që trajtojnë shkaqet e braktisjes së shkollimit janë të nevojshme. Ato ofrojnë ekspertiza të ndryshme dhe alternativa të reja për adresimin e drejtë dhe me kohë të shkaqeve të braktisjes. Këtë e reflekton edhe hulumtimi ynë.

### 1.2. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit

Objekt i hulumtimit tonë është braktisja e shkollimit nga nxënësit e shkollave profesionale, shkalla e braktisjes dhe karakteristikat e nxënësve të klasave të 10-ta, të cilët janë kandidat potencialë për të braktisur shkollimin. Objekti i hulumtimit i përgjigjet qëllimit të hulumtimit që është sigurimi i informatave më të mira për trajtimin e problemit hulumtues, në mënyrë që të nxirren rekomandime për ndërhyrje më efektive në parandalimin e dukurisë së braktisjes.

Pyetjet kryesore të ngritura për objektin e hulumtimit janë bazuar në treguesit statistikorë për braktisjen e shkollës në shkollat profesionale të Kosovës, në raportet e hulumtimeve të deritashme për braktisjen, si dhe në përvojën tonë hulumtuese. Hulumtimi i paraprijnë pyetjet në vijim:

1. A është klasa e 10-të e arsimit profesional specifike dhe a ekziston shkallë e lartë e braktisjes në këtë klasë?
2. Cilat janë arsyt kryesore të braktisjes së shkollës nga nxënësit e arsimit profesional në klasën e 10-të?

### 1.3. Realizimi i hulumtimit

Hulumtimi u realizua në periudhën maj-shtator 2010, nga ekipi i hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje prej gjashtë hulumtuesve, i udhëhequr prej koordinatoreve të hulumtimit-hulumtues të IPK-së, dhe në mbështetje të ekspertes Froukje Wartenbergh nga Holanda, e angazhuar nga ETF-i.

Hulumtimi u realizua në katër faza kryesore:

Faza e parë e hulumtimit u realizua në gjysmën e dytë të muajit maj 2010. Në këtë fazë u organizua punëtorja e parë, me qëllim të hartimit të planit dinamik të realizimit të hulumtimit, përgatitjes së instrumenteve të hulumtimit, identifikimit të shkollave për fazën pilot të hulumtimit, si dhe pilotimit të instrumenteve të hulumtimit.

Në javën e fundit të muajit maj u realizua faza e dytë, e cila u karakterizua me realizimin e hulumtimit në shkollat e përzgjedhura.

Faza e tretë u realizua në qershor të vitit 2010, me analizimin e të dhënave fillestare të rezultateve të hulumtimit, të cilat u prezantuan në punëtorinë e radhës me ekspertin Froukje Wartenbergh dhe hartimin e planit dinamik të përpunimit të të dhënave, analizës dhe krahasimit të tyre.

Në periudhën e katërt, korrik-shtator 2010, u realizua hulumtimi kabinetik, u analizuan statistikat në arsimin e mesëm të lartë, masat politike për parandalimin e braktisjes, përkrahja e donatorëve dhe gjetjet nga hulumtimet e tjera. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë analizuar të dhënat e hulumtimit dhe është përgatitur raporti i hulumtimit.

*Metodologjia e hulumtimit.* Hulumtimi është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative. Është zbatuar qasja e hulumtimit kabinetik, përmes së cilës janë konsultuar politikat arsimore që trajtojnë braktisjen, statistikat në arsim, hulumtimet e deritashme në fushën e braktisjes etj. Po ashtu, është zbatuar hulumtimi përmes anketës, e cila

ndihmoi në pasqyrimin e këndvështrimeve të nxënësve dhe mësimitdhënësve për kompleksitetin e dukurisë së braktisjes.

*Objektivat kryesore të hulumtimit:*

- Shqyrtimi dhe analiza e aspekteve të politikave arsimore, përkrahjes së donatorëve, hulumtimeve dhe statistikave në arsimin profesional që reflektojnë braktisjen e shkollës;
- Grumbullimi i të dhënave përmes instrumenteve të hulumtimit, përkritazi me karakteristikat e nxënësve potencialë për ta braktisur shkollën;
- Analiza dhe interpretimi i të dhënave të fituara nga hulumtimi dhe paraqitja e tyre përmes procedurave statistikore;
- Nxjerrja e përfundimeve, rekomandimeve për trajtimin e drejtë të braktisjes në shkollat profesionale dhe
- Hartimi i planit të veprimit për fazën e dytë të projektit.

*Popullacioni dhe mostra.* Popullacionin në hulumtim e përbëjnë nxënësit e klasës së dhjetë të shkollave profesionale të Kosovës dhe mësimitdhënësit, të cilët janë të angazhuar në mësimitdhënie dhe nxënie në klasat e 10-ta të arsimit profesional. Statistikat e MASHT-it për Arsim Parauniversitar tregojnë se në klasën e dhjetë në shkollat profesionale në Kosovë, në vitin shkollor 2009/2010, janë regjistruar gjithsej 20402 nxënës, prej tyre 7183 vajza ose 35%, ndërsa 690 mësimitdhënës janë të angazhuar në këto klasa, në gjithsej 460 paralele.

Duke pasur parasysh se kjo është faza e parë e hulumtimit, ne kemi përzgjedhur një mostër me dy shtresa për hulumtim, njëra e përbërë nga nxënësit e klasës së 10-të të shkollave profesionale (Prishtinë, Podujevë, Drenas, Klinë dhe Istog), e përbërë prej 334 nxënësve, dhe tjetra e përbërë prej 82 mësimitdhënësve të shkollave të njëjta, që kryesisht japin mësim në klasat e 10-ta. Përzgjedhja e mostrës nga nxënësit është bërë e rastit, pa ndonjë kriter metodologjik, vetëm me orientim të mos janë nga i njëjti profil arsimor, ndërsa mostra e mësimitdhënësve është përzgjedhur sipas kriterit: kujdestar klase dhe mësimitdhënës që japin mësim në klasat dhe paralelet e nxënësve të përfshirë në hulumtim. Jemi përcaktuar për mostrën e nxënësve dhe mësimitdhënësve me qëllim të verifikimit të hipotezës kryesore dhe hipotezës ndihmëse, të cilat kanë të bëjnë me braktisjen e shkollës nga nxënësit e klasës së 10-të të arsimit profesional.

Përbërjen e mostrës e pasqyrojmë në tabelën në vijim.

Nr	Shkolla	Vendi	Numri i nxënësve Klasa 10 2009/2010	Numri i nxënësve të përfshirë në hulumtim	
				Nr	%
1	Shkolla profesionale "Mithat Frashëri"	Istog	339	42	12%
2	Shkolla teknike "28 Nëntori"	Prishtinë	353	72	20%
3	Shkolla bujqësore "Abdyl Frashëri"	Prishtinë	204	43	21%
4	Shkolla profesionale "Fehmi Agani"	Klinë	434	30	7%
5	Shkolla ekonomike "Isa Boletini"	Podujevë	666	71	11%
6	Shkolla teknike "Fehmi Lladrovci"	Drenas	733	76	10%
<b>Totali</b>			<b>2729</b>	<b>334</b>	<b>12%</b>

Tabela 1.1. Shkollat e përfshira në hulumtim dhe numri i nxënësve

*Metodat e hulumtimit.* Zbatimi i metodologjisë hulumtuese të kombinuar ka bërë të mundur përdorimin e disa metodave hulumtuese, përmes së cilave kemi mbledhur dhe përpunuar të dhënat lidhur me çështjet e vena në fokus të hulumtimit tonë. Metodat kryesore të cilat i kemi përdorur në hulumtimin tonë janë: *Metoda e analizës teorike, Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda përshkruese dhe Metoda statistikore.*

*Teknikat e hulumtimit.* Teknika e anketimit është e vetmja që është përdorur me qëllim të mbledhjes së të dhënave të çështjeve të vëna në fokus të hulumtimit dhe më vonë përpunimit të tyre. Pyetjet në pyetësorin e anketës janë adresuar për të dhënat e përgjithshme të subjekteve të përfshira në hulumtim dhe për të dhënat përmbajtjesore të lidhura me temën e hulumtimit.

Anketimi i nxënësve është realizuar me 16 pyetje themelore të shtruara në pyetësorin për nxënës. Përgjigjet në pyetje janë kërkuar në nivele të tipit të mbyllur dhe në disa raste me mundësi plotësimi<sup>2</sup>. Përdorimi i tipit të mbyllur dhe të hapur të pyetjeve ka mundësuar përpunimin kuantitativ dhe kualitativ të të dhënave, ndërsa anketimi i mësimdhënësve është realizuar me 13 pyetje themelore të shtruara në pyetësorin për mësimdhënës. Njëjtë sikur për nxënës, edhe në pyetësorin për mësimdhënës përgjigjet në pyetje janë kërkuar në nivele të tipit të mbyllur dhe në disa raste me mundësi plotësimi<sup>3</sup>. Edhe formati i pyetjeve në pyetësorin për mësimdhënës ka mundësuar përpunimin kuantitativ dhe kualitativ të të dhënave.

<sup>2</sup> Me gjerësisht shih në shtojcë pyetësorin për nxënës.

<sup>3</sup> Me gjerësisht shih në shtojcë pyetësorin për mësimdhënës.

Pyetjet në pyetësor janë të tipave të ndryshme: të mbyllura, të hapura dhe të kombinuara. Pyetjet e adresuara në pyetësor për çështjet përmbajtjesore të temës së hulumtimit përfshijnë aspektet që lidhen me nivelin e kënaqësisë së nxënësve dhe mësimdhënësve me shkollën, mësimdhënien, raportet nxënës - mësimdhënës, bashkëpunimi me mësimdhënës dhe me prindër, treguesit e braktisjes etj.

*Si kemi vepruar në realizimin e hulumtimit përmes teknikës së anketimit?* Në çdo shkollë të përzgjedhur për ta bërë hulumtimin, fillimisht kemi kontaktuar me drejtorin apo zv/drejtorin e shkollës, ku kemi bërë prezantimin e qëllimit të vizitës në shkollë dhe qëllimin e hulumtimit. Pastaj, me ndihmën e drejtuesve të shkollave, kemi bërë shpërndarjen e pyetësorëve të mësimdhënësit dhe tek nxënësit - paralelet e të cilëve janë përzgjedhur për mostër të hulumtimit. Mësimdhënësve udhëzimet për plotësimin e pyetësorëve u janë dhënë në sallën e mësimdhënësve, në pauzën në mes të orëve mësimore. Kurse udhëzimet për nxënës janë dhënë në klasën e tyre, si dhe është bërë monitorimi i tyre gjatë një ore mësimore, për të mos e lejuar ndërhyrjen e të tjerëve në punën e pavarur të tyre. Pas përfundimit të punës janë mbledhur pyetësorët e mësimdhënësve dhe të nxënësve dhe ndërkohë është filluar me analizën dhe përpunimin e të dhënave. Kështu është vepruar në të gjitha shkollat dhe paralelet e përfshira në hulumtim.

#### 1.4. Pastrimi i të dhënave - kontrolli i kualitetit

Ekipi hulumtues vëmendje të veçantë i kushtoi futjes së të dhënave në programin kompjuterik Microsoft Office Excel 2007 me qëllim të pastrimit të të dhënave-kontrollit të kualitetit, analizës dhe interpretimit të rezultateve. Për futjen e të dhënave origjinale kemi punuar në çifte dhe në përfundim të futjes së të dhënave ato janë kontrolluar në mënyrë reciproke nga çiftet që kanë punuar. Kjo qasje ka ndihmuar që të sigurohen të dhëna komplete dhe të kontrolluara mirë.

Pas futjes së të dhënave ato janë ruajtur në një dokument origjinal dhe është filluar me hapat tjerë - pastrimin e të dhënave. Pastrimin e të dhënave e kemi bërë në bazë të rregullave të akorduara nga ekipi hulumtues, varësisht nga specifikat e pyetjeve dhe varësisht nga trajtimi i tyre gjatë analizës së të dhënave. Disa nga rregullat e vendosura për pastrimin e të dhënave janë të përshkruara në vijim:

- Në rastet kur nxënësit kanë shënuar për të gjitha nivelet e arsimimit të prindërve JO, por në fund ka shënuar tjetër PO, mirëpo pa

specifikuar çfarë niveli të arsimimit, jemi përcaktuar që ta lëmë të zbrazët, sepse është e paqartë shkalla e arsimimit;

- Në rastet kur nxënësit kanë shënuar për të gjitha nivelet e arsimimit të prindërve JO, jemi përcaktuara që ta shënojmë me i/e paarsimuar;
- Në rastet e shënimit të udhëtimit *deri në 3 km* dhe nuk ka specifikuar vendbanimin *fshat-qytet*, jemi përcaktuar që në raste të tilla vendbanimin ta shënojmë *qytet*;
- Përgjigjet e dhëna në pyetjen e 8-të (**Sa shpesh ikni nga orët e mësimit?**), për alternativën a) *asnjëherë*, në pyetjen e 9-të dhe të 10-të, që kanë mbetur të paplotësuara, nuk do të llogariten me -1;
- Përgjigjet e dhëna në pyetjen e 8-të (*asnjëherë*), ndërsa në pyetjen e 9-të kanë shënuar arsyen e ikjes, përgjigjet merren për bazë vetëm si opinion i nxënësve për arsyet e ikjes së nxënësve të tjerë të klasës;
- Përgjigjet e dhëna në pyetjen e 8-të (*asnjëherë*), ndërsa në pyetjen e 10-të kanë dhënë vlerësimin për masat ndaj nxënësve që kanë mungesa, përgjigjet merren për bazë vetëm si mendim i nxënësve për institucionet që ndërmarrin masa;
- Të gjitha përgjigjet e dyfishta janë eliminuar dhe nuk janë marrë për bazë gjatë analizës;

Pastrimi i të dhënave të nxënësve nxori në sipërfaqe katër pyetësorë të paplotësuar në masën mbi 60%. Që të katër pyetësorët e nxënësve me këtë shkallë të mosplotësimit janë hequr nga analiza e të dhënave. Gjithashtu, pastrimi i të dhënave të mësimdhënësve rezultoi me heqjen e një pyetësori për shkak të mosplotësimit në masën mbi 80%.

Pas përfundimit të pastrimit të të dhënave, dokumenti i pastrimit është ruajtur i veçantë dhe është krijuar dokumenti i ri për të bërë ndryshimet e nevojshme mbi bazën e logjikës së trajtimit të të dhënave për analizë. P.sh. për shkallën e arsimimit të prindërve për katër opsionet e mundshme kemi krijuar një kolonë në të cilën kemi shënuar nivelin përfundimtar të arsimimit të prindërve. Pas pastrimit të të dhënave kemi arritur te forma finale e të dhënave, forma për analizë dhe interpretim të të dhënave. Para se të fillojmë me analizën e të dhënave, ekipi hulumtues është pajtuar me përmbajtjen e raportit dhe pastaj ka bërë planin e analizës<sup>4</sup>, ka përcaktuar grupet që do t'i

<sup>4</sup> Më gjerësisht shih në shtojcë planin e analizës së të dhënave. Plani përveç analizës së të dhënave përfshin edhe përgjegjësit për futjen e të dhënave dhe hulumtimin kabinetik, duke përfshirë politikën arsimore, statistikën në arsim, përkrahjen e donatorëve dhe hulumtimet e tjera në këtë fushë.

krahasojë, ndërlidhjen me përmbledhjen e këtyre të dhënave, përdorimin e tabelave dhe figurave etj.

## 1.5. Përkufizimi i nocionit “braktisje”

Varësisht nga karakteristikat e zhvillimit të sistemit arsimor të një vendi, përkufizohet edhe termi “braktisje”:

- Studiuesi Kozma Grillo në Fjalorin e Edukimit (2002), me termin braktisje e shkollës, u referohet nxënësve që për vështirësi ekonomike apo për mungesë të aftësive etj. nuk e mbarojnë një cikël të rregullt formimi.
- OECD nxënësin që e lë një nivel të veçantë të sistemit arsimor, pa e arritur kualifikimin e parë, e përkufizon “braktisës”.
- UNESCO lënien e shkollës, pa e përfunduar ciklin e filluar të një programi, e përkufizon “braktisje”.
- Studiuesi Morrow (1987) nxënës braktisës e quan çdo nxënës që është regjistruar paraprakisht në shkollë dhe i cili nuk është më i regjistruar në mënyrë aktive, që tregohet me 15 ditë mungesë të paarsyeshme të njëpasnjëshme dhe për të cilin nuk është pranuar asnjë e dhënë formale që tregon regjistrimin në një institucion tjetër arsimor të licencuar nga shteti.
- Dolf van Veen (sipas Glynn Kirkham 2009 - University of Wolverhampton), në hulumtimet e tij për braktisjen e shkollimit nga nxënësit, përdor termin mosfrekuentim
- Ndërsa sipas Projektligjit për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2010) “braktisje e shkollës” do të thotë tërheqje e hershme nga shkollimi obligues. Ne, në mbështetje të përkufizimeve të lartcekura, jemi përcaktuar që në hulumtimin tonë mosvazhdimin e shkollimit në klasat vijuese të nxënësve të regjistruar ta trajtojmë braktisje të shkollimit, përkundrajt faktit se shkollimi i mesëm i lartë te ne akoma nuk është i obligueshëm.

## 1.6. Përmbledhje e shkurtër e raportit

Raporti, përveç përmbledhjes ekzekutive, e cila është dhënë në fillim të raportit, përbëhet nga tetë kapituj. *Hyrja është kapitulli i parë.*

*Në kapitullin e dytë* pasqyrohen statistikën e përgjithshme të arsimit të mesëm të lartë që ofrojnë tregues për braktisjen. Pastaj ofrohen të dhëna të përkrahjes së arsimit profesional nga donatorët, si 'World Bank', GTZ-ja, UNICEF-i etj. Ndërsa, në pjesën e fundit të kapitullit të dytë pasqyrohen disa tregues të gjetjeve për braktisjen nga hulumtimet e tjera.

*Në kapitullin e tretë* pasqyrohen të dhënat hyrëse për nxënës dhe mësimdhënës, si: përkatësia gjinore dhe mosha e nxënësve, shkalla e shkollimit të prindërve dhe punësimin e tyre, vendbanimi i nxënësve dhe distanca e udhëtimit deri në shkollë. Po ashtu, në kapitullin e tretë ofrohen të dhënat për përkatësinë gjinore dhe moshën e mësimdhënësve, përgatitjen shkollor/kualifikimin, përvojën e punës dhe përfshirjen e mësimdhënësve në trajnime.

*Në kapitullin e katërt* ofrohen të dhëna mbi atë se sa janë të kënaqur nxënësit dhe mësimdhënësit me shkollën. Në veçanti, në këtë kapitull jepen fakte mbi mënyrat e zgjedhjes së drejtimit/shkollës nga nxënësit, arsyet më kryesore të zgjedhjes së drejtimit/shkollës, mënyrat e informimit të nxënësve për zgjedhjen e profilit arsimor, shkollën e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës dhe profilit arsimor, shkollën e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës në raport me mënyrën e zgjedhjes, shkollën e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të lidhura me procesin mësimor, me raportet me mësimdhënës, me vlerësimin e arritjeve etj. Po ashtu në këtë kapitull ofrohen tregues për shkollën e kënaqësisë së mësimdhënësve me planin dhe programin mësimor, motivimin e nxënësve në klasë, klimën që krijohet në klasë, dallimet në mësim dhe sjelljet e nxënësve, kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia, aplikimin e teknologjisë së re të mësimdhënies dhe motivimin e mësimdhënësve për punë me nxënës.

*Në kapitullin e pestë* ofrohen të dhëna të rezultateve të hulumtimit dhe interpretimit të tyre për mësimdhënien dhe stilet e mësimdhënies, me fokus të veçantë për pritjet e nxënësve nga shkolla dhe mësimdhënësit, afërsinë e mësimdhënësve me nxënës, llojet alternative të komunikimit, detyrat e shtëpisë dhe bashkëpunimin me prindër.

*Në kapitullin e gjashtë* pasqyrohen treguesit e braktisjes. Fillimisht përshkruhen informatat për braktisjen nga administrata e shkollës. Pastaj

përshkruhen treguesit e braktisjes të nxjerrë nga hulumtimi me nxënës, për atë se sa shpesh nxënësit ikin nga orët e mësimi, pse ikin nga orët e mësimi, çka ndodh kur ikin nga orët e mësimi, cili është numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën, cilat janë arsyet kryesore për braktisjen e shkollës, cilat janë veprimet e ndërmarra për parandalimin e braktisjes, si dhe çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore. Gjithashtu në këtë kapitull jepen fakte nga mësimdhënësit për nxënësit potencialë për braktisje, numrin aktual të nxënësve që e kanë braktisur shkollën, arsyet e braktisjes, diskutimin e pasojave të braktisjes, shpeshësinë e mbajtjes së takimeve me mësimdhënës për të diskutuar për braktisjen, temat specifike për braktisjen që diskutohen me mësimdhënës, bashkëpunimin me prindër, format e bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindërit e nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës.

*Në kapitullin e shtatë* ofrohen të dhëna për parashikimin dhe parandalimin e braktisjes përmes prezantimit të karakteristikave për nxënësit që janë më së shumti në rrezik për të braktisur shkollën (nxënësit potencialë për të braktisur shkollën), identifikimin e llojeve të mësimdhënies që rrisin rrezikun për braktisje të shkollës nga nxënësit, si dhe ofrimin e të dhënave për atë se çka bëjnë dhe çka nuk bëjnë shkollat për parandalimin e braktisjes. *Në kapitullin e tetë* përshkruhen përfundimet dhe rekomandimet. Kapitulli përmbledh vlerësimin e kësaj faze të hulumtimit (metodologjinë, përparësitë, kufizimet etj.), gjetjet më të rëndësishme, rekomandimet për të ardhmen, si dhe idetë për hulumtimet për të ardhmen në këtë fushë.

## Kapitulli II

### 2. Hulumtimi kabinetik

Në fokus të hulumtimit kabinetik u vendosen analiza e statistikave në arsim - me theks të veçantë analiza statistikave që ofrojnë tregues për braktisjen, analiza e masave politike për parandalimin e braktisjes, analiza e përkrahjes së donatorëve për parandalimin e braktisjes, si dhe analiza e gjetjeve nga hulumtimet e tjera.

#### 2.1. Statistikat për braktisjen

Analiza e statistikave për arsimin e mesëm të lartë në Kosovë është bërë në referim të të dhënave statistikore nga EMIS për vitet shkollore 2005/2006 – 2009/2010. Në funksion të realizimit të qëllimit të hulumtimit, kemi bërë analizën e të dhënave të numrit të nxënësve që kanë përfunduar klasën e 9-të, përfshirjen e tyre në klasën e 10-të, pastaj në klasën e 11-të, 12-të dhe 13-të. Këtë e kemi bërë për të siguruar tregues statistikorë për përfshirjen apo mospërfshirjen e nxënësve në të gjitha klasat e shkollës së mesme të lartë të këtij viti shkollor. Analizën e kemi bërë si për shkolla profesionale, ashtu edhe për gjimnazet, sepse mungojnë raporte të sakta të lëvizjes së nxënësve nga shkollat profesionale, në gjimnaze dhe anasjelltas.

*Shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 9-të në klasën e 10-të (2006/2007-2009/2010).* Sipas të dhënave statistikore të sistemit të menaxhimit të informatave në Ministrinë e Arsimit përqindja e numrit të nxënësve që mbarojnë klasën e 9-të të shkollës së mesme të ulët dhe që nuk përfshihen në klasën e 10-të të arsimit të mesëm të lartë është në rënie, përkatësisht përfshirja e nxënësve në klasën e 10-të është në rritje. Në veçanti nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të në vitin shkollor 2008/2009 shënojnë shkallë më të lartë të përfshirjes në arsimin e mesëm të lartë. Kjo me gjasë është arritur nën ndikimin e vendimit të MASHT-it Nr. 482/01-B, i datës 21.08.2009, për përfshirje të nxënësve në shkollimin e mesëm të lartë. Statistikat e arsimit për 2006/2007 deri në vitin 2009/2010 ofrojnë këto të dhëna për përfshirjen e nxënësve në shkollën e mesme të lartë – klasën e 10-të.

Viti shkollor	Numri i nxënësve që kanë mbaruar klasën e 9-të	Viti shkollor	Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të	%	Numri i nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 10-të	%
2005/2006	32669	2006/2007	28434	87%	4235	13%
2006/2007	32058	2007/2008	28982	90%	3076	10%
2007/2008	36169	2008/2009	32456	90%	3713	10%
2008/2009	40271	2009/2010	37521	93%	2750	7%
Totali	141167	Totali	127393	90%	13773	10%

Tabela 2.1. Numri i nxënësve 2005/2006 – 2008/2009 që kanë mbaruar klasën e 9-të dhe numri i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të

Të dhënat nga tabela e paraqitur më lart tregojnë se në katër vitet e fundit, pas mbarimit të klasës së 9-të, nuk janë regjistruar në klasën e 10-të 13773 nxënës, ose rreth 10%. Figura në vijim pasqyron përqindjet dhe numrin e nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 10-të nga viti 2006/2007 deri në vitin 2009/2010.




Figura 2.1. Përqindjet për numrin e nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 10-të nga viti 2006/2007 deri në vitin 2009/2010

Për të parë dallimet gjinore të nxënësve të përfshirë nga klasa e 9-të në klasën e 10-të, kemi bërë një analizë të të dhënave të përfshirjes së nxënësve në klasën e 10-të në vitin shkollor 2009/2010. Analiza e të dhënave tregon se 3115 vajza ose 16.01 % e tyre që e kanë mbaruar klasën e 9-të nuk janë regjistruar në klasën e 10-të, ndërsa numri i meshkujve është rritur në klasën e 10-të për 365, nga numri i nxënësve meshkuj që e kanë mbaruar klasën e 9-të<sup>5</sup>.

Tabela në vijim i pasqyron këto të dhëna.

Klasa e 9-të Viti shkollor 2008/2009	Numri i nxënësve		
	M	F	GJ
	20819	19452	40271
Klasa e 10 Viti shkollor 2009/2010	Numri i nxënësve		
	M	F	GJ
	21184	16337	37521
Ndryshimi nga klasa e 9-të në klasën e 10-të ( Mosregjistrimi në klasën e 10-të)	Numri i nxënësve		
	M	F	GJ
	+ 365 ose 1 %	3115 ose 16. %	2750 7%

Tabela 2.2. Raporti gjinor i nxënësve të klasës së 10-të, 2009/2010

*Klasa 11-të (2009/2010) - shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të.* Sipas dispozitave ligjore të arsimit të mesëm të lartë, të gjithë nxënësit që mbarojnë klasën përkatëse me sukses pozitiv mund të vazhdojnë në klasën vijuese të drejtimit përkatës, apo në tipin tjetër të shkollës, me kusht që në rastin e fundit të kenë dhënë ndryshimet në lëndët e parapara me udhëzim administrativ për ndërrimin e tipit të shkollës, apo profilit arsimor.

Analizën e shkallës së përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të e kemi bërë duke gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve të kësaj gjenerate që nuk janë përfshirë në klasën e 10-të pas përfundimit të klasës së 9-të, si dhe duke gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 11-të nga klasa e 10-të. Tabela në vijim pasqyron këto ndryshime.

<sup>5</sup> Pas analizës së të dhënave, kemi ardhur në përfundim se kjo rritje e numrit të nxënësve mund të jetë ndonjë gabim statistikor, ose mund të jenë nxënës që kanë humbur klasën paraprakisht dhe përsëri janë regjistruar në klasën e 10-të. Nëse këtë numër të nxënësve ia heqim numrit të regjistruar nga klasa e 9-të, vijmë në përfundim se 7.74% e nxënësve që e kanë mbaruar klasën e 9-të në këtë gjeneratë nuk janë regjistruar në klasën e 10-të.

Tipi i shkollës	Viti shkollor 2007/2008 Klasa 9-të		Viti shkollor 2008/2009 Klasa 10-të		Ndryshimi nga klasa 9-të		Viti shkollor 2009/2010 Klasa 11-të		Ndryshimi nga klasa 10 (shkalla e braktisjes)	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkolla prof.			17358	53.48			14686	51	2672	15
Gjimnaze			15098	46.52			14026	49	1072	8
Gjithsej	36169		32456	100	3713	10.27	28712	100	3744	12

Tabela 2.3. Shkalla e (mos)përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të - viti shkollor 2009/2010

Tabela nr. 2.3 tregon se 2672 ose 15% e nxënësve të shkollave profesionale nuk e kanë vazhduar klasën e 11-të në këtë vit shkollor, ndërsa në gjimnaze nuk e kanë vazhduar 1072 ose 8%, përkatësisht në total 3744 ose 12 % e nxënësve nuk e kanë vazhduar shkollimin në klasën e 11-të të shkollës së mesme të lartë. Figura në vijim paraqet numrin dhe përqindjen e nxënësve të shkollave profesionale që nuk e kanë vazhduar klasën e 11-të.




Figura 2.2. Raporti i (mos)përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të - 2009/2010

*Klasa 12-të (2009/2010) - shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 11-të.* Ashtu sikurse për klasën e 11-të, sipas dispozitave ligjore të arsimit të mesëm të lartë, të gjithë nxënësit që e mbarojnë klasën përkatëse me sukses pozitiv mund të vazhdojnë në klasën vijuese të drejtimit përkatës – klasën e

12-të, apo në tipin tjetër të shkollës, me kusht që të kenë dhënë ndryshimet në lëndët e parapara për ndërrimin e tipit të shkollës dhe profilit arsimor.

Analizën e shkallës së përfshirjes së nxënësve nga klasa e 11-të në klasën e 12-të e kemi bërë duke i gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve të kësaj gjenerate që nuk janë përfshirë në klasën e 10-të pas përfundimit të klasës së 9-të, duke gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 11-të nga klasa e 10-të, si dhe duke gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 12-të nga klasa e 11-të. Tabela në vijim pasqyron këto ndryshime.

Tipi i shkollës	Viti 2007/2008 Klasa 10		Viti 2008/2009 Klasa 11		Viti 2009/2010 Klasa 12		Ndryshimi nga klasa 10-të në klasën e 11-të		Ndryshimi nga klasa 11-të në klasën e 12-të		Ndryshimi nga klasa 10-të dhe 11-të në klasën e 12-të	
	Zi	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkolla profesionale	15965	55	13377	51	12198	51	2588	19	1179	10	3767	24
Gjimnaze	13017	45	12770	49	11825	49	247	2	945	8	1192	9
Gjithsej	28982	100	26147	100	24023	100	2835	11	2124	9	4959	17

Tabela 2.4. Shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 11-të në klasën e 12-të - viti shkollor 2009/2010.

Tabela 2.4 tregon se prej 28982 nxënësve që e kanë vazhduar klasën e 10-të, 2835 ose 11 % e tyre e kanë ndërprerë vijimin e shkollimit në klasën e 11-të, shumica prej tyre janë nxënës të shkollës profesionale, 2588 ose 19% e nxënësve të shkollave profesionale. Ndërsa prej 26147 nxënësve që kanë vazhduar klasën e 11-të, 2124 ose 9% nuk kanë vazhduar klasën e 12-të. Për dallim nga klasa e 11-të, në klasën e 12-të numri i nxënësve të gjimnazeve është rritur për 8%. Nëse e krahasojmë numrin hyrës të nxënësve në klasën e 10-të dhe numrin e regjistruar të nxënësve në klasën e 12-të, shohim se për 4959 ose për 17% është më i vogël numri i nxënësve në klasën e 12-të. Përqindja më e lartë e nxënësve që nuk e kanë vazhduar shkollën në këto vite janë nxënësit nga shkollat profesionale, ku 2588 ose 19% e tyre e kanë ndërprerë shkollimin pas klasës së 10-të dhe 1179 nxënës ose 10% e tyre nuk e kanë vazhduar shkollimin pas klasës së 11-të, ose e kanë ndërprerë gjatë klasës së 11-të. Në total, numri i nxënësve të arsimit profesional që e

kanë ndërprerë shkollimin në klasën e 10-të dhe 11-të arrin në 3767 ose 24% nga numri i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të.

Për vazhdimin e shkollimit nga klasa e 11-të, në klasën e 12-të nuk mund të themi se kemi të bëjmë me braktisje në këtë shkallë të lartë të përqindjes, sepse disa profile arsimore kanë programin e tyre, ku nxënësit mund të certifikohen pas përfundimit të klasës së 11-të, por nuk e ndalon vazhdimin në klasën e 12-të. Mirëpo, mungojnë të dhëna të sakta për nxënësit që kanë marrë certifikata në fund të klasës së 11-të dhe për nxënësit që në bazë të profileve të tyre arsimore është dashur domosdoshmërisht të vazhdojnë edhe klasën e 12-të. Për të ilustruar më mirë shkallën e ndërprerjes së shkollimit të gjeneratës së nxënësve të këtij viti shkollor në klasën e 12-të, në figurën në vijim do të pasqyrohen dallimet në përqindje të nxënësve të shkollave profesionale dhe të gjimnazeve që nuk kanë vazhduar në klasën e 12-të.




Figura 2.3. Shkalla e përqindjes së nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 11-të dhe 12-të

Të dhënat nga figura 2.3 tregojnë se shkalla e përqindjes së nxënësve që nuk janë regjistruar në klasën e 11-të të shkollave profesionale, apo braktisja në këtë klasë është shumë më e lartë se në klasën e 12-të, ndërsa në gjimnaze braktisja më e lartë është shënuar në klasën e 12-të.

**Klasa 13-të (2009/2010)- shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 12-të.** Njëjtë si për klasat e tjera, edhe për klasën e 13-të analizën e shkallës së përfshirjes së nxënësve e kemi bërë duke gjetur ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 11-të nga klasa e 10-të, ndryshimet e numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 12-të nga klasa e 11-të, si dhe duke gjetur ndryshimet e



numrit dhe përqindjes së nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 13-të nga klasa e 12-të.

Tabela në vijim (2.5) pasqyron numrin e nxënësve të së njëjtës gjeneratë nga klasa e 10-të deri në klasën e 13-të, përqindjen e numrit të nxënësve në raport me tipin e shkollës – shkollë profesionale apo gjimnaz, ndërsa tabela 2.6 pasqyron numrin e nxënësve të së njëjtës gjeneratë që nuk kanë vazhduar shkollën në klasën e 11-të, përkatësisht në klasën e 12-të dhe 13-të.

Tipi i shkollës	Viti 2006/2007 Klasa 10-të		Viti 2007/2008 Klasa 11-të		Viti 2008/2009 Klasa 12-të		Viti 2009/2010 Klasa 13-të	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkolla prof.	15719	55	13477	53	12458	52	11702	85
Gjimnaze	12715	45	12152	47	11504	48	2095	15
Gjith.	28434	100	25629	100	23962	100	13797	100

Tabela 2.5. Klasa e 13-të, (2009/2010) - shkalla e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të

Tipi i shkollës	Numri i nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 11-të - Viti 2007/2008		Numri i nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 12-të - Viti 2008/2009		Numri i nxënësve që nuk kanë vazhduar në klasën e 13-të <sup>6</sup> - Viti 2009/2010		Shkalla e mospërfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të dhe 12-të	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Shkolla profesionale	2242	14	1019	8	756	6	3261	21
Gjimnaze	563	4	648	6			1211	10
Gjith.	2805	10	1667	7			4472	16

Tabela 2.6. Klasa e 13-të (2009/2010) - shkalla e mospërfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të.

<sup>6</sup> Ndryshimin nga klasa e 12-të në klasën e 13-të nuk e kemi llogaritur në shkallën e mospërfshirjes së nxënësve në shkollë, për faktin se nuk kemi të dhëna të sakta për ndarjen e nxënësve, që sipas drejtimeve profesionale klasën e 13-të e kanë të obligueshme, si dhe për faktin e dytë se të gjithë nxënësit që e kanë përfunduar klasën e 12-të kanë pasur të drejtë të shkojnë në klasën e 13-të, por jo në mënyrë të obligueshme.

Tabela 2.6 tregon se prej 28434 nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të, 2805 ose rreth 10 % e tyre e kanë ndërprerë vijimin e shkollimit në klasën e 11-të, ndërsa 1667 ose 7 % e nxënësve që e kanë përfunduar klasën e 11-të nuk kanë vazhduar në klasën e 12-të, kurse 756 nxënës ose mbi 6 % e nxënësve të shkollës profesionale nuk e kanë vijuar shkollimin në klasën e 13-të, edhe pse është hequr kriteri për përfshirjen e nxënësve të shkollave profesionale në klasën e 13-të. Edhe në këtë gjeneratë, shkalla më e lartë e përqindjes së nxënësve që nuk e kanë vazhduar shkollën në këto vite të shkollimit janë nxënësit nga shkollat profesionale, mirëpo është shkallë më e ulët e mospërfshirjes në shkollim, për dallim nga dy klasat tjera të këtij viti shkollor – klasës së 11-të dhe klasës së 12-të.

*Raporti gjinor i përfshirjes së nxënësve në klasat vijuese.* Analiza e statistikave të arsimit të mesëm të lartë tregon se mospërfshirja e nxënësve në klasat vijuese është e shprehur më shumë te meshkujt se te femrat. Të dhënat statistikore të gjeneratës së nxënësve që në vitin shkollor 2008/2009 janë regjistruar në klasën e 10-të dhe në vitin shkollor 2009/2010 kanë vazhduar në klasën e 11-të, tregojnë se mbi 14 % e meshkujve nuk kanë vazhduar shkollimin në klasën e 11-të, kurse mbi 8% e vajzave nuk e kanë vazhduar klasën e 11-të. Tabela në vijim i ilustron këto të dhëna:

Në shkallë	Klasa 10-të 2008/2009			Klasa 11-të 2009/2010					
	M	F	GJ	M	F	GJ	Përfshirja e meshkujve	Përfshirja e femrave	Gjithsej
vendi	18309	14147	32456	15729	12983	28712	86%	92%	88%

Tabela 2.7. Raporti gjinor i përfshirjes së nxënësve në klasën e 11-të, 2009/2010 - në shkallë vendi

Edhe të dhënat statistikore të nxënësve në komunat ku është realizuar hulumtimi tregojnë raportin gjinor të përfshirjes së nxënësve nga klasa e 10-të në klasën e 11-të, i cili është përafërsisht i njëjtë. Shkalla më e ulët e përfshirjes së nxënësve meshkuj nga klasa e 10-të në klasën e 11-të është shënuar në komunën e Klinës. Në këtë komunë, sipas statistikave të vitit 2009/2010, mbi 22% e meshkujve nuk e kanë vazhduar klasën e 11-të. Ndërsa në komunën e Drenasit të dhënat statistikore nuk janë të harmonizuara nga viti në vit, veçmas për raportin gjinor të vajzave. Tabela në vijim i ilustron këto të dhëna:

Komuna	Klasa 10-të 2008/2009			Klasa 11-të 2009/2010					
	M	F	GJ	M	F	GJ	M % e përfshirjes	F% përfshirjes	GJ% përfshirjes
Prishtinë	2160	2041	4201	1885	1626	3511	87	80	84
Drenas	637	466	1103	585	489	1074	92	105	97
Podujevë	871	673	1544	706	613	1319	81	91	85
Klinë	531	299	830	410	275	685	77	92	83
Istog	360	286	646	332	276	608	92	97	94
<b>Totali</b>	<b>4559</b>	<b>3765</b>	<b>8324</b>	<b>3918</b>	<b>3279</b>	<b>7197</b>	<b>86</b>	<b>87</b>	<b>86</b>

Tabela 2.8. Raporti gjinor i përfshirjes së nxënësve në klasën e 11-të, 2009/2010 - në shkollat e përfshira në hulumtim

Përmbledhje e të dhënave statistikore për shkallën e braktisjes në shkollat e mesme të larta.

Nga analiza e të dhënave statistikore të bëra për tri klasat ( 11-të, 12-të dhe 13-të ), në vitin shkollor 2009/2010, kemi arritur në përfundim se shkalla më e lartë e braktisjes së shkollimit nga nxënësit e arsimit të mesëm të lartë, është në fund të klasës së 10-të. Kjo vërtetohet nga të dhënat statistikore të të gjitha klasave të kësaj gjenerate. Ndërprerja e shkollimit në shkallën më të lartë është e shprehur në shkollat profesionale.

Tabela në vijim pasqyron përmbledhjen e mospërfshirjes në shkollë të nxënësve për gjeneratat që në këtë vit shkollor janë në klasën e 11-të, 12-të dhe 13-të. Për klasën e 10-të të këtij viti shkollor nuk janë dhënë tregues statistikore, sepse kanë munguar raportet statistikore përfundimtare në kohën e përpunimit të raportit të këtij hulumtimi.

Klasa	Shkolla profesionale Nr.i nx. braktisës		Gjimnaze Nr.i nx. braktisës		Gjithsej Nr.i nx. braktisës	
		%		%		%
Klasa 11-të, 2009/2010 ( Braktisja nga klasa 10-të)	2672	15	1072	8	3744	12
Klasa 12: 2009/2010 (Braktisja nga klasa 10-të dhe 11)	3767	24	1192	9	4959	17
Klasa 13: 2009/2010 ( Braktisja nga klasa 10 dhe 11 <sup>7</sup> )	3261	21	1211	10	4472	14
<b>Totali</b>	<b>9700</b>	<b>20</b>	<b>3475</b>	<b>9</b>	<b>13175</b>	<b>15</b>

Tabela 2.9 Pasqyra e braktisjes në arsimin e mesëm të lartë, klasat 11, 12 dhe 13

<sup>7</sup> Nuk e kemi përfshirë braktisjen e nxënësve të klasës së 12, sepse nuk kemi të dhëna të sakta për numrin e nxënësve që janë të obligueshëm në bazë të programit mësimor të vijojnë klasën e 13.

Të dhënat nga tabela 2.9. janë tregues të qartë për shkallën e lartë të braktisjes së nxënësve në shkollat e mesme të larta në Kosovë, në veçanti në shkollat profesionale. Përmbledhja e braktisjes në shkollat profesionale pasqyrohet edhe në figurën në vijim.




Figura 2.4: Pasqyra e braktisjes në arsimin profesional- klasat 11-të, 12-të dhe 13-të

Sipas burimeve të MASHT-it, vijueshmëria e nxënësve sipas raportit midis nxënësve të regjistruar dhe atyre që arrijnë në fund të vitit në arsimin e mesëm të lartë<sup>8</sup> në nivelin 10-12 është 14%, ku mund të themi se është mjaft shqetësuese, sidomos nëse shikohet nga aspekti gjinor, ku në nivelin e 10-12 më shumë është e shprehur braktisja e shkollës nga nxënës të gjinisë mashkullore. Sipas këtyre të dhënave, vetëm 86% e atyre që regjistrojnë klasën e 10-të kalojnë në klasë të 11-të. Të dhënat, sipas burimeve të MASHT-it, janë shqetësuese, sepse nuk dihet se çfarë ndodh me pjesën tjetër të nxënësve që braktisin shkollën. Pas shqetësimeve të MASHT-it për dukurinë e braktisjes është ndërmarrë një hap konkret për orientimin e politikave për zbutjen e kësaj dukurie. Kështu, MASHT-i hartoi Planin e veprimit kundër braktisjes, 2009-2014. Nga të dhënat statistike në këtë burim lidhur me braktisjen, në nivelin të cilin hulumtimi ynë e kishte në fokus, jepen të dhëna jo inkurajuese. Sipas këtij burimi, nga viti shkollor 2003-2004 kemi rritje të shkallës së braktisjes së shkollimit në shkollimin e mesëm të lartë, 10-13. Sipas këtij burimi, derisa në vitin shkollor nga numri i përgjithshëm i nxënësve në nivelin 10-13, ishte 66968 dhe braktisje prej 2%, kjo në vitin shkollor 2007-2008 nga 90180 rreth 4% e kanë braktisur shkollimin.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> MASHT, Treguesit dhe të dhëna statistikore në arsim, për vitet shkollorë, 2004/05, 05/06, 06/07, Prishtinë, 2008, fq. 25.

<sup>9</sup> Plani kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014, MASHT, Prishtinë 2009, fq. 23.

**Konkludim.** Përfshirja e nxënësve në klasën e 10-të në vitet e fundit ka shënuar rritje deri në 93% të nxënësve që kanë mbaruar klasën e 9-të. Të dhënat e përmbledhura për përfshirjen e nxënësve në klasën e 10-të dhe për vazhdimin e shkollimit të tyre tregojnë se shkalla më e lartë e braktisjes së shkollës ndodh nga klasa e 10-të në klasën e 11-të dhe se në vitin e fundit në arsimin profesional 15% e nxënësve e kanë braktisur shkollën për arsye të ndryshme, duke përfshirë edhe humbjen e klasës. Numri i nxënësve që humbin vitin shkollor në klasën e 10-të është shumë më i lartë se në klasat e tjera. Për përfshirjen e nxënësve përsëritës në klasë të njëjta mungojnë të dhënat e sakta. Nxënësit që humbin klasën dhe nuk e përsërisin klasën në vitin vijues nuk raportohen si nxënës braktisës, sepse arsimit i mesëm i lartë nuk është i obligueshëm, por, në fakt, të gjithë nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, që nuk marrin njërin nga certifikatat e niveleve të arsimit profesional apo të tipit të gjimnazeve, janë braktisës të shkollës.

## 2.2. Analiza e politikave për parandalimin e braktisjes

Përpjekjet për adresimin e masave politike për parandalimin e braktisjes kanë rezultuar me forma të ndryshme, si me hartimin e ligjeve të ndryshme në Arsimin Parauniversitar, udhëzimet administrative, vendimet të veçanta, strategjitë etj. Ligjet në Arsimin Parauniversitar në masë të konsiderueshme përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e nivelit qendror dhe lokal lidhur me planifikimin dhe koordinimin, rregullimin dhe kontrollin, personelin, financimin, transportin e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe për funksionet e tjera.

Ligjet kryesore me të cilat rregullohet Arsimiti Parauniversitar janë: Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nr. 2002/2, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Ligji për Arsimimin dhe Aftësimin Profesional, nr. 2006/24, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve nr. 2005/43, Ligji për Inspektimin e Arsimit në Kosovë, nr. 2004/55, Ligji për Kualifikimet Kombëtare, nr. 03/L-060, Ligji për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore, nr. 03/L-018. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë mban përgjegjësinë kryesore për politikën arsimore në vend, me këtë rast edhe për parandalimin e braktisjes.

Në Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nuk përkufizohet qartë termi “braktisje“. Në nenin 7.15 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm

saktësohet se, në qoftë se një nxënës mungon në procesin e arsimit të detyruar, prindërit e tij mund të detyrohen të paguajnë gjoba, po që se mungesa është rezultat i veprimeve të qëllimshme apo neglizhencës së prindërve.

Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë e ndalon përjashtimin e nxënësve nga shkolla, mirëpo me udhëzime administrative rregullohen masat edukative dhe disiplinore që mund të aplikohen ndaj nxënësve që bëjnë veprime të ndaluara dhe që nuk tregojnë vijueshmëri të rregullt në mësim. Udhëzimi Administrativ (nr. 7/2009), Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta përcaktojnë të drejtat e nxënësve, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim dhe praktikë profesionale dhe masat disiplinore, masat edukative - disiplinore, procedurat për zbatimin e masave etj. Masa edukative-disiplinore, pezullim i përkohshëm më shumë se një muaj shqiptohet nga Kuvendi Komunal, duke siguruar arsimim alternativ për nxënësin e pezulluar. Për këtë të fundit mungojnë raporte se si Kuvendet Komunale sigurojnë arsimim alternativ për nxënësit e pezulluar.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka nxjerrë edhe Udhëzime Administrative dhe vendime të veçanta për parandalimin e braktisjes. **Udhëzimi Administrativ Nr. MASHT [I] 13/2005:** Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar, reflektojnë në parandalimin e braktisjes. Në bazë të këtij udhëzimi përcaktohen masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar. Edhe pse udhëzimi është nxjerrë në vitin 2005, nuk ka të dhëna që janë ndërmarrë masa ndaj prindërve fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar në shkollë, apo që e kanë ndërprerë shkollimin, kurse numri i nxënësve që braktisin shkollimin është rritur.

Me qëllim që të sigurohet një pasqyrë reale e të dhënave të lëvizjes dhe braktisjes së nxënësve, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka nxjerrë vendimin nr. 375/02-1, të datës 13.01.2006, me të cilin obligon drejtorët e shkollave në arsimin e detyruar që të evidentojnë me saktësi lëvizjen e nxënësve brenda vitit shkollor, duke mbajtur dosjen e dokumentacionit për: rastet e transferimit të nxënësve prej një shkolle në tjetrën; informatat kthyesë për nxënësit e transferuar nga shkollat ku ata janë transferuar; braktisjen dhe shkaqet e saj. Vendimi është shpërndarë në institucionet shkollore, zbatimi i të cilit mbikëqyret nga inspektorët e arsimit në nivel rajonal dhe në nivelin qendror. Po ashtu, janë marrë edhe vendime të tjera, të cilat indirekt kanë qenë masa për parandalimin e braktisjes, si vendimi nr. 557/02-1, i datës 22.08.2008, për rritjen e numrit të nxënësve në

paralele deri në 37, pastaj vendimi nr. 258/01-B, i datës 17.09.2008, për heqjen e kriterëve për regjistrim në klasën e 13-të dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në klasën e 13-të që kanë mbaruar me sukses pozitiv klasën e 12-të.

Vendimi i fundit shikuar nga këndi i përfshirjes më të madhe të nxënësve në klasën e 13-të ka reflektuar pozitivisht, mirëpo shikuar nga këndi i zbatimit në praktikë ka shkaktuar vështirësi për shkollat dhe komunat, për shkak të mungesës së hapësirës shkollore, si dhe për shkak të vështirësive buxhetore të komunave për futjen e mësimdhënësve të rinj në listën e pagave. Këto vështirësi, në masë të konsiderueshme, kanë krijuar pakënaqësi të mësimdhënësit, por edhe në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, për shkak të rritjes së numrit të nxënësve në klasa.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka hartuar Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007/2017. Në strategji është paraparë që deri në vitin 2009 të hulumtohen shkaqet e braktisjes së shkollës, ndërsa nga viti 2009-2012 të bëhet adaptimi i programeve për integrimin e nxënësve që nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë apo që kanë braktisur shkollën<sup>10</sup>. Hulumtimi për shkaqet e braktisjes është bërë në vitin 2008 dhe në të janë përfshirë vetëm tetë komuna të Kosovës, ndërsa procesi i adaptimit të programeve për nxënësit që e kanë braktisur shkollën ende nuk ka filluar dhe nuk ka një plan se kur do të fillohet dhe si do të harmonizohet plani i veprimit.

Përveç Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007/2017, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka hartuar edhe Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2007/2017. Strategjia e veçantë për integrimin e komuniteteve në arsim është bërë për shkak të pjesëmarrjes jo të kënaqshme të tyre në sistemin arsimor. Përkundër faktit se strategjia është miratuar në vitin 2007, braktisja e shkollës nga nxënësit RAE është shumë e lartë, ndërsa integrimi i nxënësve që e kanë braktisur shkollën në shkollimin e rregullt është minimal.

Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore në arsimin e obligueshëm, klasat 1-9, siguroi mbështetje të madhe për të gjithë nxënësit në Kosovë, veçmas për nxënësit familjet e të cilëve janë në gjendje të rëndë sociale. Përkundërt arsimit të obligueshëm, klasat 1 – 9, në arsimin e mesëm të lartë tekstet shkollore nuk

<sup>10</sup> MASHT: Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë, 2007 – 2017, Prishtinë 2007, f. 75.

sigurohen nga MASHT-i. AAP ballafaqohet me mungesë të teksteve shkollore, në shumicën e profileve arsimore, pavarësisht përpjekjeve të profesorëve për plotësimin e kësaj mungese.

Plani Kombëtar i Veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014 është dokumenti i fundit i miratuar nga MASHT-i, i cili synon që të adresojë në mënyrë më të plotë dukurinë e braktisjes së shkollës. Në dokument janë përfshirë gjashtë objektiva, të cilat duhet të arrihen deri në vitin 2014. Secila objektivë strategjike e Planit Kombëtar të veprimit kundër braktisjes së shkollës ka aktivitetet kryesore, pastaj për secilin aktivitet janë të përcaktuara institucionet përgjegjëse realizuese, partnerët, afatet kohore, burimet e financimit, treguesit dhe mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit. Me gjithë planin mjaft ambicioz për parandalimin e braktisjes, zbatimi i tij në praktikë nuk është duke ecur sipas afateve kohore të parapara në të. Sa për ilustrim po veçojmë disa aktivitete, të cilat kanë qenë të parapara të përmbushën në vitin 2009 dhe nuk janë përmbushur: Emërimi i një zyrtari në MASHT për çështjen e braktisjes së shkollës; hartimi i Udhëzimit Administrativ për rishikimin e formularit për transferim të nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër dhe përcaktimi i masave ndëshkuese në rastet e braktisjes etj..

### 2.3. Përkrahja e donatorëve për parandalimin e braktisjes

Arsimi Parauniversitar në Kosovë në përgjithësi dhe arsimi profesional në veçanti kanë pasur mbështetje të fuqishme nga donatorë të ndryshëm, si UNICEF, Banka Botërore, GTZ, SWISS CONTACT, DANIDA, KOSVET, ETF, ...etj.

Mbështetja në ngritjen e cilësisë së arsimit në një vend mund të bëhet në forma dhe mjete të ndryshme, qoftë të drejtpërdrejta, qoftë të tërthorta. Çështja e shkollimit bën pjesë në të drejtën elementare të njeriut. Sigurimi i kësaj të drejte është detyrim kushtetues edhe i vendit tonë. Përkrahja në këtë fushë nuk ka munguar as në Kosovë. Investimi kryesor i donatorëve në fushën e përmirësimit të kushteve të shkollimit është orientuar në sigurimin e kushteve elementare për ndjekjen e shkollimit, duke investuar në infrastrukturë shkollore, në programe mësimore, zhvillim profesional të mësimdhënësve, etj.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, si subjekt shtetëror përgjegjës për sigurimin e të drejtës kushtetuese për arsim, me përkrahjen e donatorëve të ndryshëm që kanë mbështetur zhvillimin e arsimit në Kosovë,

ka hartuar dhe realizuar projekte dhe programe mbështetëse për parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit në Kosovë. Projektet dhe programet e ndryshme për parandalimin e braktisjes përfshijnë të gjitha nivelet e arsimit formal, edhe pse në to është përfshirë edhe arsimit joformal. Donatorët kanë mbështetur direkt apo indirekt çështjen e parandalimit të braktisjes së shkollës nga nxënësit në Kosovë.

Banka Botërore ka ndihmuar në fushën e parandalimit të braktisjes përmes Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (EPIP I dhe II), Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015, Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007/2017 etj.

UNICEF-i nga viti 1999 e këndej ka mbështetur arsimin në Kosovë në fusha të ndryshme, si në Zhvillimin e Kornizës së Re të Kurrikulit, e cila ishte bazë për zhvillimin e kurrikulave lëndore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, mandej në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, Arsimin me nevoja të veçanta, fëmijët e pakicave RAE, Zhvillimin e kurrikulave për arsimimin e të rriturve etj. Në mënyrë të veçantë, UNICEF-i ka kontribuar në parandalimin e braktisjes përmes përkrahjes në hulumtime të ndryshme, si:

- Pasqyra gjinore në sistemin arsimor në Kosovë (2003 )
- Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë (2004 )
- Arsimi për fëmijët minoritarë në Kosovë (2005)
- Regjistrimi dhe braktisja e shkollave nga vajzat në Kosovë (2004).

Organizatë tjetër, e cila e ka mbështetur dhe vazhdon ta mbështesë në veçanti arsimin profesional në Kosovë, është GTZ-ja, e cila përmes projekteve dhe programeve të ndryshme, si : Trajnimit e mësimdhënësve për hartimin e kurrikulave për arsimin dhe aftësimin profesional, Mbështetjen e grupeve punuese në hartimin e modeleve kurrikulave, (Programeve mësimore me organizimin e përmbajtjeve mësimore me bazë lëndore dhe modulare), në aftësimin e mësimdhënësve në bazat e metodikës dhe didaktikës (*Kursi bazik* dhe didaktika profesionale (*Kursi i avancuar*), në aftësimin e mësimdhënësve në hartimin e kartës DACUM (analiza e profesionit), në hartimin e procedurave për realizimin e provimit përfundimtar (Teoria dhe praktika profesionale), në trajnimin e mësimdhënësve për vlerësues dhe verifikues të brendshëm në vlerësimin e bazuar në kompetencë. Gjithashtu, një ndihme të veçantë GTZ-ja do të japë përmes programit të hartuar që ka të bëjë me arsimin joformal

dhe masat planifikuese për parandalimin e braktisjes së hershme të shkollës. DANIDA ka ofruar mbështetje për agrobiznes, në punësimin e të rinjve me qëllim të zvogëlimit të papunësisë<sup>11</sup>. ETF-i ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm të resurseve humane, ndihmon në promovimin e përfshirjes së Kosovës në raportim dhe bashkëpunim në kuadër të Kornizës së Kartelës Evropiane për SME, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve qeverisëse dhe administrative në reforma dhe në menaxhimin e ndryshimeve në fushën e politikës së punësimit. Hulumtimi “Braktisja e shkollës në arsimin profesional – karakteristikat e nxënësve potencialë për të braktisur shkollën” është realizuar gjithashtu në mbështetje të ETF-it, qëllimi i të cilit është ngritja e kapaciteteve të IPK-së për të nxjerrë rekomandime të mbështetura në dëshmi dhe të bazuara në fakte. Si rezultat i mbështetjes së donatorëve në fushën e arsimit, në përgjithësi, dhe parandalimin e braktisjes së shkollimit nga nxënësit, në veçanti, janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen disa projekte, të cilat pritet që të ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin e braktisjes, sidomos te nxënësit që janë potencialë për të braktisur shkollën. Kontributi i donatorëve në këtë fushë vërehet në:

- Trajnimit e shumicës së mësimdhënësve për arsim dhe aftësim profesional;
- Realizimin të hulumtimeve dhe studimeve të ndryshme për braktisjen që janë realizuar nga Banka Botërore, UNICEF-i, CESES;
- Nxjerrjen e rekomandimeve;
- Hartimin e strategjisë nga MASHT-i dhe dokumenteve të tjera përcjellëse.

## 2.4. Gjetjet nga hulumtimet e tjera

Braktisja e shkollimit në Kosovë është dukuri mjaft e shprehur dhe e ndjeshme. Për t’u njohur dhe për të plotësuar më mirë këtë fushë në kuadër të projektit të IPK&ETF, shfletuam dhe hulumtuam dokumentet dhe materialet e tjera në të cilat është trajtuar braktisja. Pothuajse në të gjitha studimet dhe hulumtimet e kësaj natyre të bëra deri më sot në Kosovë, braktisja paraqitet si dukuri e dëmshme shoqërore, sidomos për brezin e ri. Edhe pse nuk hasim në ndonjë hulumtim më specifik sa i përket arsimit profesional, të dhënat tregojnë për shqetësimet shoqërore për këtë dukuri.

<sup>11</sup> Papunësia konsiderohet një nga motivet e braktisjes së nxënësve nga shkolla.

Të dhënat, e marra nga MASHT-i dhe nga studimet e tjera tregojnë se përqindja e braktisjes rritet në vartësi me nivelin e shkollimit. Frekuencën më të lartë të braktisjes e hasim në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-të-12-të. “Megjithëkëtë, nuk ka një tendencë konstante të braktisjeve, pasi që ato ndryshojnë në bazë të kohës, gjinisë dhe përkatësisë etnike. Arsyt kryesore për braktisje të konstatuara në botimet e tjera të viteve të fundit në nivel fillor dhe atë të mesëm në Kosovë janë: *niveli i ulët i të ardhurave familjare, distanca e madhe prej shtëpisë në shkollë, sidomos mungesa e transportit, nevoja e familjeve për ndihmën e fëmijëve dhe besimi se fëmijët nuk mund të kenë kurrfarë dobie prej shkollimit.*<sup>12</sup>

Në vitin 2008, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në bashkëpunim me Ekipin Koordinues të Projektit PPPA II<sup>13</sup> dhe me financim të Bankës Botërore realizoi studimin: “Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë”. Në këtë studim janë përmbledhur të dhëna për çështjet që lidhen me braktisjen, faktorët që ndikojnë në braktisje dhe rekomandimet lidhur me parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Hulumtimi është shtrirë në pesë komuna të Kosovës. Është hartuar raporti i hulumtimit dhe është shpërndarë në institucione të ndryshme arsimore.

Rezultatet nga hulumtimet për braktisjen e shkollës nga nxënësit në Kosovë tregojnë se në të shumtën e rasteve braktisja e shkollës është më e shprehur në zonat rurale, nga fëmijët që vijnë prej familjeve me gjendje të rëndë sociale dhe nga fëmijët e komuniteteve RAE. Po ashtu, të dhënat tregojnë se braktisja më e madhe është evidentuar në kalimin nga niveli i shkollimit

<sup>12</sup> Instituti RINVEST (2009): , Arsimi joformal në Kosovë, hulumtimi dhe analiza e braktisjes nga arsimit i obliguar dhe arsimit i mesëm i lartë në Kosovë, Prishtinë, fq. 5

<sup>13</sup> PPPA – Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim i financuar nga Banka Botërore. Projekti është zhvilluar në dy faza: në fazën e parë: 2003-2005 dhe në fazën e dytë 2006-2008.

Projekti është përbërë nga tre komponentë:

1. Granti për zhvillimin e shkollës – ka ofruar financim për shkolla në mënyrë që të arrihet përmirësimi i qasjes/përfshirjes së nxënësve në shkollë dhe suksesit në arsim.
2. Sistemi informative për menaxhim të arsimit - ka ofruar ndihmë në forcim dhe qëndrueshmëri të të dhënave për nxënësit dhe shkollën.
3. Menaxhimi i projekteve – ka ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë shkollës në planifikim dhe menaxhim të projekteve.

Të gjitha shkollat e përfshira në PPPA janë përfshirë në trajnime profesionale për planifikim dhe menaxhim të projekteve shkollore. Projekti ka paraparë që pjesëmarrja e shkollave të jetë në bashkëpunim me komunitetin. Kjo ka bërë që të gjitha shkollat konkurruese në projekte, paraprakisht të themelojnë këshillin e shkollës, të caktojnë prioritetet e projekteve të shkollës dhe të bashkëpunojnë ngushtë me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të sigurojnë 5 % të shumës totale të projektit nga shkolla dhe komuniteti.

të mesëm të ulët në atë të mesëm të lartë, përkatësisht nga klasa e 9-të në klasën e 10-të. Hulumtimet e bëra nga UNICEF-i<sup>14</sup>, KEC-i<sup>15</sup> dhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në bashkëpunim me ekipin koordinues të projektit PPPA II, janë mjaft të rëndësishme, mirëpo nuk kanë arritur që në masë të kënaqshme ta adresojnë problematikën e braktisjes në Kosovë, përkatësisht ta zbusin ose ta ndërpresin atë, sepse rekomandimet e dala nga këto hulumtime nuk kanë mobilizuar në masë të duhur bartësit e arsimit në nivel qendror dhe lokal.

Sfidë e vazhdueshme në AAP në vitin 2004 ishte se numri i vajzave në shkolla profesionale ishte shumë i vogël, mësimdhënësit ishin kryesisht meshkuj, që nuk ishte një shembull i mirë për inkurajimin e femrës për pjesëmarrje në AAP, ekzistonte mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar dhe të trajnuar, kishte mungesë të infrastrukturës, përfshirë edhe anën praktike, kishte mungesë të të dhënave të mjaftueshme mbi situatën aktuale në Kosovë.<sup>16</sup>

Pikërisht mungesa e të dhënave relevante për shkaqet e braktisjes së shkollimit nga nxënësit në shkollat profesionale na shtyri që t’i qasemi këtij hulumtimi.

Njëri ndër treguesit për ekzistimin ose praninë e dukurisë së braktisjes së shkollës ishte edhe mosvijueshmëria e mësimimit ose numri i madh i mungesave të bëra nga nxënësit e këtij niveli të shkollimit.

Plani i veprimtimit i MASHT-it doli si rezultat i një hulumtimi që u bë për braktisjen e shkollës në Kosovë<sup>17</sup>. Sipas këtij hulumtimi, janë identifikuar këta faktorë të braktisjes së shkollës nga nxënësit:

- Kushtet e vështira ekonomike;
- Mungesa e kapaciteteve shkollore dhe infrastrukturës, veçanërisht mungesa e shkollave të mesme të larta;
- Distanca e gjatë e udhëtimit për nxënësit;
- Interesimi i ulët i nxënësve ose niveli i ulët i njohurive për profilet e caktuara në arsimin e mesëm të lartë;

<sup>14</sup> Fondi Emergjent Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara.

<sup>15</sup> Qendra për Arsim e Kosovës ka publikuar disa botime të veçanta, të cilat pasqyrojnë shkurtimisht edhe të dhënat për braktisjen e shkollës. Vlejnë të veçohen publikimet: *Arsimi në Kosovë: Shifra dhe Fakte’ (2000); Arsimi në Kosovë (2001);* Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës (2002).

<sup>16</sup> Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë, UNICEF, Prishtinë, janar 2004, fq. 20.

<sup>17</sup> Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë, 2008, fq. 10

- Vetëdijesimi i ulët i prindërve për rëndësinë e arsimit të mesëm dhe profileve arsimore në dispozicion.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara dhe nga diskutimet me zyrtarë arsimorë dhe me prindër, kemi këtë përmbledhje të vlerësimit të gjendjes ekzistuese sa i përket dukurisë së braktisjes në Kosovë: “Në përgjithësi institucionet arsimore janë të interesuara të merren seriozisht me problematikën e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Mirëpo, sistemi aktual i menaxhimit të arsimit nuk përcakton qartë përgjegjësit kryesorë që duhet të merren me këtë problematikë në mënyrë të vazhdueshme dhe për pasojë kemi qasje të momentit të trajtimit të problematikës.

Hulumtimet e bëra për braktisjen e shkollës kanë bërë që institucionet arsimore të sensibilizohen më shumë për trajtimin e kësaj dukurie. Mirëpo, hulumtimet e deritanishme janë të pakta dhe jo gjithëpërfshirëse. Kjo ka reflektuar në hartimin e projekteve të pjesshëm për parandalimin e braktisjes.”Mbetet shumë për t’u bërë në këtë fushë, në veçanti në çështjet specifike të saj, në mënyrë që të kemi rezultate të prekshme në praktikën tonë shkollore.”<sup>18</sup>

Trajtimet dhe gjetjet e deritashme në fushën e braktisjes së shkollimit nuk janë të kënaqshme. Kjo për faktin se kanë mbetur më tepër në nivelin e trajtimit kuantitativ të problemit dhe të konstatimit të prezencës së dukurisë. Qasja që i kemi bërë në hulumtim ndryshon nga qasjet e deritashme. Nuk janë trajtuar sa e si duhet edhe faktorët e tjerë të mundshëm për ndikim në rritjen e shkallës së braktisjes në Kosovë.

<sup>18</sup> H. Devetaku, S. Mehmeti, H. Zylfiu: “Braktisja e shkollimit nga nxënësit në Kosovë”, në Kërkime Pedagogjike, botim i Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2010, fq . 24-25

## Kapitulli III

### 3. Të dhënat për nxënësit dhe mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim

Të dhënat hyrëse që do të ofrohen në këtë kapitull për nxënësit e përfshirë në hulumtim janë të dhëna për: gjininë, moshën e nxënësve, arsimimin dhe punësimin e prindërve, vendbanimin e nxënësve dhe distancën e udhëtimit deri në shkollë. Kurse të dhënat hyrëse për mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim që do të prezantohen në vijim përfshijnë gjininë dhe moshën e mësimdhënësve, kualifikimin, përvojën në mësimdhënie dhe përfshirjen në trajnime.

#### 3.1. Nxënësit

Nxënësit e përfshirë në hulumtim i takojnë klasave të 10-ta të shkollave profesionale të Kosovës, të përzgjedhura si mostër për realizimin e këtij hulumtimi. Janë 334 nxënës të përfshirë në hulumtim, mirëpo disa prej tyre nuk i kanë plotësuar të gjitha të dhënat hyrëse të tyre. Analiza e të dhënave hyrëse sjellë të dhëna për karakteristikat e lartshënuara me dallime në numër, varësisht sa i kanë plotësuar ata.

*Profilet arsimore dhe numri i nxënësve të përfshirë në hulumtim.* Shkollat profesionale në Kosovë janë të profileve të ndryshme, disa nga shkollat janë të përziera. Ekipi hulumtues nuk ka pasur kritere se në cilat profile arsimore të realizohet hulumtimi, mirëpo me qëllim që të shohim profilet arsimore dhe numrin e nxënësve nga këto profile që janë përfshirë në hulumtim, kemi përgatitur tabelën në vijim.

Profili arsimor	Numri i nxënësve të përfshirë në hulumtim - sipas profileve	%
Administrim biznesi	32	10
Banka dhe sigurime	39	12
Gjeodezi	34	10
Hortikulturë	27	8
Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	15	5
Informatikë	40	12
Komunikacion rrugorë	38	11
Metalpunues	18	5
Metalurgji	36	11
Operator prodhimi	24	7
Teknik i Ndërtimtarisë	15	4
Veterinari	16	5
<b>Totali</b>	<b>334</b>	

Tabela.3.1. Profilet arsimore të nxënësve të përfshirë në hulumtim, numri i nxënësve, /përqindja

Mosha dhe gjinia e nxënësve të përfshirë në hulumtim. Jemi përcaktuar që të marrim të dhëna për moshën dhe gjininë e nxënësve me qëllim të krahasimit dhe gjetjes së nxënësve që janë në rrezik më të madh për të braktisur shkollën. Nga të dhënat e fituara mbi moshën e nxënësve të përfshirë në hulumtim ( tab. 3.2.) shohim se nga 322 nxënës sa i janë përgjigjur kërkesës në pyetësor lidhur me këtë karakteristikë në këto klasa, përqindja më e lartë e nxënësve është ajo e moshës 16-vjeçare, me mbi 57% ose 185 nxënës. Të dhënat e plota i prezanton tabela në vijim:

Moshë e nxënësve të klasës së 10-të	Numri Sipas moshës	%	Sipas gjinisë			
			M	%	F	%
15 vjeç	40	12	25	11	15	15
16 vjeç	185	58	123	55	62	63
17 vjeç	84	26	64	28	20	20
18 vjeç	10	3	8	4	2	2
19 vjeç	1	0.3	1	1	0	-
20 vjeç	1	0.3	1	0.50	0	-
24 vjeç	1	0.3	1	0.50	0	-
<b>Totali</b>	<b>322</b>	<b>100</b>	<b>223</b>	<b>69<sup>19</sup></b>	<b>99</b>	<b>31<sup>20</sup></b>

Tabela.3.2. Moshë dhe gjinia e nxënësve të përfshirë në hulumtim

<sup>19</sup> Tregon përqindjen e nxjerrë me numrin e totalit të nxënësve që kanë dhënë përgjigje për moshën dhe gjininë.

<sup>20</sup> Sqarimi – si në fosnotën paraprake.

Sa i përket gjinisë së nxënësve të përfshirë në hulumtim, shihet se në klasat e përfshira në hulumtim moshë e nxënësve të gjinisë mashkullore varion nga 15 deri në 21 vjeç (me dominim të asaj 16-vjeçare me 55%), ndërsa moshë e nxënësve të gjinisë femërore përfshihet brenda 15 dhe 18 vjeç (gjithashtu me dominim të moshës 16 vjeç me 62%).

Shkalla e arsimimit dhe punësimit të prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim. Prindërit janë faktorë më rëndësi për përkrahjen e fëmijëve në jetë në përgjithësi dhe në shkollimin e tyre në veçanti. Për të nxjerrë dallimet e shkallës së arsimimit dhe punësimit të prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim, kemi shtruar pyetje në pyetësorin për nxënës, në pjesën e parë të tij, të dhënat e përgjithshme, ku kemi kërkuar prej nxënësve të japin përgjigje për shkallën e arsimimit të të dy prindërve dhe të punësimit të tyre. Të dhënat tregojnë dallime të dukshme në shkallën e arsimimit të prindërve dhe veçmas në punësim.

Tabela në vijim sjellë dallimet për këto dy aspekte.

Shkalla e arsimimit	Nëna	Babai
E lartë	13 %	29 %
E mesme	44 %	57 %
Fillore	38 %	13 %
pa arsimuar	5 %	2 %
<b>Total</b>	<b>314</b> nxënës kanë dhënë përgjigje për shkallën e arsimimit të nënës	<b>320</b> nxënës kanë dhënë përgjigje për shkallën e arsimimit të babës
<b>Punësimi</b>	<b>Nëna</b>	<b>Baba</b>
Po	19 %	73 %
Jo	81 %	27%
<b>Totali</b>	<b>272</b> nxënës kanë dhënë përgjigje për punësimin e nënës	<b>294</b> nxënës kanë dhënë përgjigje për punësimin e babës

Tabela 3.3. Niveli i arsimimit të prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim

Dallimet janë të evidentuara edhe në punësimin e prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim, ku sipas tabelës 3.3, mbi 73% e baballarëve janë të punësuar, ndërsa tek nënat kjo shifër arrin vetëm në 19%. Ky raport jo i barabartë i shkallës së punësimit të prindërve (klasifikuar në gjini), me siguri që, ndër të tjera, është pasojë edhe e nivelit jo të barabartë të shkollimit të tyre.



*Distanca e udhëtimit të nxënësve për në shkollë dhe vendbanimi.* Distanca e udhëtimit të nxënësve për në shkollë (dhe anasjelltas) gjithmonë ka luajtur një rol me rëndësi në vijueshmërinë e rregullt të mësimit nga ana e nxënësve. Nga analiza e të dhënave të fituara përmes pyetësorëve, shihet se 212 nxënës ose mbi 69% e nxënësve të përfshirë në hulumtim janë nga fshatrat, ndërsa përafërsisht 30% e tyre janë nxënës me vendbanim në qytet. Dallimet më të theksuara sa i përket distancës së udhëtimit për në shkollë janë tek ajo 7-10 km dhe mbi 10 km, ku 64 % e nxënësve me vendbanim në fshatra janë të detyruar ta bëjnë këtë udhëtim çdo ditë për të vijuar rregullisht mësimin, ndërsa nga nxënësit me vendbanim në qytet këtë distancë e kalojnë vetëm 9%. Mbi 64% e tyre (nxënësve me vendbanim në qytet) distanca shkollë – shtëpi shënon 1-3 km.

Distanca shkollë-shtëpi	Numri i nxënësve			
	Fshat		Qytet	
1-3 km	26	12%	59	64%
4 - 6 km	50	24%	20	22%
7 - 10 km	59	27%	8	9%
Mbi 10 km	77	36%	5	5%
Total:	<b>212</b>		<b>92</b>	

Tabela.3.4. Distanca e udhëtimit të nxënësve për në shkollë

### 3. 2. Mësimdhënësit

Shumica e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim janë mësimdhënës në klasat e 10-ta, mirëpo në mesin e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim ka mësimdhënës që japin mësim edhe në klasat e tjera (11-të, 12-të,13-të). Njëjtë sikur për nxënës, edhe analiza e të dhënave hyrëse të mësimdhënësve sjellë të dhëna me dallime në numër, varësisht se si janë përgjigjur mësimdhënësit në pyetësin e tyre.

*Gjinia, moshë dhe kualifikimi i mësimdhënësve.* Janë karakteristika që reflektojnë në punën e mësimdhënësve, prandaj i kemi vendosur në pyetësin e mësimdhënësve, me qëllim të nxjerrjes së dallimeve eventuale në përgjigjet e mësimdhënësve për aspektet e ndërlidhura me braktisjen, të specifikuar në pyetësin e tyre. Tabela në vijim pasqyron gjininë, moshën dhe kualifikimin e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim.

Gjinia dhe moshë			
Gjinia	Moshë	Numri i mësimdhënësve	
		Numri	%
F	21-30	7	24
	31-40	7	24
	41-50	10	34
	51-60	5	17
Totali F		29	36
M	21-30	7	14
	31-40	10	20
	41-50	19	37
	51-60	13	25
	Mbi 60	2	4
Totali M		51	64
Totali M & F		80	

Tabela. 3.5. Gjinia dhe moshë e mësimdhënësve

Siç shihet nga të dhënat e tabelës, numri i mësimdhënësve meshkuj është dominues krahasuar me numrin e mësimdhënësve femra, të dhëna këto që afërsisht përputhen edhe me statistikat kombëtare të mësimdhënësve në arsimin profesional<sup>21</sup>. Përfshirë të dy gjinitë, shumica e mësimdhënësve i takon moshës 41-50 vjeçare. Nga 80 mësimdhënës në total sa kanë dhënë përgjigje për këto karakteristika, 2 prej tyre kanë të përfunduar nivelin MASTER të shkollimit, 61 Fakultetin, kurse 17 SHLP-në.

Tabela në vijim pasqyron dallimet e kualifikimit të mësimdhënësve sipas gjinisë:

Kualifikimi								
Gjinia	Master (numri)	%	Fakulteti (numri)	%	SHLP (numri)	%	Gjithsej	
							Numri	%
F	0		23	79	6	21	29	36
M	2	4	38	74	11	22	51	64
Totali M & F	2	3	61	76	17	21	80	100

Tabela. 3.5.1. Gjinia dhe kualifikimi i mësimdhënësve

*Përvoja e punës së mësimdhënësve dhe moshë.* Përvojën e punës së mësimdhënësve e kemi ndarë në katër shkallë: 0 – 1 vjet, 2-10 vjet, 11-20 vjet dhe mbi 20 vjet, duke e krahasuar me moshën e mësimdhënësve. Nga

<sup>21</sup> Më gjerësisht, shih statistikat e arsimit në Kosovë 2009/2010 për mësimdhënësit e arsimit të mesëm të lartë.

80 mësime të përfshirë në hulumtim, që kanë dhënë karakteristikat e tyre mbi përvojën e punës dhe moshën, 7 janë me 1 vjet përvojë pune, 20 janë me 2-10 vjet përvojë pune, 20 janë me 11-20 vjet përvojë pune dhe 33 janë me mbi 20 vjet përvojë pune. Nga këto të dhëna shohim se dominojnë mësime të përfshirë me përvojë pune mbi 20 vjet, sidomos krahasuar me mësime të përfshirë fillestarë, që kanë përvojë pune 0-1 vjet. Të dhënat sipas përvojës së punës së mësime të përfshirë në raport me moshën kalendarike të tyre prezantohen në tabelën në vijim.

Përvoja e punës	Moshë						
	21-30	31-40	41-50	51-60	Mbi 60vjeç	Gjithsej	
	%	%	%	%	%	Nr	%
0-1 vjet	57	43	0	0	0	7	9
2-10 vjet	30	40	15	15	0	20	25
11-20 vjet	10	25	45	20	0	20	25
Mbi 20 vjet	0	9	52	33	6	33	41
<b>Totali</b>	15	24	36	23	3	80	100

Tabela 3.5.2. Përvoja e punës dhe moshë e mësime të përfshirë

Të dhënat nga tabela tregojnë se mbi 41 % e mësime të përfshirë kanë mbi 20 vjet përvojë pune, ndërsa numri i mësime të përfshirë që kanë përvojë të punës nga 2 – 10 vjet dhe 11 – 20 vjet është i njëjtë. Afër 9% e mësime të përfshirë në hulumtim janë në vitin e parë të përvojës së tyre, 3 prej tyre ose 4%, edhe pse janë në moshë ndërmjet 31- 40 vjet, e kanë vitin e parë të përvojës së punës me nxënësit.

*Trajnimet e mësime të përfshirë.* Trajnimet e mësime të përfshirë janë pjesë e zhvillimit profesional të tyre. Për të parë programet trajnuese, të cilat i kanë ndjekur mësime të përfshirë në hulumtim, në pyetësor mësime të përfshirë u kemi dhënë mundësinë të shënojnë deri në tri programe të trajnimit. Sintezë e bërë trajnimeve të mësime të përfshirë në hulumtim sjellë këto të dhëna:

Përfshirja në trajnime	Totali	% <sup>22</sup>
Didaktikë - metodikë	35	44
Didaktikë profesionale	25	31
ECDL	15	19
MNQ	8	10
Trajnimet metodologjike të nivelit fillestar nga MASHT-i	20	25
Udhëheqje arsimore	6	8
Aftësimi modular (praktikë profesionale)	9	11
EBCL	3	4
<b>Totali</b>	121	

Tabela.3.5.3. Gjinia, moshë dhe kualifikimi i mësime të përfshirë

Sic shihet nga tabela 3.5.3, janë dy programe të trajnimit të ofruara nga GTZ-ja, që në shkallë më të lartë janë të ndjekura nga mësime të përfshirë në hulumtim: Didaktikë – metodikë me 44% të mësime të përfshirë, dhe Didaktikë profesionale me 31% të mësime të përfshirë. Grupi i tretë janë mësime të përfshirë që kanë ndjekur trajnimet metodologjike të nivelit fillestar të ofruara nga MASHT-i, me 25%. Programi i ECDL-it është programi i radhës që më së shumti e kanë ndjekur mësime të përfshirë në hulumtim, 19%. Programet e tjera trajnuese janë më pak të ndjekura në mësime të përfshirë në hulumtim.

<sup>22</sup> Përqindja e numrit të mësime të përfshirë në trajnime është nxjerrë me numrin 80, sepse ky është numri i mësime të përfshirë që kryesisht i kanë plotësuar shumicën e pyetjeve në pyetësorin e tyre, ndërsa numri 121 tregon edhe mësime të përfshirë që kanë ndjekur më shumë se një program trajnimi.

## Kapitulli IV

### 4. Shkalla e kënaqësisë së nxënësve dhe mësimdhënësve me shkollën

Në këtë kapitull do të trajtohet shkalla e kënaqësisë së nxënësve me shkollën, e reflektuar nga nxënësit për mënyrat e zgjedhjes së drejtimit/shkollës, arsyet më kryesore të zgjedhjes së drejtimit/shkollës, mënyrat e informimit të nxënësve për zgjedhjen e profilit arsimor, shkallën e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës dhe profilit arsimor, shkallën e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës në raport me mënyrën e zgjedhjes, shkallën e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të lidhura me procesin mësimor, me raportet me mësimdhënës, me vlerësimin e arritjeve, etj.

Po ashtu, në këtë kapitull ofrohen tregues për shkallën e kënaqësisë së mësimdhënësve me planin dhe programin mësimor, motivimin e nxënësve në klasë, klimën që krijohet në klasë, dallimet në mësim dhe sjellje të nxënësve, kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia, aplikimin e teknologjisë së re të mësimdhënies dhe motivimin e mësimdhënësve për punë me nxënës.

#### 4.1. Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me përzgjedhjen e shkollës dhe profilit arsimor

Ndër faktorët me rëndësi për arritjen e suksesit në mësim, por edhe për vazhdimin e shkollimit nga ana e nxënësve, është shkalla e kënaqësisë së tyre me shkollën dhe profilin të cilin e kanë zgjedhur si profesion të ardhshëm. Me qëllim të marrjes së informacioneve nga ana e nxënësve për këtë aspekt, i cili do të mund të ishte edhe shkak për braktisjen apo vazhdimin e shkollës, nxënësve iu parashtrua pyetjet sikur në tabelën në vijim.

Shkalla e kënaqësisë	Numri i nxënësve	%
Aspak i kënaqur	5	2
Pak i kënaqur	14	4
Mesatarisht i kënaqur	46	14
I kënaqur	97	29
Shumë i kënaqur	170	51
<b>Totali</b>	<b>332</b>	<b>100</b>

Tabela 4. Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës dhe profilit arsimor

Nga tabela e dhënë pas përpunimit të pyetësorëve të hulumtimit kemi këto rezultate: Nga gjithsej 332 nxënës të anketuar, 51% e tyre deklarojnë se janë shumë të kënaqur me zgjedhjen e shkollës dhe të profilit arsimor, ndërsa vetëm 2% prej tyre nuk janë aspak të kënaqur me këtë zgjedhje. Nëse vetëm pak më shumë se gjysma e nxënësve janë shumë të kënaqur me zgjedhjen e shkollës dhe profilit, atëherë del se pjesa tjetër, në rastin tonë 20%, nuk kanë bërë zgjidhje të mirë të shkollës dhe të profesionit, sidomos 6% e nxënësve që nuk janë aspak të kënaqur ose pak të kënaqur. Shkallën e kënaqësisë së nxënësve me zgjedhjen e shkollës dhe të profilit arsimor e kemi ndërlidhur edhe me mënyrën e zgjedhjes së shkollës dhe të profilit. Këtë e kemi bërë me qëllim që të krahasojmë përgjigjet e nxënësve që kanë deklaruar se vetë e kanë bërë zgjedhjen e shkollës dhe të profilit arsimor, e kanë zgjedhur me prindërit, apo se ka qenë mundësia e vetme për të zgjedhur. Në tabelën në vijim janë dhënë aspekte të tjera më konkrete të shprehjes së kënaqësisë/pakënaqësisë së nxënësve lidhur me mënyrën e zgjedhjes së profilit dhe të shkollës.

Mënyrat e zgjedhjes	Shkalla e kënaqësisë me zgjedhjen e profilin dhe të shkollës				
	Aspak i kënaqur	Pak i kënaqur	Mesatarisht i kënaqur	i/e kënaqur	Shumë i/e kënaqur
↓					
Ishte zgjedhja e fundit	8%	18%	27%	25%	22%
Prindërit ma kanë zgjedhur	0%	9%	18%	18%	55%
E kam zgjidhur në bashkëpunim me prindër	0%	2%	14%	24%	61%
Kjo ishte zgjedhja ime e dëshiruar	1%	1%	9%	35%	54%

Tabela 4.1. Shkallës e kënaqësisë së nxënësve me profilin dhe shkollën në raport me mënyrën e zgjedhjes

Të dhënat nga tabela 4.1. tregojnë se ka dallime të shkallës së kënaqësisë me zgjedhjen e shkollës dhe profilin arsimor në mes të mënyrave të zgjedhjes. Në pyetësorë, 109 nxënës ose 33% janë përgjigjur se shkollën dhe profilin e kanë zgjedhur në bashkëpunim me prindër. Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqësisë së tyre me këtë mënyrë të zgjedhjes janë përgjigjur kështu: 61% prej tyre janë shumë të kënaqur, 24% janë të kënaqur, 14% mesatarisht të kënaqur dhe 2% prej tyre pak të kënaqur. Nga 51 nxënës ose 15% e tyre që kanë dhënë përgjigje *ishte zgjedhja ime e fundit*, vetëm 22% e tyre janë shumë të kënaqur, 25% të kënaqur dhe 27% mesatarisht të kënaqur, kurse aspak të kënaqur me këtë aspekt janë 8% e tyre.

Sa i përket *zgjedhjes me dëshirë të shkollës dhe të profilin*, e cila mendojmë se do të ishte zgjedhja më e mirë e mundshme, kemi këtë nivel të kënaqësisë së nxënësve të përfshirë në mostrën e hulumtimit. Shumë të kënaqur janë 54% , të kënaqur janë 35% e nxënësve, ndërsa më pak të kënaqur janë mbi 2 % e nxënësve. Në alternativën tjetër lidhur me zgjedhjen e profilin dhe të shkollës nga ana e prindërve janë dhënë vetëm 11 përgjigje. Prej tyre 6 ose 55% deklarojnë se janë shumë të kënaqur dhe pesë të tjerë janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur në nivel të duhur. Kjo tregon se kemi nivel të ulët të ndikimit të prindërve në zgjedhjen e shkollës dhe të profilin arsimor të fëmijëve të tyre. Te kjo pyetje shihet një laramani sa i përket informimit të nxënësve për orientim profesional.

Po ashtu, këto të dhëna më se miri pasqyrohen në figurën në vijim.




Figura 4.1. Shkallës e kënaqësisë së nxënësve me profilin dhe shkollën në raport me mënyrën e zgjedhjes

## 4.2. Shkalla e kënaqësisë me aspekte të procesit mësimor

Suksesi i nxënësve në mësim, vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive në shkollë në masë shumë të madhe varen nga shkalla e kënaqësisë së nxënësve me procesin mësimor. Andaj e kemi hulumtuar shkallën e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të procesit mësimor. Tabela në vijim pasqyron aspekte që lidhen me procesin mësimor të hulumtuara dhe rezultatet e fituara lidhur me shkallën e kënaqësisë së nxënësve me aspektet fizike dhe të përmbajtjes së asaj që hynë në cilësinë e mësimnxënies.

Aspekte të lidhura me procesin mësimor	Vlerësimi					Totali
	1	2	3	4	5	
a) Planin dhe programin mësimor	4	5	37	41	196	283
b) Mësimdhënësit	4	21	36	64	178	303
c) Ambientin shkollor (sjelljet, dhunën, dukuritë negative)	32	36	82	79	72	301
d) Numrin e nxënësve në klasë	36	25	77	59	99	296
e) Perspektivën	5	20	58	91	117	291
f) Kushtet e shkollimit	23	15	67	76	113	294

Tabela 4.2.: Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të lidhura me procesin mësimor, (1= shkallë e ulët e kënaqësisë, 5 = shkallë e lartë e kënaqësisë)

Nga nxënësit është kërkuar që të vlerësojnë me shkallën numerike 1-5 nivelin e kënaqësisë së tyre me secilin aspekt të vendosur në tabelë. Nga të dhënat numerike në tabelë shihet se me planin dhe programin mësimor, shumë të kënaqur janë 69% nga 283 nxënës të përfshirë në hulumtim. Të kënaqur (vlerësimi me 4) janë 14%, më pak të kënaqur (vlerësimi me 3) 13%, ndërsa me vlerësimin 2 dhe 1 ky aspekt i procesit mësimor është vlerësuar vetëm nga 3%, nga 283 nxënës që kanë dhënë vlerësimet e tyre lidhur me këtë aspekt të procesit mësimor.

Afërsisht vlerësim të ngjashëm kemi edhe me shkallën e vlerësimit të mësimdhënësve. Nga 303 nxënës sa kanë dhënë vlerësimet e tyre për këtë aspekt të lidhur me procesin mësimor, me notën 5 vlerësojnë 59%, me 4 vlerësojnë 21%, me 3 kemi 12%, si dhe me notën 2 kemi 7% e nxënësve të anketuar. Por edhe me nivelin 1 kemi rreth 1%.

Sa i përket vlerësimit të ambientit shkollor (sjelljet, dhunën dhe dukuritë negative), mund të themi se kemi një vlerësim shumë real ose të balancuar, i cili mund të merret edhe si tregues i mundshëm për ndikim në braktisjen e shkollimit dhe në suksesin e ulët të tyre. Kështu, nga 301 nxënës sa kanë dhënë vlerësimet e tyre për këtë aspekt, kemi këtë pasqyrë të vlerësimeve: me 5 kemi 24%, me 4 kanë vlerësuar 26%, me 3 kemi 27%, me vlerën 2 kemi 12% dhe me 1 kemi 11% nga 301 nxënës sa janë përgjigjur në këtë alternativë.

Sa i përket aspektit tjetër që ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së kënaqësisë së nxënësve, me numrin e nxënësve në klasë, edhe këtu kemi një vlerësim shumë të balancuar. Kështu nga 296 nxënës sa kanë dhënë vlerësimet e tyre për këtë aspekt, me notën 5 vlerësojnë 33%, me 4 vlerësojnë 20%, me 3 kemi 26%, si dhe me notën 2 gjithsej 8% dhe me notën 1 kemi 12% e nxënësve.

Një aspekt i veçantë dhe me ndikim në mësimnxënie dhe braktisje të shkollimit është edhe ai i perspektivës së shkollimit. Më pak se gjysma e nxënësve e vlerësojnë me notën 5 perspektivën e shkollimit, gjithsej 117 ose 40% nga 291 nxënës, me 4 vlerësojnë 31% prej tyre, ndërsa 20% vlerësojnë me 3, kurse me 2 7% dhe rreth 2%, me 1 që nuk shohin ndonjë perspektivë nga shkolla dhe profili i zgjedhur ose profesioni i tyre i ardhshëm. Një kërkesë e pyetësorit ishte edhe për shprehjen e shkallës së kënaqësisë me kushtet e shkollimit dhe kemi fituar këto rezultate. Nga 293 nxënës të anketuar, me notën 5 i vlerësojnë kushtet e shkollimit 38% prej tyre. Me katër 4 kemi 26% prej tyre, 23% vlerësojnë me 3, rreth 5% vlerësojnë me 2 si dhe 8% me 1.

### 4.3. Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me raportet me mësimdhënës

Ndër faktorët e rëndësishëm për shprehjen e ndjenjës së kënaqësisë, pakënaqësisë së nxënësve në shkollë, paraqet edhe raporti i komunikimit të dyanshëm nxënës-mësues. Këtë nivel e kemi hulumtuar nëpërmjet të pyetjes me alternativa për këto aspekte të komunikimit të nxënësve me mësuesit e tyre: *Mund të bisedoj lirshëm me mësimdhënës për problemet e mia; Kam dëshirë të kem profesor tjetër; Profesorët i marrin seriozisht kërkesat e mia, Jam i kënaqur me atë që na ofrojnë profesorët*, si dhe më mundësinë për të plotësuar vetë nxënësit. Për secilën alternativë nxënësve u është kërkuar të japin vlerësimin e tyre nga 1 (shkallë e ulët e kënaqësisë) deri në 5 (shkallë e lartë e kënaqësisë).

Nga gjithsej 302 nxënës sa janë përgjigjur në këtë pyetje, vetëm 51% e vlerësojnë me notën 5 *mundësinë e bisedimit lirshëm me mësimdhënës* për problemet e veta. Ndërsa 20% këtë e vlerësojnë me 4, 11% me 3 dhe 8% me 2, ndërsa 12% nuk janë të kënaqur me mundësinë e komunikimit me mësimdhënësit për problemet e tyre. Nga gjithsej 286, 48% vlerësojnë me 1 dëshirën për të pasur mësues tjetër, 9% vlerësojnë me 2 këtë, 14% me 4 me 4 dhe 20% shprehin shkallë të lartë të dëshirës për të pasur profesor të tjerë.

Seriozitetin e profesorëve për t'u marrë me kërkesat e tyre ata e shprehin kështu: 42% nga 291 e vlerësojnë me notën 5 seriozitetin e profesorëve, 19% me 4, 18% me 3, por 10% vlerësojnë me 2, si dhe 12% prej tyre me 1, që është shkallë e lartë e shprehjes së nivelit të ulët të pakënaqësisë me shkallën e seriozitetit të profesorëve për t'u marrë me problemet e nxënësve. Sa i përket alternativës *Jam i kënaqur me atë që na ofrojnë profesorët*, si dhe alternativës *tjetër*, mendojmë se nuk janë tregues shumë realë për raportin dhe shkallën e kënaqësisë së nxënësve me profesorët e tyre. Këtu shihet se nga 314 nxënës, 66% prej tyre vlerësojnë me notën 5, pra shkallë e lartë e kënaqësisë me atë që ofrojnë profesorët për ta, por pa specifikuar se çfarë ju ofrojnë ata, mësimdhënie cilësore, me të cilën më lart nuk e kanë treguar këtë shkallë kënaqësie, mundësi bisedimi për trajtimin e problemeve individuale apo të tjera. Ndërsa vetëm 5% e tyre vlerësojnë me notën 1, pra jo të kënaqur me atë çfarë ofrojnë profesorët e tyre.

Tabela në vijim pasqyron aspektet e hulumtuara për raportet e nxënësve me mësimdhënës dhe rezultatet e fituara lidhur me shkallën e kënaqësisë së nxënësve me raportet me mësimdhënës.

Aspekte të lidhura me raportet me mësimdhënësin	1	2	3	4	5	Totali
a) Mund të bisedoj lirshëm me mësimdhënësin për problemet e mia	12%	8%	11%	20%	51%	302
b) Kam dëshirë të kem profesor tjetër	48%	9%	14%	8%	20%	286
c) Profesorët i marrin seriozisht kërkesat e mia	12%	10%	18%	19%	42%	291
d) Jam i kënaqur me atë që na ofrojnë profesorët	5%	5%	9%	15%	66%	314

Tabela 4.3.: Shkalla e vlerësimit të nxënësve për raportet e tyre me mësimdhënësin

#### 4.4. Shkalla e kënaqësisë së nxënësve me procesin e vlerësimit të arritjeve

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve reflekton në mënyra të ndryshme të nxënësit. Vlerësimi i bazuar në parime dhe kritere ndikon pozitivisht të nxënësit, ndërsa vlerësimi që nuk mbështetet në parimet dhe kriteret e vlerësimit ndikon negativisht të nxënësit dhe në raste të veçanta mund të nxisë braktisjen e shkollës nga nxënësit.

Shkallën e kënaqësisë së nxënësve me disa aspekte të vlerësimit e kemi hulumtuar nëpërmjet tabelës me pesë aspekte të lidhura me vlerësimin dhe shkallën për vlerësimin e këtyre aspekteve. Tabela në vijim pasqyron aspektet e hulumtuara për shkallën e kënaqësisë së nxënësve me procesin e vlerësimit të arritjeve dhe rezultatet e fituara.

Aspekte të lidhura me vlerësimin	1	2	3	4	5	Totali
a) Planifikimin e vlerësimit	3%	6%	18%	31%	42%	295
b) Kriteret e vlerësimit	3%	8%	22%	30%	37%	290
c) Vlerësimin e bazuar në fakte dhe objektiva	4%	8%	24%	22%	41%	289
d) Vlerësimi që mbështetet në mësimet të mësuara në klasë	1%	7%	14%	20%	58%	291
e) Vlerësimi që ndihmon në intervenimin për përmirësim të rezultateve të nxënësve	15%	5%	13%	22%	45%	288

Tabela 4.4.: Aspektet e lidhura me vlerësimin dhe shkalla e kënaqësisë së nxënësve

Nga të dhënat e tabelës 4.5. shohim se me *planifikimin e vlerësimit* 42% e nxënësve janë shumë të kënaqur (kanë vlerësuar me 5), nga 295 sa kanë dhënë përgjigje. Po për këtë aspekt me 4 kanë vlerësuar 31% prej tyre, me 3 kanë vlerësuar 18% e nxënësve, kurse 6% kanë vlerësuar me 2 dhe 1, që tregojnë shkallë të ulët të kënaqësisë me planifikimin e vlerësimit.

Me *kriteret e vlerësimit*, shkallë të ulët të kënaqësisë kanë shprehur 9 nxënës 3% nga 290 nxënës sa kanë dhënë përgjigje për këtë aspekt të vlerësimit, me 2 po ashtu nivel të ulët të kënaqësisë kanë shprehur 8% nga 290 nxënës, 22% janë mesatarisht të kënaqur ose vlerësimi më 3, derisa 30% vlerësojnë me 4 si dhe 37% e nxënësve të anketuar vlerësojnë me 5, çka tregojnë shkallë të lartë të kënaqësisë me kriteret e vlerësimit nga ana e profesorëve të tyre.

Sa i përket alternativës së vlerësimit, *vlerësimi i bazuar në fakte dhe objektiva*, kemi një vlerësim sa të shkapërderdhur. Nga 289, 4% kanë shprehur pakënaqësi të thellë (1), ndërsa 41% prej tyre kanë shprehur shkallë të lartë të kënaqësisë lidhur me këtë aspekt të vlerësimit. Në alternativën nën d kemi një vlerësim pak më ndryshe se sa alternativa nën c. Shkallë më të ulët të kënaqësisë kanë shprehur vetëm 1% e nxënësve, ndërsa shkallë më të lartë të kënaqësisë (5) kanë shprehur gjithsej 170 ose 58% e nxënësve. Një tregues me rëndësi këtu është alternativa nën c, ku 15% nga 288 nxënës kanë shprehur shkallë të lartë të pakënaqësisë. Nëse kësaj i shtohet edhe grupi tjetër prej 5% e nxënësve të cilët gjithashtu tregojnë shkallë të ulët të kënaqësisë me këtë aspekt të vlerësimit, atëherë shihet sa gati 1/3 e nxënësve nuk janë të kënaqur me këtë aspekt të vlerësimit, pa marrë parasysh që 45% prej tyre vlerësojnë me 5 vlerësimin që ata i ndihmon për përmirësimin e rezultateve mësimore. Këtu ndoshta mund të kërkohej edhe tregues me rëndësi që ndikojnë në shkallën e braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve në shkollimin e mesëm profesional.

#### 4.5. Shkalla e kënaqësisë së mësimdhënëseve me procesin mësimor

Procesi mësimor lidhet ngushtë me të gjithë faktorët e bashkëpunimit, si me nxënësit, mësimdhënësit, drejtuesit e shkollës, prindërit etj. Pa dyshim mësimdhënësit janë faktorë kyçë në procesin mësimor. Shkalla e kënaqësisë së tyre me planin dhe programin mësimor, motivimin e nxënësve në klasë, klimën që krijohet në klasë, dallimet në mësim dhe sjellje të nxënësve, kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia, aplikimin e teknologjisë së re të

mësimdhënies dhe motivimin e mësimdhënësve për punë me nxënës është hulumtuar nëpërmjet vlerësimit të vetë mësimdhënësve.

Aspektet e lidhura me procesin mësimor	Vlerësimi					Totali
	1	2	3	4	5	
Planin dhe programin mësimor	0%	8%	29%	43%	21%	<b>80</b>
Motivimin e nxënësve në klasë	1%	9%	36%	42%	12%	<b>81</b>
Klimën që krijohet në klasë	1%	3%	27%	39%	30%	<b>77</b>
Dallimin intelektual të nxënësve	0%	11%	39%	30%	19%	<b>79</b>
Sjelljet e nxënësve	1%	18%	33%	41%	8%	<b>79</b>
Kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia	5%	16%	45%	21%	13%	<b>76</b>
Aplikimin e teknologjisë së re të mësimdhënies (Grafoskopi, videobimi, DVD etj).	35%	21%	13%	13%	18%	<b>77</b>
Motivimin tuaj për punë me nxënës	5%	1%	11%	41%	42%	<b>76</b>

Tabela 4.5.: Aspektet e lidhura me procesin mësimor dhe shkalla e kënaqësisë së mësimdhënësve

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë (tabela 4.5.), shohim se mësimdhënësit shkallën më të lartë të kënaqësisë e kanë me *motivimin e tyre për punë me nxënës*, për këtë aspekt 42% e mësimdhënësve janë shumë të kënaqur dhe 41% e mësimdhënësve janë të kënaqur.

Me *klimën që krijohet në klasë* nuk janë shumë të kënaqur afro 39% e mësimdhënësve. Ndërsa rreth 30% prej tyre janë shumë të kënaqur.

Edhe sa i përket dallimit intelektual të nxënësve në klasë kemi gati të njëjtin vlerësim/kënaqësi të mësimdhënësve. Kjo shihet edhe në grafikun nr. 2, dominon shkalla e vlerësimit 3 dhe 4 ose 39% dhe 30%. Është indikativ edhe vlerësimi me 2 ose 11%. Pra, tregojnë pakënaqësi me elementet e kërkuar që kanë të bëjnë me punën dhe klimën në klasë.

Shkallë të ulët të kënaqësisë mësimdhënësit e anketuar kanë paraqitur *për sjelljet e nxënësve në shkollë*, 42% të mësimdhënësve janë të kënaqur, ndërsa 33% më pak të kënaqur dhe 18% shumë pakë të kënaqur dhe *kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia* 21% të mësimdhënësve janë të kënaqur, ndërsa 45% më pak të kënaqur dhe 16% shumë pakë të kënaqur, respektivisht 5% në shkallën më të ulët të kënaqësisë. Ndërsa shkallën më të ulët të kënaqësisë mësimdhënësit e kanë shprehur në aplikimin e teknologjisë së re të mësimdhënies (Grafoskopi, videobimi, DVD etj.), lidhur me këtë 35 % të mësimdhënësve nuk janë aspak të kënaqur dhe 21% janë fare pak të kënaqur.

Nga analiza e përgjithshme e të gjitha aspekteve të paraqitura shohim se shkalla e kënaqësisë qëndron në nivelin mesatar, por është edhe një

përqindje rreth 21% që kanë shkallë të lartë të kënaqësisë dhe po ashtu pjesa tjetër me rreth 11% me shkallë më të ulët të kënaqësisë respektivisht 6 %.

Mësimdhënësi nuk mund të jetë indiferent ndaj dukurisë së braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve me të cilët ai punon, ose për të cilët ai angazhohet në shkollë. Tek e fundit, ai duhet të ndiej një pjesë të barrës së përgjegjësisë për këtë, sepse mund të jetë edhe ai një faktor për braktisjen e shkollës nga ana e nxënësve.

## Kapitulli V

### 5. Mësimdhënia dhe stilet e mësimdhënies

Në këtë kapitull nuk do të trajtojmë mësimdhënien dhe stilet e mësimdhënies në aspektin teorik, apo në aspektin praktik të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënësve në orët e mësimi, por do të trajtojmë mësimdhënien dhe stilet e mësimdhënies të reflektuara nga pritjet e nxënësve për mësimdhënës, afërsinë e mësimdhënësve me nxënës, llojet alternative të komunikimit që i përdorin mësimdhënësit, mënyrat e menaxhimit të detyrave të shtëpisë dhe nga bashkëpunimi dhe format e bashkëpunimit me prindër.

#### 5.1. Pritjet e nxënësve

Pritjet janë mundësi për të krijuar mobilitet te faktorët e bashkëpunimit për përmbushjen e tyre. Sikurse shkolla dhe mësimdhënësit që kanë pritjet e tyre nga nxënësit, po ashtu edhe nxënësit kanë pritjet e tyre nga shkolla dhe mësimdhënësit. Qasja jonë në hulumtimin e pritjeve të nxënësve nga shkolla dhe mësimdhënësit është orientuar drejt ndërlidhjes me fushën e hulumtimit. Në këtë drejtim, në pyetësorin për nxënës kemi adresuar një pyetje për nxënës lidhur me pritjet e tyre se çka presin nxënësit nga shkolla dhe mësimdhënësit në mënyrë që ata të mësojnë më shumë.

Lidhur me pyetjen e adresuar janë dhënë pesë alternativa dhe nxënësve u është dhënë mundësi që të japin përgjigje në një apo më shumë alternativa. Rezultatet nga kjo pyetje sjellin të dhëna mjaft interesante që meritojnë analizë më të thelluar. Tabela në vijim pasqyron rezultatet e nxënësve në përqindje për pritjet e tyre. Përgjigjet janë dhënë me Po ose Jo.

Pritjet e nxënësve	Po	Totali
a) Mësimdhënia të jetë më atraktive	33%	<b>329</b>
b) Të përfshihem më shumë në aktivitete	35%	<b>328</b>
c) Të përfillen më shumë kërkesat e mia për organizimin e aktiviteteve brenda klasës	13%	<b>328</b>
d) Mësimdhënësit të sillen më mirë me mua	21%	<b>325</b>
e) Të dëgjohet më shumë zëri im në vendimmarrje	11%	<b>328</b>

Tabela 5. Pritjet e nxënësve nga shkolla dhe mësimdhënësit

Nga të dhënat e tabelës shohim se pritjet e nxënësve janë në shkallë më të lartë për mësimdhënien që të jetë më atraktive dhe për përfshirjen e nxënësve më shumë në aktivitete, pastaj vijnë pritjet që mësimdhënësit të sillen më mirë me nxënës. Pritjet më të ulëta janë për përfilljen e kërkesave të nxënësve dhe për dëgjim më shuam të zërit të tyre. Duket se nxënësit nuk e shohin vetën partner në vendimmarrje dhe në organizimin e aktiviteteve brenda klasës për shkak se nuk është praktikuar që të jenë pjesë e këtyre angazhimeve dhe përgjegjësi, prandaj i kanë pritjet më të ulëta në këto aspekte.

Duke pasur parasysh rezultatet e fituara nga kjo pyetje, nga të gjithë nxënësit e përfshirë në hulumtim kemi dashur që të bëjmë një ndërlidhje vetëm për pritjet e nxënësve që kanë deklaruar se asnjëherë nuk ikin nga orët e mësimit<sup>23</sup>. Edhe rezultatet e këtij grupi të nxënësve nuk sigurojnë pritje të larta nga shkolla për të mësuar më mirë. Tabela në vijim pasqyron këto të dhëna në bazë të numrit të nxënësve që kanë dhënë përgjigje:

Pritjet e nxënësve	Po	Totali
a) Mësimdhënia të jetë më atraktive	39%	<b>140</b>
b) Të përfshihem më shumë në aktivitete	41%	<b>139</b>
c) Të përfillen më shumë kërkesat e mia për organizimin e aktiviteteve brenda klasës	15%	<b>139</b>
d) Mësimdhënësit të sillen më mirë me mua	15%	<b>138</b>
e) Te dëgjohet më shumë zëri im në vendimmarrje	10%	<b>139</b>

Tabela 5.1. Pritjet e nxënësve nga shkolla - që kanë deklaruar se asnjëherë nuk ikin nga orët e mësimit

<sup>23</sup> Më gjerësisht për shpeshësinë e ikjes nga orët e mësimit shih në kapitullin VI

Rezultatet e fituara nga kjo pyetje reflektojnë mundësinë për të arritur në dy konkludime lidhur me pritjet e nxënësve dhe shkollës. E para, shumica e shkollave nuk praktikojnë që të kërkojnë nga nxënësit se çfarë pritjesh kanë ata nga shkolla dhe nga mësimdhënësit. E dyta, shumica e shkollave nuk i njoftojnë nxënësit me pritjet që ato kanë për ta. Gjithsesi, ndërlidhja e pritjeve të shkollës nga nxënësit dhe anasjelltas do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë në arsim dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim, që nënkupton edhe parandalimin e braktisjes.

## 5.2. Afërsia e mësimdhënësve me nxënës

Një nga objektivat e reformës arsimore është edhe përmirësimi i raportit mësimdhënës-nxënës dhe anasjelltas. Në funksion të përmirësimit të këtyre raporteve janë organizuar trajnime të ndryshme me mësimdhënës në të gjitha nivelet e shkollimit, pra edhe me mësimdhënës të arsimit profesional. Fokusi ynë në trajtimin e afërsisë së mësimdhënësve me nxënës është venë në çështjen e parandalimit të braktisjes. Për këtë arsye kemi bërë përpjekje që nga mësimdhënësit të marrim vlerësimin e tyre për relacionet e tyre me të gjithë nxënësit, njohjen e situatës së të gjithë nxënësve si dhe për vëmendjen që mësimdhënësit u kushtojnë nxënësve. Këto aspekte i kemi vendosur në një tabelë të veçantë dhe kemi kërkuar prej mësimdhënësve që në bazë të vlerësimit të tyre të tregojnë afërsinë e tyre me nxënës.

Aspekte të lidhura me shkallën e afërsisë së mësimdhënësve me nxënës	1	2	3	4	5 <sup>24</sup>	Totali
Jam në relacione të mira me të gjithë nxënësit	0 %	1 %	6 %	37 %	56%	<b>81</b>
E njoh situatën e të gjithë nxënësve në shtëpi	4 %	14%	47%	25 %	11%	<b>81</b>
I kushtoj vëmendje të gjithë nxënësve	0 %	0 %	6 %	22 %	72%	<b>78</b>
I kushtoj vëmendje të veçantë nxënësve të suksesshëm	1 %	1 %	10%	28 %	59%	<b>79</b>
I kushtoj vëmendje nxënësve me nota të dobëta	0 %	1 %	20%	25 %	53%	<b>79</b>
Jam i/e hapur ndaj pyetjeve të nxënësve edhe nëse nuk lidhen me lëndën e ngushtë mësimore	0 %	0 %	16%	20 %	64%	<b>81</b>

Tabela 5.2. Vlerësimi i mësimdhënësve për aspektet dhe shkallën e afërsisë së tyre me nxënës

Në përgjithësi, mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim kanë dhënë vlerësime se kanë shkallë të lartë të afërsisë me nxënës. Dallimet më të

<sup>24</sup> Vlerësimi me notën 5 nënkupton shkallën e lartë të afërsisë, ndërsa vlerësimi me 1 nënkupton shkallën e ulët të afërsisë.



mëdha janë shënuar për aspektin: *E njoh situatën e të gjithë nxënësve në shtëpi*. Vetëm 9 mësimitdhënës (ose 11%) nga 81 sa kanë dhënë vlerësime për këtë aspekt të afërsisë me nxënës, kanë dhënë vlerësimin për shkallë të lartë të njohjes së situatës së të gjithë nxënësve në shtëpi.

Ndërlidhja e aspekteve të vëna për vlerësim nga mësimitdhënësit për shkallën e afërsisë me nxënës sjellë dallime kontradiktore të vlerësimeve të mësimitdhënësve. Derisa në aspektin e afërsisë me nxënës: *I kushtoj vëmendje të gjithë nxënësve*, shumica e mësimitdhënësve japin shkallë të lartë të vlerësimit pozitiv, në aspektin tjetër: *I kushtoj vëmendje të veçantë nxënësve me nota të dobëta*, kemi një vlerësim më ndryshe, sepse 16 mësimitdhënës ose 20% e mësimitdhënësve që kanë dhënë vlerësim për këtë aspekt, kanë vlerësuar me 3 apo thënë ndryshe mesatarisht i kushtojnë vëmendje nxënësve me nota të dobëta. Kjo është një e dhënë se një pjesë e mësimitdhënësve nuk “shqetësohen” shumë për nxënësit me nota të dobëta, të cilët në një mënyrë edhe mund të jenë potencialë për të braktisur shkollën.

### 5.3. Alternativat e komunikimit

Komunikimi konsiderohet qelës i suksesit në të gjitha fushat e jetës, pra edhe në arsim. Mësimitdhënësi që përdor komunikim të natyrshëm, të qartë dhe bindës, siguron afërsi më të mirë me nxënës, siguron mësimitdhënie më atraktive. Në veçanti komunikim i veçantë kërkohet me nxënës që kanë probleme të ndryshme në mësim. Për të marrë informacion nga mësimitdhënësit për shpeshësinë e përdorimit të komunikimit të tyre me nxënës që kanë probleme në mësim, kemi kërkuar prej tyre që të japin përgjigjeje në njërën nga katër alternativat e vëna për mundësi. Rezultatet tregojnë këto të dhëna për shpeshësinë e përdorimit të mënyrave alternative të komunikimit të mësimitdhënësve me nxënës që kanë probleme në mësim:




Figura 5.2: Shpeshësia e përdorimit të mënyrave alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim

Rezultatet tregojnë se shumica e mësimitdhënësve përdorin mënyra të ndryshme të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim, por jo çdoherë. Komunikimi me nxënës që kanë probleme në mësim duhet të jetë i rregullt, në mënyrë që asgjë të mos i lihet rastit. Me gjithë faktin se shumica e mësimitdhënësve përdorin mënyra alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim, nuk mund të japim vlerësime për efektshmërinë e mënyrave të komunikimit që i përdorin mësimitdhënësit, kur kemi parasysh suksesin e nxënësve në arsimin profesional, mungesat e tyre në mësim, si dhe braktisjen e shkollimit nga ta. Kjo është një çështje që meriton studim të veçantë.

### 5.4. Mënyrat e menaxhimit të detyrave të shtëpisë

Detyrat e shtëpisë janë pjesë e procesit të të nxënës. Ato praktikohen në të gjitha nivelet e arsimit, pra edhe në arsimin profesional. Mënyra e aplikimit dhe menaxhimit të tyre është e drejtë e mësimitdhënësve në bashkëpunim me nxënës, por edhe me prindër. Duke pasur parasysh numrin e nxënësve në klasë, kohëzgjatjen e orës mësimore në shkollat tona, del si nevojë që detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme dhe gjithësesi kërkohet një menaxhim efikas i tyre në mënyrë që të realizohen programet mësimore dhe të arrihen rezultatet e pritura mësimore.

Lidhur me detyrat e shtëpisë, kemi shtruar një kërkesë për mësimitdhënës dhe kemi kërkuar prej tyre të tregojnë a u japin nxënësve detyra të shtëpisë, a i kontrollojnë detyrat e shtëpisë dhe a i njoftojnë nxënësit me rezultatet e detyrave të shtëpisë. Për të tri aspektet e detyrave të shtëpisë kemi dhënë mundësinë e përgjigjeve me: *Çdoherë, shpesh, disa herë, asnjëherë*. Mësimitdhënësit kanë treguar në këtë mënyrë menaxhimin e detyrave të shtëpisë të dedikuara nxënësve:




Figura 5.3: Mënyrat e menaxhimit të detyrave të shtëpisë

Nëse analizojmë përqindjen e mësimdhënësve që vetëm disa herë u japin nxënësve detyra të shtëpisë, mund të themi se rreth 23 % e mësimdhënësve pak e përdorin këtë formë të përcjelljes së përparimit dhe angazhimit të nxënësve dhe se ata (mësimdhënësit) kanë më pak mundësi që të njohin situatën e të gjithë nxënësve në shtëpi. Edhe numri i mësimdhënësve që vetëm disa herë i kontrollojnë detyrat e shtëpisë dhe vetëm disa herë i njoftojnë nxënësit me rezultatet e detyrave të shtëpisë, tregon për menaxhim jo cilësor të detyrave të shtëpisë.

Dhënia e detyrave të shtëpisë, kontrolli i tyre dhe komunikimi i rezultateve janë mundësi e mirë për të ndjekur përparimin dhe angazhimin e nxënësve, për të njohur më mirë situatën e nxënësve në shtëpi dhe po ashtu janë një mundësi e mire edhe e nxitjes së bashkëpunimit me prindër. Këto përparësi të menaxhimit të detyrave të shtëpisë duhet të reflektojnë pozitivisht në mësimdhënie dhe stile të mësimdhënies.

## 5.5. Bashkëpunimi me prindër

Sot nuk mund të flasim për shkollë bashkëkohore dhe cilësore nëse në atë shkollë nuk zhvillohet bashkëpunimi me prindër. Për këtë qëllim, në pyetësorin e mësimdhënësve, kemi provuar të marrim informacion për përfshirjen e prindërve në bashkëpunim të rregullt. Rezultatet tregojnë se vetëm 30% e mësimdhënësve arrijnë t'i përfshijnë të gjithë prindërit në takime të rregullta, kurse 59% e mësimdhënësve bashkëpunojnë rregullisht me disa prindër. Një argument tjetër mjaft domethënës për temën tonë të hulumtimit është se afër 10% e mësimdhënësve thonë se bashkëpunojnë

vetëm me prindërit e nxënësve të cilët i kontaktojnë ata, d.m.th. ky grup i mësimdhënësve nuk jep tregues të angazhimit të tyre për përfshirjen e prindërve në bashkëpunim. Figura në vijim tregon për bashkëpunimin e mësimdhënësve me prindër.




Figura 5.4: Bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindër

Përveç përfshirjes së prindërve në bashkëpunim, nga mësimdhënësit kemi kërkuar që të na japin informacion të veçantë për format e bashkëpunimit me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës. Përgjigjet e mësimdhënësve lidhur me format e bashkëpunimit janë të ilustruara në tabelën në vijim:

Format e bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindër	Po	Totali
Përmes takimeve të rregullta	59%	80
Përmes emailit/letërkëmbimeve	4%	80
Përmes drejtorit të shkollës	21%	80
Nuk kemi bashkëpunim, sepse nuk kemi qasje me ta	15%	80
Tjetër (shëno)	11%	81

Në alternativën e fundit ( tjetër – shëno ), mësimdhënësit (11 % e tyre) kanë veçuar këto forma të bashkëpunimit me prindër:

- Takime rasti - disa prindër nuk janë të interesuar të bashkëpunojnë me prindër
- Takime formale apo informale
- Ftohen prindërit edhe jashtë takimeve të rregullta
- I ftojme prindërit të vijnë në shkollë
- Në takime me prindër
- Përmes ftesave
- Përmes takimit me prindër
- Takime rasti

Tabela 5.3: Format e bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës

Të dhënat nga tabela tregojnë se 59% e mësimeve bashkëpunojnë përmes takimeve të rregullta me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës. Po ashtu, të dhënat tregojnë se vetëm 4% e mësimeve bashkëpunojnë me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës përmes emalit apo formave tjera të letërkëmbimeve, kurse 21% e mësimeve bashkëpunojnë me prindër vetëm përmes drejtorit të shkollës. Një argument tjetër mjaft i ndejshëm është fakti se 15 % e mësimeve nuk bashkëpunojnë fare me prindër të nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës, për arsye se nuk kanë qasje në komunikim me ta. Gjithashtu, përqindja e mësimeve që fare nuk bashkëpunojnë me prindërit e nxënësve që kanë shenja të braktisjes së shkollës afërsisht përputhet me numrin e nxënësve që tashmë e kanë braktisur shkollën.

Përveç këtyre formave, mësuesit kanë veçuar edhe takimet e rastit me mësuesin, festat e shkollës etj., për të bashkëpunuar lidhur me nxënësit që kanë shenja të braktisjes së shkollës.

**Konkludim.** Mësimdhënia dhe stilet e mësimdhënies në shkollat profesionale, në raport me parandalimin e braktisjes, nuk sigurojnë shkallë të kënaqshme të adresimit të drejtë të braktisjes së shkollës. Kjo reflektohet me pritje të ulëta të nxënësve nga shkolla për të mësuar më shumë, me përkushtim jo të kënaqshëm të vëmendjes së mësimeve ndaj nxënësve që kanë nota të dobëta, me komunikim sipërfaqësor dhe pa aplikuar mënyra alternative të komunikimit që sigurojnë tejkalimin e problemeve të nxënësve në mësim, me menaxhim jociësor të detyrave të shtëpisë, me bashkëpunim sipërfaqësor me prindër dhe me aplikim vetëm të formave tradicionale të bashkëpunimit me prindër, siç janë takimet formale.

## Kapitulli VI

### 6. Treguesit e braktisjes

Në kapitullin VI do të trajtohen treguesit e braktisjes të bazuar në informacionet e siguruar nga administrata e shkollave dhe nga reflektimet e nxënësve dhe të mësimeve për shpeshësinë e ikjes nga orët mësimore, arsyet e ikjes, masat që ndërmerren në rast të ikjes nga orët mësimore, numrin e nxënësve që e kanë braktisur mësimin, arsyet e mundshme të braktisjes, karakteristikat e nxënësve potencialë për braktisje, intervenimet në funksion të parandalimit të braktisjes dhe se çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore.

#### 6.1. Informata nga Komuna dhe administrata e shkollës

Informatat nga administrata e shkollës do të pasqyrojnë të dhënat e suksesit dhe të mungesave të nxënësve të klasës së 10-të në fund të gjysmëvjetorit të parë 2009/2010.

Analiza e treguesve statistikorë të suksesit pozitiv të nxënësve tregon se vetëm 32 % e nxënësve të klasës së 10-të në komunat e përfshira në hulumtimin tonë kanë arritur sukses pozitiv në fund të gjysmëvjetorit të parë. Në mesin e nxënësve që kanë sukses pozitiv numri dhe përqindja më e madhe e tyre është me sukses të sh.mirë 1214 nxënës ose rreth 39%. Më gjerësisht për suksesin pozitiv të nxënësve shih tabelën 6.1.

	Komuna	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv									
				Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive	
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1	Prishtinë	111	4601	462	32	574	39	339	23	83	8	1458	32
2	Podujevë	53	1944	122	20	254	41	200	33	38	6	614	32
3	Glllogoc	33	1461	116	30	174	37	140	30	35	8	465	32
4	Istog	23	799	85	27	124	39	94	29	17	5	320	40
5	Klinë	23	715	57	25	88	39	72	32	10	4	227	32
Gjithsej		243	9520	842	27	1214	39	845	27	183	6	3084	32

Tabela 6.1. Suksesi i nxënësve të klasës së 10 (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë

Përkundrajt numrit të nxënësve me sukses pozitiv, numri i nxënësve me sukses të pamjaftueshëm është dyfish më i madh, 6210 nxënës, 65% e nxënësve të klasës së 10-të të komunave të përfshira në hulumtim në fund të gjysmëvjetorit të parë kanë sukses të pamjaftueshëm. Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme është numri më i madh i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, përkatësisht 4415 nxënës, ose 71% e nxënësve që kanë sukses të pamjaftueshëm në fund të gjysmëvjetorit të parë 2009/2010. Më gjerësisht për suksesin e pamjaftueshëm të nxënësve shih tabelën 6.2.

Numri	Komuna	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi i pamjaftueshëm									
				Me 1 notë pamjaftueshme		Me 2 nota pamjaftuesh.		Me 3 e më shumë nota të pamjaftuesh.		Gjithsej me nota të pamjaftuesh.		Të panotuar	
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		Nr
1	Prishtinë	111	4601	486	16	463	15	2095	69	3044	66	99	2
2	Podujevë	53	1944	179	14	148	12	947	74	1274	66	56	3
3	Glllogoc	33	1461	124	13	118	12	721	75	963	66	33	2
2	Istog	23	799	92	21	66	15	286	64	444	56	35	4
3	Klinë	23	715	56	12	63	13	366	76	485	68	3	0.4
Gjithsej		243	9520	937	15	858	14	4415	71	6210	65	226	2

Tabela 6.2. Suksesi i pamjaftueshëm i nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë.

Tabela 6.2 pasqyron edhe numrin e nxënësve të panotuar në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit 2009/2010. Sipas tabelës, shohim se 226 nxënës, ose mbi 2% të nxënësve të klasës së 10-të, nga komunat e përfshira në hulumtim kanë mbetur të panotuar në fund të gjysmëvjetorit të parë. Analiza e numrit të mungesave të nxënësve të klasës së 10-të në fund të gjysmëvjetorit të parë tregon se mesatarja e numrit të mungesave të arsyeshme për kokë të një nxënësi është 6.35 mungesa, ndërsa mesatarja e numrit të mungesave të paarsyeshme është 7.06 mungesa. Mesatarja në total të mungesave është 13.42 mungesa për kokë të një nxënësi. Më gjerësisht për mungesat e nxënësve shih tabelën 6.3.

	Komuna	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Numri i mungesave					
				Të arsyeshme	Mesatarja	Të paarsyeshme	Mesatarja	Gjithsej	Mesatarja
1	Prishtinë	111	4601	29445	6.3997	33265	7.23	62710	13.63
2	Podujevë	53	1944	11917	6.1301	13239	6.8102	25156	12.94
3	Glllogoc	33	1461	7028	4.8104	6752	4.6215	13780	9.4319
2	Istog	23	799	5409	6.7697	6139	7.6834	11548	14.453
3	Klinë	23	715	6663	9.3189	7891	11.036	14554	20.355
Gjithsej		243	9520	60462	6.3511	67286	7.0679	127748	13.419

Tabela 6.3. Mungesat e nxënësve të klasës së 10-të (2009/2010) në gjysmëvjetorin e parë

## 6.2. Treguesit e braktisjes sipas nxënësve

### 6.2.1 Shpeshësia e ikjes së nxënësve nga orët mësimore

Ikja e nxënësve nga orët e mësimin mendohet se mund të jetë një ndër karakteristikat e nxënësve potencialë për braktisjen e shkollës, sidomos kur kjo ikje është e shpeshtë dhe e pajustificueshme.

Lidhur me dukurinë e ikjes së nxënësve nga orët e mësimin, në pyetësorë kemi parashtruar pyetje për të siguruar informacion se a ikin ata nga orët e mësimin dhe, nëse po, sa shpesh. Pyetja e parashtruar për ikjet nga orët e mësimin është ndërtuar me katër mundësi për t'u përgjigjur, ku nxënësit kanë pasur mundësi të përcaktohen në vetëm njërin nga to. Në tabelën 6.4.

janë prezantuar rezultatet e dhëna nga nxënësit lidhur me shpeshtësinë e ikjes nga orët mësimore, të specifikuara në gjininë e nxënësve të përfshirë në hulumtim.

Shkalla e shpeshtësisë	F	%	M	%	Total	%
Asnjëherë	59	60	81	35	140	43
Nganjëherë	39	40	139	60	178	54
Shpesh			3	1	3	1
Shumë shpesh			7	3	7	2
<b>Total</b>	<b>98</b>		<b>230</b>		<b>328</b>	

Tabela 6.4. Shpeshtësia e ikjes së nxënësve nga orët mësimore

Në të dhënat tabelore të mësipërme shihet se 140 nxënës (ose 43%) të përfshirë në hulumtim kanë deklaruar se asnjëherë nuk ikin nga orët e mësimimit, ndërsa nxënës që deklarojnë se ikin shumë shpesh nga orët mësimore janë vetëm 7 (ose 2%). Është me rëndësi të përmendet se nga 98 nxënës të gjinisë femërore sa janë përgjigjur në këtë pyetje, 59 (60%) prej e tyre janë deklaruar se *asnjëherë* nuk ikin nga orët e mësimimit dhe me *ndonjëherë* 39 (40%), ndërsa në mundësinë e përgjigjes me *shpesh* ose *shumë shpesh* të ikjes nga orët e mësimimit nuk kemi asnjë përgjigje. Edhe nga gjinia mashkullore e nxënësve të përfshirë në hulumtim kemi përafërsisht një raport të njëjtë në përgjigje, ku 220 (95%) e tyre janë përgjigjur për dy mundësitë e para, ndërsa vetëm 10 nxënës (4%) janë përgjigjur se ikin *shpesh* ose *shumë shpesh* nga orët e mësimimit. Dallimet gjinore sa i përket shkallës së shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit vërehen më tepër në faktin se përqindje më e madhe e nxënësve të gjinisë femërore janë përgjigjur se asnjëherë nuk ikin nga orët mësimore (60%), ndërsa te gjinia e kundërt e nxënësve përqindjen më të lartë e arrin përgjigjja e ikjes nganjëherë nga orët e mësimimit (61%).

### 6.2.2. Arsyet e ikjes nga orët e mësimimit

Edhe sa i përket arsyeve të ikjes së nxënësve nga mësimi në pyetësor është shtruar pyetja e ndërtuar me gjashtë alternativa, ku nxënësit kanë pasur mundësi të përcaktohen vetëm për njërin nga mundësitë e dhëna si përgjigje. Të dhënat e fituara pas përpunimit janë paraqitur në tabelën 6.5, ndërsa në

tabelën 6.6 është paraqitur ndërlidhja e shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes.

Arsyet	F	%	M	%	Total	%
Kam dëshirë të fle më shumë	3	5	5	3	8	3
Nuk jam i/e përgatitur për orën mësimore	33	54	100	54	133	54
Nuk më pëlqen mësimdhënësi	4	7	18	10	22	9
Ora është e mërzitshme	6	10	12	7	18	7
Punoj një punë	2	3	12	7	14	6
Sepse isha i lodhur	13	21	37	20	50	20
<b>Grand Total</b>	<b>61</b>		<b>184</b>		<b>245</b>	

Tabela 6.5. Arsyet e ikjes nga orët e mësimimit – sipas nxënësve

Ndërlidhja e shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes	Kam dëshirë të fle më shumë	Nuk jam i/e përgatitur për orën mësimore	Nuk më pëlqen mësimdhënësi	Ora është e mërzitshme	Punoj një punë	Sepse isha i lodhur
Asnjëherë	2%	41%	16%	6%	14%	22%
Nganjëherë	4%	59%	5%	9%	3%	20%
Shpesh	0%	67%	0%	0%	0%	33%
Shumë shpesh	0%	17%	50%	33%	0%	0%

Tabela 6.6. Ndërlidhja e shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes

Edhe pse 140 nxënës të përfshirë në hulumtim, pyetjes për shpeshtësinë e ikjes nga orët e mësimimit i janë përgjigjur, me *asnjëherë* 64 prej tyre kanë dhënë gjithashtu përgjigje në pyetjen vijuese për arsyet e mundshme të ikjes nga orët e mësimimit. Meqenëse mundësi për përgjigje në këtë pyetje kanë pasur vetëm nxënësit që në pyetjen për shpeshtësinë e ikjes nuk janë përgjigjur me *asnjëherë*, atëherë përgjigjet e marra nga ta për arsyet e mundshme të ikjes nga mësimi i konsiderojmë vetëm si opinione të tyre, ose konsiderojmë se përgjigja e tyre me *asnjëherë* nuk ka qenë objektive.

Në të tri shkallët tjera të shpeshtësisë së ikjes së nxënësve nga orët e mësimimit, numrin më të lartë e ka alternativa *nganjëherë*, në të cilën janë përgjigjur 172 nxënës. Për arsyen e ikjes *nganjëherë* nga orët e mësimimit ata japin arsyetimin se *nuk janë të përgatitur për orën mësimore*, për të cilën

janë përgjigjur 104 nxënës (59%), ndërsa arsyeja e dytë për nga numri i nxënësve që janë përgjigjur në alternativën *nganjëherë* është *sepse isha i lodhur* me 35 (20%). Për nxënësit që janë deklaruar se ikin *shpesh* apo *shumë shpesh* nga orët mësimore, shkaqet më kryesore të ikjes nga orët e mësimimit janë: *nuk janë të përgatitur për orë mësimore, nuk u pëlqen mësimdhënësi, ora është e mërzitshme dhe se janë të lodhur*.

*Edhe figura në vijim pasqyron ndërlidhjen e shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes.*




Figura 6.1. Ndërlidhja e shpeshtësisë së ikjes nga orët e mësimimit me arsyet e ikjes

### 6.2.3. Masat edukative dhe disiplinore ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit

Me Udhëzimin Administrativ nr. 7/2009, *Kodi i Mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta*, përcaktohen të drejtat dhe obligimet e nxënësve, veprimet e ndaluara dhe masat disiplinore për mospërfilljen e rregullave të shkollës dhe mosvijueshmërinë e rregullt në mësim. Për të marrë informacion se a merren masa në shkollë ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit, në pyetësorin e nxënësve kemi ofruar vlerësim pesë shkallësh, ku nxënësit kanë pasur mundësi të japin vlerësimin e tyre për të tre subjektet (mësimdhënësit, drejtorin e shkollës apo DKA-në), që me ligj janë të thirrur që të marrin masa edukative dhe disiplinore ndaj nxënësve që nuk i përmbushin obligimet e tyre dhe që mungojnë pa arsye nga procesi mësimor. Të dhënat e fituara për shpeshtësinë dhe përgjegjësinë e marrjes së masave ndaj nxënësve që ikin nga orët mësimore po e paraqesim në tabelën 6.7.

Kush merr masa disiplinore ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit?	1	2	3	4	5	Totali
a) Profesori	10%	4%	9%	14%	63%	270
b) Shkolla	27%	4%	14%	19%	36%	250
c) Drejtorja e arsimit në komunë	43%	9%	10%	12%	27%	247

Tabela 6.7. Shpeshtësia e marrjes së masave ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë përqindja më e lartë e nxënësve është në përgjigjen e alternativës *çdoherë* për profesorët, si ndërmarrës të masave ndaj nxënësve që ikin nga orët e mësimimit, me 170 nxënës të përgjigjur (63%); për mundësinë *shumë shpesh*, me 47 nxënës (19%) dhe *shpesh* me 36 nxënës (14%) shprehen për shkollën si ndërmarrëse e masave, ndërsa për DKA-në, si ndërmarrëse e masave disiplinore ndaj nxënësve që ikin nga orët mësimore, kemi përgjigje me përqindjen më të lartë për mundësinë *nganjëherë*, me 21 nxënës (9 %) dhe *asnjëherë* me 106 nxënës (43%). Nga ky raport i të dhënave vlerësojmë se shkolla dhe DKA-ja nuk ndërmerr masa të mjaftueshme disiplinore ndaj nxënësve që braktisin orët mësimore, ndërsa më të angazhuar në këtë drejtim janë profesorët e tyre.

### 6.2.4. Numri i nxënësve që e kanë braktisur në klasën e 10-të (2009/2010) dhe arsyet e braktisjes, sipas nxënësve të klasës

Meqenëse faza e mbledhjes së të dhënave në shkollë për hulumtimin e braktisjes së shkollës në arsimin profesional është realizuar në periudhën maj-qershor 2010, kemi konsideruar se nxënësit kanë një shkallë të mirë të informacioneve për nivelin e braktisjes së shkollës brenda vitit shkollor dhe kemi provuar që nga nxënësit e përfshirë në hulumtim të marrim informacion të drejtpërdrejtë për braktisjen e shkollës nga kolegët e tyre.

Në pyetjen se a e ka braktisur dikush nga klasa e tyre shkollën gjatë vitit shkollor 2009/2010, kemi marrë përgjigje mjaft domethënëse. Nga 326 nxënës sa kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, 230 ose rreth 71% e tyre janë shprehur me PO, e kanë braktisur shkollën disa nxënës nga klasat tona, kurse 96 nxënës ose mbi 29% janë përgjigjur me JO. Përgjigjja e lartë me Po vërteton se në shumicën paraleleve të klasave të 10-ta është një numër i

konsiderueshëm i nxënësve që e kanë braktisur shkollën në këtë vit shkollor 2009/2010.

Gjetjet e arsyeve kryesore të braktisjes së shkollës nga nxënësit e klasave të dhjeta të arsimit profesional është një nga qëllimet kryesore të këtij hulumtimi. Për të arritur këtë qëllim, informacion të drejtpërdrejtë kemi marrë nga nxënësit e përfshirë në hulumtim dhe që i njohin konkretisht arsyet e braktisjes përmes pyetjes se *Çfarë mendojnë ata, cilat janë arsyet kryesore të braktisjes së shkollës*.

Përgjigjet e nxënësve për arsyet kryesore të braktisjes së shkollës në raport me numrin e nxënësve që mendojnë se ka pasur apo nuk ka pasur braktisje në klasat e tyre brenda vitit shkollor 2009/2010 janë paraqitur në tabelën 6.8.

Arsyet e braktisjes së shkollës	Po	Totali
a) Sjelljet jo të mira të mësimdhënësve	13%	<b>318</b>
b) Kushtet e vështira ekonomike	31%	<b>319</b>
c) Pasiguria në shkollë	2%	<b>318</b>
d) Punësimi	10%	<b>318</b>
e) Rrethanat familjare	16%	<b>318</b>
f) Shkaqet e migrimit	14%	<b>318</b>
g) Problemet shëndetësore	3%	<b>318</b>
h) Suksesi i dobët në mësim	42%	<b>318</b>

Tabela 6.8. Opinioni i nxënësve për arsyet e braktisjes së shkollës nga nxënësit e klasës së tyre

Nga pasqyra e përgjigjeve të nxënësve shihet se nxënësit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me arsyet e braktisjes të shtruar në këtë pyetje. Vlen të veçohen dy arsye të braktisjes së shkollës të cilat kanë shkallën më të lartë të atyre që janë përgjigjur: 135 nxënës (ose 42%) janë përgjigjur se braktisja e shkollës ka ndodhur për shkak se nxënësit kanë sukses të dobët në mësim dhe 99 nxënës (ose 31%) që mendojnë se kushtet e vështira ekonomike kanë ndikuar që nxënësit të braktisin shkollën dhe si pasojë nevojën për punësim me 32 nxënës të përgjigjur (ose 10%).

Vetë fakti se nxënësit e pranojnë se suksesi i dobët në mësim është një ndër arsyet kryesore të braktisjes së shkollës, tregon se ata në këtë moshë fillojnë të rezultojnë mbi efektet negative të mossuksesit të tyre dhe se ata fillojnë të kërkojnë alternativa, të cilat mund të siguronin sukses më të mirë dhe patjetër edhe ulje të nivelit të braktisjes.

### 6.2.5. Veprimet e ndërmarra nga shkolla për parandalimin e braktisjes

Trajtimi me seriozitet i dukurisë së braktisjes nga shkolla është një parakusht për masa parandaluese dhe luftimin e braktisjes. Për të ditur opinionet e nxënësve për angazhimin e shkollës në parandalimin e braktisjes, në pyetësorin e realizuar me nxënës kemi parashtruar pyetjen se *Çfarë mendojnë se ka bërë shkolla për parandalimin e braktisjes*. Në këtë pyetje kemi vendosur tri alternativa dhe kemi kërkuar nga nxënësit që sipas nevojës të japin përgjigje në tri të mundshmet, tabela 6.9.

Hapat që ka ndërmarrë shkolla në parandalimin e braktisjes	PO	Totali
Nuk ka bërë asgjë	47%	<b>319</b>
I ka ftuar prindërit në mbledhje	47%	<b>319</b>
Ka bërë fushatë për parandalimin e braktisjes	7%	<b>321</b>

Tabela 6.9. Opinioni i nxënësve për atë se çfarë ka bërë shkolla për parandalimin e braktisjes

Në pyetjen për hapat që ka ndërmarrë shkolla për parandalimin e braktisjes, bazuar në të dhënat tabelore të paraqitura më lart, mbi 47 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim shprehen se shkolla nuk ka bërë asgjë të veçantë në këtë drejtim. Po e njëjta përqindje e nxënësve shprehen se për parandalimin e braktisjes shkolla i ka ftuar prindërit në mbledhje. Pavarësisht numrit të nxënësve që e kanë braktisur shkollën në shkollat ku ne e kemi realizuar hulumtimin, kanë munguar fushatat e veçanta të këtyre shkollave për parandalimin e braktisjes, qoftë përmes informimit publik, debateve, apo programeve të tjera të veçanta. Vetëm 7 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se shkolla ka bërë fushatë për parandalimin e braktisjes.

### 6.2.6. Çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore?

Nga analiza e treguesve statistikorë kemi vërejtur se braktisja më e madhe e shkollës në arsimin profesional është në klasën e 10-të. Meqenëse hulumtimi në shkolla është realizuar në fund të vitit shkollor dhe, me qëllim të evidentimit të nxënësve të mundshëm që do të braktisin shkollën në vitin vijues shkollor, nga nxënësit kemi synuar të marrim informacion se çfarë ata do të bëjnë pas pushimeve verore, respektivisht se çfarë mendojnë ata se do të bëjnë në vitin shkollor 2010/2011. Këtë mendim të nxënësve e kemi hulumtuar përmes katër alternativave të parashtruara në pyetjen e realizuar me ta. Përgjigjet e nxënësve, sipas numrit dhe përqindjes, për atë se çfarë do të bëjnë ata pas pushimeve verore i kemi përmbledhur në tabelën 6.10.

Opinioni i nxënësve	PO
Do ta ndërroj profilin	3%
Do të kërkoj punë	8%
Do të vazhdoj shkollën	78%
Nuk e di se çfarë do të bëj	11%
Totali (numri i nxënësve që janë përgjigjur )	321

Tabela 6.10. Çfarë do të bëjnë nxënësit pas pushimeve verore

Nga të dhënat tabelore shihet qartë se shumica e nxënësve, 250 nxënës 78%, pas pushimeve verore do të vazhdojnë shkollën, kurse përqindja tjetër e nxënësve është përgjigjur për tri alternativat e tjera. Rezultatet e përgjigjeve në pyetjen 2 dhe 4 që i përgjigjen përqindjes 20% e nxënësve të përgjigjur na lejojnë të supozojmë se kjo përqindje e nxënësve është në rrezik për të braktisur shkollën dhe për të mos vazhduar mësimet e rregullta në klasën vijuese. Mbetet të analizohen të dhënat e fillimit të vitit shkollor 2010/2011 për të vërtetuar se sa është përqindja e nxënësve të kësaj gjenerate (klasës së 10-të) që do të përfshihen në klasën e 11-të.

### 6.3. Treguesit e braktisjes sipas mësimdhënësve

#### 6.3.1. Identifikimi i nxënësve potencialë për braktisje të shkollës

Mësimdhënësit janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin mësimor. Ata vazhdimisht e vëzhgojnë praninë e nxënësve në klasë edhe në procesin e të nxënësve, prandaj ata mund t'i njohin më së miri nxënësit potencialë për braktisje të shkollës.

Duke u nisur nga kjo mundësi, kemi kërkuar nga mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim që të përgjigjen në pyetjen nëse kanë vërejtur nxënës potencialë për braktisje në klasat e tyre. Nga 80 mësimdhënës që kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje, 51 prej tyre ose 64% kanë vërejtur nxënës potencialë në klasat e tyre që mund të braktisin shkollën, kurse 29 mësimdhënës ose 36% e tyre nuk e kanë vërejtur një gjë të tillë. Sipas mësimdhënësve, identifikimi i nxënësve potencialë për të braktisur shkollën është vërejtur në bazë të disa treguesve, të cilët do t'i veçojmë më poshtë.

Treguesit e veçuar	Totali <sup>25</sup> (%)
Gjendja sociale	39%
Migrimi	24%
Interesimi për kalim në shkollat e tjera	7%
Nevoja për punësim	2%
Suksesi i dobët në mësim	5%
Mosinteresimi i prindërve	10%
Vijueshmëria jo e rregullt e mësimi	10%
Mungesa e perspektivës	20%
Sjelljet jo të mira në shkollë	2%
Sëmundjet në familje	2%
Problemet familjare	5%
Martesa e hershme	2%
Niveli i ulët arsimor	2%
Problemet shëndetësore	7%

Tabela 6.11. Treguesit në bazë të të cilëve mësimdhënësit i kanë identifikuar nxënësit potencialë për të braktisur shkollën

<sup>25</sup> 51 mësimdhënës kanë thënë se kanë vërejtur nxënësit potencialë për ta braktisur, ndërsa 41 prej tyre kanë veçuar treguesit, në bazë të të cilëve mendojnë se nxënësit mund të braktisin shkollën ( disa prej tyre kanë dhënë më shumë se një tregues).



Mësimdhënësit i kanë veçuar treguesit në bazë të të cilëve mendojnë se nxënësit mund ta braktisin shkollën dhe sipas këtyre treguesve shohim se treguesit kryesorë janë: *Gjendja e vështirë ekonomike, migrimi dhe mungesa e perspektives.*

### 6.3.2. Diskutimi i pasojave të braktisjes

Për ta parandaluar dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit, posaçërisht te nxënësit potencialë që mund të braktisin shkollën, diskutimi i pasojave të braktisjes është një nga mundësitë e ndikimit të nxënësit për t'iu kthyer shkollës dhe mësimi. Komplexiteti i pasojave të braktisjes kërkon diskutime të shpeshta me nxënësit, në mënyrë që pasojat e braktisjes të kuptohen në thelb dhe me kohë. Për të parë shpeshësinë e diskutimeve të mësimdhënësve me nxënësit për pasojat e braktisjes, kemi kërkuar nga mësimdhënësit që të përgjigjen në njërin nga katër alternativat e mundshme në pyetjen: *Sa shpesh diskutoni me nxënësit për pasojat e braktisjes?* Tabela në vijim paraqet rezultatet nga kjo pyetje.

Shpeshësia e diskutimeve	PO
Çdo javë	40 %
Çdo muaj	16 %
Ndonjëherë	44%
Asnjëherë	0%
Totali (numri i mësimdhënësve që janë përgjigjur )	82

Tabela 6.12. Shpeshësia e diskutimit të mësimdhënësve me nxënësit për pasojat e braktisjes

Të dhënat nga tabela tregojnë se asnjë mësimdhënës nuk është shprehur se asnjëherë nuk diskutojnë me nxënësit për pasojat e braktisjes. Kjo është një gjë e mirë! Mbi 40% diskutojnë çdo javë, 16 % diskutojnë çdo muaj, ndërkaq ekziston një përqindje e lartë, 44 % mësimdhënësve, që shprehen se diskutojnë me nxënësit për pasojat e braktisjes *ndonjëherë*. Shpeshësia e diskutimeve me nxënësit për pasojat e braktisjes duhet të jetë masë

parandaluese e braktisjes, përqindja e mësimdhënësve që ndonjëherë bisedojnë me nxënësit për pasojat e braktisjes, nuk siguron qasjen preventive të parandalimit të braktisjes.

### 6.3.3. Arsyet e braktisjes së shkollës, sipas mësimdhënësve

Mësimdhënësit për numrin e nxënësve që e kanë braktisur shkollën në këtë vit shkollor (2009/2010) i kemi pyetur me qëllim që t'i ndërlihim informacionet me të dhënat e nxënësve dhe të dhënat e administratës së shkollës. Ashtu sikur administrata e shkollës dhe nxënësit, edhe mësimdhënësit kanë reflektuar për numrin e nxënësve që e kanë braktisur shkollën në këtë vit shkollor. Prej 81 mësimdhënësve që e kanë plotësuar pyetësorin në shkollën e nevojshme për ta analizuar, 45 mësimdhënës ose 56% kanë ofruar të dhëna të ndryshme për numrin e nxënësve që e kanë braktisur shkollën në këtë vit.

Arsyet e braktisjes së shkollës janë të ndryshme, lidhen me individin, familjen, shkollën dhe shoqërinë. Mirëpo, nga mësimdhënësve kemi kërkuar që të përgjigjen në bazë të njohjes së tyre për arsyet me kryesore të braktisjes nga nxënësit e shkollave të tyre. Arsyet më kryesore të braktisjes sipas mësimdhënësve pasqyrohen në tabelën në vijim.

Arsyet braktisjes së shkollës	PO	Totali
Kushtet e vështira ekonomike	66%	54
Pasiguria në shkollë	0	-
Punësimi	37 %	30
Rrethanat familjare	29%	24
Shkaqet e migrimit	38%	31
Problemet shëndetësore	16%	13
Suksesi i dobët në mësim	37 %	30

Tabela 6.13. Opinioni i mësimdhënësve për arsyet e braktisjes së shkollës

Arsyet e braktisjes së shkollimit sipas mësimdhënësve rangohen në këtë mënyrë: Kushtet e vështira ekonomike, shkaqet e migrimit, punësimi, suksesi i dobët në mësim, rrethanat familjare dhe problemet shëndetësore. Ajo që është e rëndësishme të përmendet është se menjëherë pas kushteve të vështira ekonomike, faktor tjetër të rëndësishëm janë punësimi dhe suksesi i dobët në mësim, të cilat duhet të trajtohen me shumë kujdes. Është një fakt

inkurajues lidhur me sigurinë në shkolla. Sikurse mësimdhënësit, ashtu edhe nxënësit e përjashtojnë mundësinë e braktisjes së shkollës për shkak të pasigurisë në shkollë.

#### 6.3.4. Sa shpesh mësimdhënësit mbajnë takime për parandalimin e braktisjes dhe çka diskutojnë në takime?

Takimet në mes të mësimdhënësve në funksion të parandalimit të braktisjes së shkollës nga nxënësit janë edhe një mundësi tjetër për ta ndihmuar parandalimin e braktisjes. Ato janë mundësi e mirë për të diskutuar raste dhe dukuri të braktisjes, për të shkëmbyer përvoja në gjetjen e rrugëve alternative për të parandaluar braktisjen, etj. Për të parë se sa shpesh mësimdhënësit e shkollave profesionale organizojnë takime në funksion të parandalimit të braktisjes, kemi kërkuar prej tyre që në pyetjen prej gjashtë alternativave të japin atë përgjigje që është relevante. Përgjigjet e mësimdhënësve në këtë pyetje janë të ndryshme. Tabela në vijim i pasqyron ato.

Shpeshësia e takimeve	PO
Çdo javë	18 %
Çdo dy javë	8 %
Çdo muaj	13 %
Çdo dy muaj	10 %
Më shpesh	33 %
Asnjëherë	20 %
<b>Totali</b> (numri i mësimdhënësve që janë përgjigjur )	<b>80</b>

Tabela 6.14: Shpeshësia e takimeve të mësimdhënësve me kolegë/mësimdhënës në funksion të parandalimit të braktisjes

Nga totali i mësimdhënësve që janë përgjigjur në këtë pyetje vlen të theksohet se 26 mësimdhënës ose 33% shprehën se takohen më shpesh se alternativat e dhëna në pyetësor. Gjithashtu, është për t'u befusuar me faktin që një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve (16 ose 20%) thonë se nuk takohen asnjëherë për të diskutuar me kolegët e tyre për këtë problem.

Përveç se është e rëndësishme shpeshësia e takimeve, janë shumë të rëndësishme edhe temat e takimeve që lidhen me dukurinë e braktisjes. Në këtë drejtim kemi hulumtuar te mësimdhënësit temat që i diskutojnë me kolegë për parandalimin e braktisjes dhe shpeshësinë e takimeve për temat e diskutimeve. Tabela në vijim pasqyron rezultatet e hulumtimit në këto dy aspekte.

Temat e bisedave me kolegë për parandalimin e braktisjes	Asnjëherë	Çdoherë	Disa herë	Shpesh	Totali
Nxënësit braktisës	1%	13%	42%	44%	69
Nxënësit potencialë për ta braktisur shkollën	1%	22%	40%	38%	69
Nxënësit që kanë probleme me sjellje dhe në të nxënë	1%	33%	24%	42%	72
Përshtatjen e metodave të punës /mësimdhënies në funksion të uljes së braktisjes	4%	42%	16%	38%	69
Masat tjera për parandalimin e braktisjes	5%	25%	37%	34%	65

Tabela 6.15. Temat e takimeve të mësimdhënësve për parandalimin e braktisjes dhe shpeshësia e takimeve

Për asnjëherë nga temat e diskutimeve për parandalimin e braktisjes nuk kanë dhënë përgjigje të gjithë mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim. Vlen të veçohet se mësimdhënësit takohen shpesh për të diskutuar për nxënësit braktisës, takohen vetëm disa herë dhe jo shpesh, apo çdoherë për nxënësit potencialë për ta braktisur shkollën, të cilët në një moment të caktuar mund të jenë braktisës, takohen shpesh për nxënësit që kanë probleme në sjellje dhe në të nxënë, takohen çdoherë për përshtatjen e metodave të punës apo të mësimdhënies në funksion të reduktimit të braktisjes dhe disa herë takohen për të diskutuar për të marrë masa të tjera për parandalimin e braktisjes.

\* Disa përqindje nuk dalin gjithëherë 100%. Kjo është kështu për shkak të rumbullakimit të shifrave.

## Kapitulli VII

### 7. Parashikimi dhe parandalimi i braktisjes

Hulumtimi është i orientuar në drejtim të gjetjes së argumenteve të braktisjes së shkollës dhe të mundësive të parandalimit të saj. Parashikimi dhe parandalimi i braktisjes ndërlidhen me identifikimin e nxënësve që më së shumti janë në rrezik për të braktisur shkollën, me identifikimin e llojeve të mësimdhënies që e rrisin rrezikun për braktisje, si dhe me gjetjen e argumenteve lidhur me atë se çka bëjnë dhe çka nuk bëjnë shkollat lidhur me parandalimin e braktisjes.

#### 7.1. Cilët nxënës janë më së shumti në rrezik për ta braktisur shkollën?

Në të gjithë kapitujt paraprakë janë prezantuar argumente të ndryshme për nxënësit që janë në rrezik për ta braktisur shkollën. Në vazhdim të këtij kapitulli do të bëjmë sintezë të këtyre argumenteve, duke veçuar nxënësit që janë në rrezik për ta braktisur shkollën.

Nëse i referohemi kapitullit për të dhënat hyrëse të nxënësve, shohim nga këto të dhëna se nxënësit më në rrezik për ta braktisur shkollën janë nxënësit prindërit e të cilëve janë të paarsimuar, apo kanë nivel të ulët të arsimimit, që nuk janë të punësuar etj. Në veçanti më në rrezik janë nxënësit që i kanë të dy prindërit në këto nivele. Rreth 5% e nxënësve e kanë nënën të paarsimuar, kurse rreth 2% të nxënësve e kanë babën të paarsimuar. Ndërsa mbi 38% të nxënësve nënën e kanë vetëm me arsim fillor, kurse 13% të nxënësve babën e kanë me këtë nivel të arsimimit. Identifikimi me kohë i këtyre karakteristikave të prindërve të nxënësve dhe monitorimi e angazhimi i kujdesshëm i shkollës dhe mësimdhënësve me këtë grup të nxënësve është një masë parandalimi i braktisjes së shkollës nga këta nxënës.

Grupi tjetër i nxënësve në rrezik për ta braktisur shkollën janë nxënësit të cilët e kanë zgjedhur shkollën dhe profilin arsimor vetëm e vetëm se ka mbetur mundësia e fundit. Kjo nënkupton se ky grup i nxënësve paraprakisht nuk është informuar për shkollën, për profilet arsimore dhe për mundësitë e ngritjes në nivele të tjera arsimore. Kjo bën që ky grup i nxënësve të startojë vitin shkollor me përgatitje jo të duhura dhe për pasojë mund të ndikojë edhe në braktisje të shkollës. Këtë grup e përbëjnë rreth

15% e nxënësve të përfshirë në hulumtim. Identifikimi me kohë i nxënësve që kanë zgjedhur shkollën dhe profilin arsimor si mundësi të fundit të mbetur dhe angazhimi i shkollës dhe mësimdhënësve për të ofruar informata të nevojshme lidhur me shkollën dhe perspektivat e profilit arsimor të “zgjedhur” janë një masë parandaluese e braktisjes.

Grupi i radhës i nxënësve në rrezik për ta braktisur shkollën janë nxënësit që pak ose aspak janë të kënaqur me shkollën. Rreth 6% e nxënësve kanë treguar pakënaqësinë e tyre me shkollën. Ambienti shkollor, në veçanti sjelljet jo të mira të nxënësve, dhuna në shkollë dhe dukuritë e tjera negative janë aspekte që më së shumti ndikojnë në pakënaqësinë e nxënësve ndaj shkollës. Trajtimi i tyre me kohë dhe pjesëmarrje të të gjithë faktorëve të bashkëpunimit (nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe drejtuesve të shkollës) bënë që të krijohet klimë pozitive në shkollë, e cila drejtpërdrejt ndikon në parandalimin e braktisjes.

Nxënësit në rrezik për braktisje janë edhe ata nxënës të cilët nuk arrijnë të integrohen në klasa me numër të madh të nxënësve në klasë. Rreth 20% e nxënësve të përfshirë në hulumtim kanë treguar shkallë të ulët të kënaqësisë me numrin aktual të nxënësve në klasë. Numri i madh i nxënësve në klasa ndikon në paraqitjen e situatave të ndryshme të prishjes së rendit dhe disiplinës në klasë, në paraqitjen e vështirësive për arritjen e rezultateve mësimore etj. Vetëm puna aktive e mësimdhënësve me nxënës në këto klasa bënë që nxënësit të ndihen më mirë, të integrohen më shpejt në klasë dhe të parandalojnë braktisjen e mundshme.

Grupi tjetër i nxënësve në rrezik për ta braktisur shkollën janë nxënësit, kërkesat e të cilëve nuk merren seriozisht nga mësimdhënësit e tyre dhe nxënësit të cilët janë të pakënaqur me atë që u ofrojnë profesorët. Mbi 21 % e nxënësve kanë vlerësime të ulëta (nota 1 dhe 2) për profesorët që nuk i marrin seriozisht kërkesat e tyre. Analiza e ndërlidhjes se vlerësimit të nxënësve për raportet me mësimdhënësin dhe deklaratimit të tyre për atë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore tregon se përqindja më e lartë e nxënësve që nuk do të vazhdojnë shkollën pas pushimeve verore është në grupin e nxënësve që nuk janë të kënaqur me atë që u ofrojnë profesorët. Mirëpo, edhe nxënësit që kanë vlerësuar me notë të lartë pozitive (4 dhe 5) për aspektet e lidhura me mësimdhënies tregojnë indikacione të braktisjes edhe te nxënësit që do të vazhdojnë shkollën pas pushimeve verore dhe te nxënësit që nuk din çka do të bëjnë pas pushimeve verore. Tabela në vijim pasqyron të dhënat për nxënësin që vlerësojnë me shkallë të lartë raportet me mësimdhënësin dhe ndërlidhja e tyre me përqindjet e nxënësve që kanë

deklaruar se nuk do të vazhdojnë shkollën, do të vazhdojnë shkollën dhe nuk e dinë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore.

Aspekte të lidhura me raportet me mësimdhënës (shkalla e kënaqësisë nga vlerësimi me 4 dhe 5)	Nxënësit që nuk do të vazhdojnë shkollën pas pushimeve verore	Nxënësit që do të vazhdojnë shkollën pas pushimeve verore	Nxënësit që nuk dinë se çka do të bëjnë pas pushimeve verore	Totali
Jam i kënaqur me atë që na ofrojnë profesorët	57%	71%	73%	71%
Profesorët i marrin seriozisht kërkesat e mia	50%	63%	64%	61%
Mund të bisedoj lirshëm me mësimdhënës për problemet e mia	74%	82%	81%	80%

Tabela 7.1. Ndërlidhja e përgjigjeve të nxënësve që vlerësojnë me notë të lartë raportet me mësimdhënës, me deklaratimet e tyre për atë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore

Nga numri i nxënësve që deklarohen se pas pushimeve verore do të vazhdojnë shkollën, 37% e tyre vlerësojnë me shkallë mesatare dhe të ulët seriozitetin e marrjes së kërkesave të tyre nga profesorët, po ashtu edhe nga totali i numrit të nxënësve që deklarohen se pas pushimeve verore nuk e dinë se çfarë do të bëjnë, 36% e tyre vlerësojnë me shkallë mesatare dhe të ulët seriozitetin e marrjes së kërkesave të tyre nga profesorët. Edhe përqindjet e nxënësve që nuk janë të kënaqur me atë që ofrojnë profesorët e tyre, por që deklarohen se pas pushimeve verore do të vazhdojnë shkollën janë të larta, 29% e tyre vlerësojnë me shkallë mesatare dhe të ulët shkollën e kënaqësisë së tyre me atë që u ofrojnë profesorët. Pra, përveç rrezikut të braktisjes së shkollës nga nxënësit që deklarohen se nuk do të vazhdojnë shkollën pa pushimeve verore, nuk janë pa rrezik edhe nxënësit që kanë deklaruar se do të vazhdojnë shkollën pas pushimeve verore, por që në vlerësimin e tyre tregojnë shkallë të lartë të pakënaqësisë me atë që u ofrojnë profesorët e tyre dhe me faktin se janë të pakënaqur me marrjen parasysh të kërkesave dhe nevojave të tyre nga profesorët.

Vlerësimet me shkallë të lartë të kënaqësisë për raportet me mësimdhënës konkretizohen edhe në figurën në vijim.




Figura 7.1. Ndërlidhja grafike e përgjigjeve të nxënësve që vlerësojnë me shkallë të lartë raportet me mësimdhënës me deklaratimet e tyre për atë se çfarë do të bëjnë pas pushimeve verore

Nxënësit e klasës së 10-të janë nxënës të moshës së ndjeshme. Kjo moshë e të rinjve reagon me forma të ndryshme në kundërpërgjigje ndaj mosplotësisht të kërkesave të tyre, si me ikje nga orët e mësimin, me largim disaditor nga shkolla dhe në raste të veçanta edhe me braktisje të shkollës. Marrja për bazë e kërkesave të arsyeshme të nxënësve bënë që ata të ndihen mirë dhe të respektojnë edhe kërkesat e të tjerëve, si të prindërve dhe mësimdhënësve. Edhe shqyrtimi i kërkesave të paarsyeshme dhe komunikimi i hapur për pamundësinë e plotësisht të tyre ka efektet e veta parandaluese në shumë dukuri që e pengojnë klimën pozitive në shkollë, pra edhe në parandalimin e braktisjes.

Në veçanti, nxënësit që ikin nga orët e mësimin janë më së shumti në rrezik për ta braktisur shkollën. Gjithsesi prej tyre më së shumti në rrezik janë nxënësit që ikin shpesh dhe shumë shpesh prej orëve të mësimin. Mbi 3% e nxënësve ikin shpesh dhe shumë shpesh nga orët e mësimin. Nuk janë pa rrezik edhe nxënësit që ikin nganjëherë nga orët e mësimin, sepse kjo pastaj mund të krijojë shprehi të ikjes nga orët e mësimin, që fillimisht i shpie me ikje të shpeshta nga orët e mësimin dhe pastaj me braktisje. Mbi 54% e nxënësve të përfshirë në hulumtim ikin nganjëherë nga orët e mësimin. Edhe statistikat e shkollave për mungesat e nxënësve nga orët e mësimin tregojnë shifra alarmante të mungesave të paarsyeshme të nxënësve nga mësimi. Monitorimi i rregullt i vijueshmërisë së nxënësve në mësim është masë

parandaluese e zvogëlimit të ikjeve nga orët e mësimit dhe e braktisjes së shkollës.

Grupi tjetër i nxënësve në rrezik për ta braktisur shkollën janë nxënësit që nuk janë të përgatitur për mësim, që tregojnë sukses të dobët në mësim. Mbi 53% e nxënësve janë shprehur se ikin nga orët e mësimit sepse nuk janë të përgatitur për mësim. Po ashtu edhe analiza e rezultateve të nxënësve në fund të gjysemvjetorit të parë nxjerrë në sipërfaqe një përqindje të lartë të nxënësve (mbi 46% të nxënësve) që kanë më shumë se tri nota të dobëta (1), të cilët janë potencial për ta braktisur shkollën për shkak të pakënaqësisë së tyre me rezultatet fillestare në shkollën e mesme të lartë. Prandaj, është më rëndësi që me kohë të identifikohen nxënësit që kanë vështirësi në mësim dhe të ndihmohen në tejkalimin e vështirësive që kanë. Me këtë grup të nxënësve duhet të krijohen raporte më të afërta, duhet të theksohen anët e forta të tyre në mësim dhe gradualisht të ndikohet në kthimin e besimit të tyre se mund të arrijnë suksese në mësim kur mësojnë në mënyrë sistematike dhe në mënyrë logjike.

Nxënësit që kanë kushte të vështira ekonomike janë grupi tjetër i nxënësve në rrezik për ta braktisur shkollën. Mbi 31 % e nxënësve kanë theksuar se arsye kryesore e braktisjes janë kushtet ekonomike. Kjo e shton rrezikun kur për shkaqe ekonomike një përqindje e konsiderueshme e nxënësve detyrohen të punojnë për të siguruar ekzistencën e tyre dhe familjes. Afër 9 % të nxënësve janë shprehur se pas pushimeve verore do të kërkojnë punë, që nënkupton se ky grup i nxënësve janë në rrezik më të madh për ta braktisur shkollën.

Në rrezik për ta braktisur shkollën janë edhe grupi i nxënësve (mbi 10 %) që pas pushimeve verore nuk e dinë së çfarë do të bëjnë, si dhe grupi i nxënësve (9%) që pas pushimeve verore do të kërkojnë punë. Kërkohej një mobilizim i veçantë i shkollës në fillim të vitit shkollor për të identifikuar nxënësit që kanë dilema në vazhdimin e shkollimit, në ndërrimin e profileve apo në aspekte të tjera që lidhen me vijueshmërinë e tyre në shkollë. Nuk janë pa rrezik për braktisje edhe nxënësit familjet e të cilëve migrojnë jashtë vendit.

## 7.2. Cilat stile të mësimdhënies rrisin rrezikun për braktisje?

Në kapitullin e 5-të kemi trajtuar mësimdhënien dhe stilet e mësimdhënies mbi bazën e pritjeve të nxënësve për mësimdhënës, afërsinë e mësimdhënësve me nxënës, mënyrat alternative të komunikimit që i përdorin mësimdhënësit me nxënës që kanë probleme në mësim, mënyrat e

menaxhimit të detyrave të shtëpisë, bashkëpunimin dhe format e bashkëpunimit me prindër. Analiza e të dhënave të cituara më lart ka nxjerrë në sipërfaqe llojet e mësimdhënies që rrisin rrezikun për braktisje.

Mësimdhënia që nuk është atraktive shkakton monotoni, pasivitet dhe humbje të interesimit të nxënësve për mësim dhe rrit rrezikun për braktisje. Mbi 33% e nxënësve kërkojnë që mësimdhënia të jetë më atraktive dhe të përfshihen më shumë në aktivitete të ndryshme. Kjo e dhënë tregon shkallën e pakënaqësisë së tyre me mësimdhënien. Po ashtu, edhe mësimdhënësit në përqindje të lartë, mbi 55% e tyre, janë të pakënaqur me aplikimin e teknologjisë së re të mësimdhënies, kjo bën që mësimdhënia të mos jetë atraktive dhe të ndikojë në braktisje të shkollës nga nxënësit. Në mënyrë të veçantë, kjo ndikon në shkollat profesionale kur kemi parasysh specifikat e saj, lidhjen e teorisë me praktikën etj.

Mësimdhënia që nuk reflekton afërsinë e duhur me nxënës ndikon në rritjen e rrezikut të braktisjes, sepse në mungesë të afërsisë së duhur me nxënës nuk krijohen relacione të mira me nxënës, nuk njihet situata e të gjithë nxënësve dhe nuk merren në konsideratë nevojat e veçanta të nxënësve me sukses të dobët.

Mësimdhënia që nuk ndërtohet me mënyra alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim rrit rrezikun për braktisje. Mbi 22 % e mësimdhënësve vetëm në raste të veçanta përdorin mënyra alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim. Mosndërtimi i mësimdhënies me forma alternative të komunikimit bën që të mos trajtohen në mënyrë të veçantë kërkesat e nxënësve, nevojat dhe interesimet e tyre.

Mësimdhënia që nuk pasurohet me menaxhim cilësor të detyrave të shtëpisë e humb seriozitetin e këtyre të fundit, e humb interesimin e nxënësve për të përmbushur detyrat dhe obligimet mësimore të caktuara, e nxit pasivitetin e nxënësve dhe rrit rrezikun e braktisjes së shkollës. Mësimdhënia e mbështetur me detyra të shtëpisë, me kontrollim sistematik të tyre dhe me njoftim me rezultatet e detyrave të shtëpisë, ndikon në mobilizimin e nxënësve për të përforcuar njohuritë dhe për të nxënë njohuri të reja. Rrjedhimisht kjo qasje ndihmon në ngritjen e shkallës së kënaqësisë së nxënësve për shkollën dhe mësimdhënësit dhe kjo pastaj mund të zvogëlojë braktisjen.

Mësimdhënia që nuk i identifikon nxënësit potencialë që mund ta braktisin shkollën nuk reflekton në parimet gjithëpërfshirëse, nuk siguron ndërmarrjen e masave preventive në parandalimin e braktisjes dhe rrjedhimisht lejon të rritet rreziku për braktisje të shkollës nga nxënësit. Mësimdhënia e drejtuar nga parimi i mësimdhënies me nxënësin në qendër

nga parimi gjithëpërfshirës mundëson në identifikimin me kohë të nxënësve potencialë për braktisje të shkollës. Andaj, përveç zbatimit të metodave të përgjithshme dhe specifike të mësimdhënies në arsimin profesional, duhet zbatuar edhe parimin gjithëpërfshirës në mësimdhënie, në mënyrë që të gjithë nxënësit të jenë të angazhuar aktivisht në procesin mësimor dhe me kohë të bëhet identifikimi i nxënësve potencialë që mund ta braktisin shkollimin.

### 7.3. Çka bëjnë shkollat për parandalimin e braktisjes?

Parandalimi i braktisjes është i lidhur ngushtë me shkollën dhe mësimdhënësit, me punën dhe angazhimin e tyre. Mësimdhënësit janë të parët në shkollë që mund të kuptojnë për nxënësit që ikin nga orët e mësimi, për nxënësit që kanë vështirësi dhe probleme në mësim, për nxënësit që tregojnë karakteristika të braktisjes. Informimi me kohë i prindërve, drejtuesve të shkollave, është mundësia e parë e parandalimit të braktisjes.

Lidhur me atë se çka bëjnë shkollat dhe çka nuk bëjnë në parandalimin e braktisjes, kemi siguruar informacione nëpërmjet takimeve të para me drejtorë të shkollave të përfshira në hulumtim, si dhe nëpërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim. Bëhen përpjekje në evidentimin me kohë të rasteve të nxënësve që kanë mungesa të shumta nga mësimi, në bashkëpunimin me prindër në përmirësimin e vijueshmërisë, si dhe në ndërmarrjen e masave edukative e disiplinore në bazë të kodit të mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta. Në të shumtën e rasteve, angazhimet e tilla nuk tregojnë rezultate dhe për pasojë një numër i nxënësve e braktisin shkollën.

Mbi 47 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim shprehen se shkolla nuk ka bërë asgjë të veçantë për parandalimin e braktisjes. Po e njëjta përqindje e nxënësve shprehen se për parandalimin e braktisjes shkolla i ka ftuar prindërit në mbledhje. Për të dy rastet informacioni tregon se nuk bëhen publike aktivitetet e shkollës në parandalimin e braktisjes (ose mungojnë plotësisht aktivitetet parandaluese), nuk përfshihen nxënësit në këto aktivitete etj. Pavarësisht numrit të nxënësve që e kanë braktisur shkollën, në shkollat ku ne e kemi realizuar hulumtimin kanë munguar fushatat e veçanta të këtyre shkollave për parandalimin e braktisjes, qoftë përmes informimit publik, debateve, apo programeve tjera të veçanta. Vetëm 6 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se shkolla ka bërë fushatë për parandalimin e braktisjes.

Diskutimet me nxënës për pasojat e braktisjes nuk bëhen nga të gjithë mësimdhënësit. Rreth 44% e mësimdhënësve vetëm ndonjëherë bisedojnë me nxënës për pasojat e braktisjes, kurse pjesa tjetër bisedojnë çdo muaj (16%), çdo javë mbi 40 %. Duke marrë për bazë moshën e nxënësve dhe fazat kritike të zhvillimit të tyre, shkolla dhe mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshme që çdoherë me nxënës të diskutojnë pasojat afat shkurtra dhe afatgjata të braktisjes.

Takimet e mësimdhënësve me kolegë/mësimdhënës, në funksion të parandalimit të braktisjes, janë aktivitete që në përgjithësi i bëjnë mësimdhënësit, por jo edhe në shpeshësinë e duhur. Edhe në këtë pikë ekziston një përqindje e lartë e mësimdhënësve (20%) që janë shprehur se asnjëherë nuk marrin pjesë në takimet me kolegë në funksion të parandalimit të braktisjes. Dukuria e braktisjes së shkollës është çështje problemore për të gjithë mësimdhënësit e shkollës, vetëm me veprime të përbashkëta dhe të harmonizuara braktisja mund të parandalohet.

Mësimdhënësit gjatë takimeve të tyre diskutojnë për tema të ndryshme që lidhen me parandalimin e braktisjes. Të dhënat e hulumtimit me mësimdhënës tregojnë se temat për parandalimin e braktisjes që më së shumti diskutohen në mes të mësimdhënësve janë: *nxënësit që kanë probleme me sjellje dhe në të nxënë, përshtatja e metodave të punës/mësimdhënies në funksion të reduktimit të braktisjes*. Ndërsa më pak diskutohen temat e veçanta si: *nxënësit potencialë për ta braktisur shkollën, masat e tjera për parandalimin e braktisjes, dhe nxënësit braktisës*. Tema e identifikimit të nxënësve që janë potencialë për ta braktisur shkollën duhet të diskutohet çdoherë, sepse është çelësi hyrës në rrugën e parandalimit të braktisjes.

Çështja e parandalimit të braktisjes nuk është çështje vetëm e shkollës dhe e mësimdhënësve, por edhe e prindërve dhe komunitetit. Bashkëpunimi aktiv i mësimdhënësve me prindër bën që prindërit të jenë partnerë në parandalimin e braktisjes. Shkollat dhe mësimdhënësit tanë bashkëpunojnë me prindër, por jo në mënyrë aktive dhe në raste të veçanta edhe vetëm me një pjesë të prindërve. Vetëm 30% e mësimdhënësve shprehen se bashkëpunojnë me të gjithë prindërit, pjesa tjetër, mbi 59%, bashkëpunojnë me disa prindër, kurse mbi 10% bashkëpunojnë vetëm me prindërit e nxënësve që vetë marrin iniciativë për t'i kontaktuar, pra këta të fundit fare nuk tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar me prindër në parandalimin e braktisjes.

Shkolla dhe mësimdhënësit bashkëpunojnë me prindër vetëm nëpërmjet takimeve të rregullta, takimeve formale. Nuk praktikohen forma alternative të bashkëpunimit, si p.sh. përmes emailit/letërkëmbimeve. Dinamika e jetës

në përgjithësi dhe dinamika e jetës shkollore në veçanti nuk lejojnë komoditet të bashkëpunimit vetëm përmes takimeve formale, braktisja nuk pret, ajo duhet parandaluar në momentin që shihet që mund të ndodhë. Çdo formë e shpejtë e bashkëpunimit që sjellë rezultate në këtë drejtim duhet shfrytëzuar.

Çështja e parandalimit të dukurisë së braktisjes së shkollës meriton vëmendje të veçantë dhe angazhim të përhershëm nga shkolla dhe faktorët e tjerë të lidhur ngushtë me të. Për këtë shkolla duhet të ketë kulturë të lartë organizative dhe menaxhuese. Formimi i ekipeve në nivel të shkollës për ta trajtuar drejt dhe me kohë braktisjen “do të sigurojë rezultate të prekshme në realizimin e objektivave të shoqërisë sonë për krijimin e mundësive për shkollim dhe shanse të barabarta për çdo nxënës”<sup>26</sup>.

## Kapitulli VIII

### 8. Përfundime dhe rekomandime

Hulumtimi “*Braktisja e shkollimit në arsimin e mesëm profesional në Kosovë*”, i realizuar me mbështetjen e ETF-it, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të hulumtuesve të IPK-së, është realizuar në pesë komuna, përkatësisht në 6 shkolla profesionale në Kosovë. Hulumtimi për braktisjen e shkollimit në arsimin profesional rezultoi të jetë mjaft i rëndësishëm, aktual, sfidues dhe njëkohësisht interesant për ekipin hulumtues dhe për të gjithë subjektet e përfshirë në hulumtim.

Si rrjedhojë e hulumtimit të realizuar me metodologji kuantitative dhe kualitative, kanë dalë gjetje relevante të braktisjes dhe rekomandime për parandalimin e braktisjes, të bazuara në gjetjet kryesore.

<sup>26</sup> Dr. Afërdita Deva – Zuna & bashkautorët (2009): Partneriteti shkollë – familje – komunitet (sfidë vijanoze), Libri Shkollor, fq. 379.

### 8.1. Vlerësimi i hulumtimit

Hulumtimi është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative. Një shembull i mirë ishte pastrimi i të dhënave/kontrolli i kualitetit, i cili është bërë me kujdes të veçantë duke respektuar të gjithë hapat metodologjikë të pastrimit të të dhënave/kontrollit të kualitetit, prej ruajtjes së të dhënave origjinale deri të pastrimi final dhe përpunimi i tyre.

Është zbatuar qasja e hulumtimit kabinetik, përmes së cilës janë konsultuar politikat arsimore që trajtojnë braktisjen, statistikën në arsim, hulumtimet e deritashme në fushën e braktisjes etj. Po ashtu është zbatuar hulumtimi përmes anketës, e cila ndihmoi në pasqyrimin e këndvështrimeve të nxënësve dhe mësimitdhënësve për kompleksitetin e dukurisë së braktisjes.

**Përparësitë.** Përfundimi me sukses i hulumtimit pilot karakterizohet me disa përparësi. Në mesin e përparësive kryesore mund të veçojmë:

- Në radhë të parë vlen për t'u veçuar puna e përbashkët e ekipit hulumtues. Ekipi hulumtues që nga faza e hartimit të projektit të hulumtimit dhe deri në fund të tij ka treguar përkushtim, përvojë profesionale, gatishmëri për të bashkëpunuar dhe ndihmuar njëri-tjetrin në të gjitha fazat e të zhvillimit të hulumtimit.
- Përkrahja nga ETF-ja në funksion të ngritjes së kapaciteteve të IPK-së.
- Partneriteti i ngushtë me drejtorë të shkollave, mësimitdhënës, nxënës, përfaqësues të MASHT-it dhe me përfaqësues të donatorëve mbështetës të arsimit në Kosovë për të gjitha aspektet e hulumtimit. Ekipi hulumtues në asnjë rast nuk ka hasur në pengesa për sigurimit e të dhënave që lidhen me fushën e hulumtimit.
- Mbledhja e të dhënave nga disa burime: nga treguesit statistikorë të numrit të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, 2005/2006–2009/2010, nga analiza e masave politike për parandalimin e braktisjes, nga analiza e përkrahjes së donatorëve, nga analiza e gjetjeve të hulumtimeve tjera, nga anketimi i nxënësve të klasës së 10-ë në shkollat profesionale dhe mësimitdhënësve të tyre dhe nga analiza e të dhënave të marra nga drejtorët e shkollave siguroi qasjen kuantitative dhe kualitative të hulumtimit.

Natyrisht, hulumtimi ynë ka pasur edhe **kufizimet** e veta, të cilat vlen t'i veçojmë:

- Koha e realizimit të hulumtimit. Puna përgatitore dhe realizimi i hulumtimit në shkollat e përzgjedhura është bërë në pjesën e dytë të muajit maj të vitit 2010. Ishin ditët e fundit të mësimin të rregullt në klasat e 10-ta. Kjo paraqiti vështirësi, për shkak se nxënësit dhe mësimdhënësit ishin në fazën finale të vlerësimeve të brendshme. Megjithatë, nuk kemi pasur refuzime për takime me mësimdhënës dhe nxënës dhe për plotësimin e pyetësorëve të hulumtimit, edhe pse disa prej tyre gjatë përpunimit shihej se janë plotësuar në mënyrë të shpejtë dhe në disa raste nxënësit apo mësimdhënësit binin në kontradiktë me vetveten.
- Gjithashtu, është vërejtur se disa nga pyetjet nuk janë kuptuar si duhet, sidomos përmbajtjet e tabelave, të cilat kanë pasur më shumë se një karakteristikë për të dhënë përgjigje dhe për pasojë disa nga nxënësit nuk i kanë plotësuar të gjitha karakteristikat e vëna në tabela.
- Një kufizim tjetër ka qenë mungesa e të dhënave të plota statistikore për arsimin profesional, sidomos për nxënësit që e kanë kryer nivelin e parë dhe kanë kaluar në nivelin e dytë, e pastaj në nivelin e tretë. Po ashtu kanë munguar të dhënat statistikore për lëvizjen e nxënësve nga shkollat profesionale, në gjimnaze dhe anasjelltas. Prandaj jemi detyruar që paralelisht t'i përpunojmë edhe të dhënat e gjimnazeve, me qëllim që të shohim lëvizjen e nxënësve dhe të gjejmë ndryshimet - braktisjen nga gjenerata në gjeneratë.
- Dhe kufizim tjetër ka qenë mospërfshirja e komuniteteve tjera në hulumtim, për shkak të kohës së kufizuar.

### 8.3. Gjetjet më të rëndësishme nga hulumtimi

Qëllimi kryesor i hulumtimit është verifikimi ose rënia e hipotezës së parashtruar të hulumtimit si dhe arritja e objektivave të dhëna në fillim të hulumtimit. Hipoteza kryesore e hulumtimit ishte se një numër i caktuar i konsiderueshëm i nxënësve që e regjistrojnë shkollimin e mesëm të lartë - klasën e 10-të, e ndërpresin shkollimin. Çështja e dukurisë së braktisjes së shkollimit në të gjitha nivelet e shkollimit botërisht ka qenë e ditur, por shkaqet e braktisjes nuk janë ditur saktësisht. Synim i ekipit hulumtues ishte pikërisht që të gjenden dhe verifikohen shkaqet e vërteta të braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve, por edhe gjetja e shkaqeve për nxënësit potencialë për të braktisur shkollimin. Këtu do të përpiqemi të përfshijmë treguesit më të rëndësishëm për dukurinë e braktisjes dhe treguesit më të rëndësishëm për nxënësit potencialë për të braktisur shkollimin, të dala nga analiza e statistikave të arsimit të mesëm të lartë dhe nga hulumtimi i realizuar në mostër të caktuar.

#### *Gjetjet nga hulumtimi përmes analizës së statistikave kombëtare në arsimin e mesëm të lartë tregojnë se:*

- Përqindja e përfshirjes së nxënësve nga klasa e 9-të në klasën e 10-të është në rritje. Për dallim nga viti shkollor 2006/2007, kur në klasën e 10-të janë përfshirë 87% e nxënësve, përfshirja e nxënësve në klasën e 10-të në vitin 2009/2010 ka arritur në 93%;
- Edhe pse është rritur përfshirja e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, braktisja e shkollës në kalimin nga klasa e 10-të në klasën e 11-të është përafërsisht e njëjtë, nga 12 % deri në 17% në gjimnaze dhe shkolla profesionale, kurse vetëm në shkolla profesionale nga 14% deri në 19%;
- Djemtë në përqindje më të lartë regjistrohen në klasën e 10-të dhe gjithashtu në përqindje më të lartë e braktisin klasën e 10-të. Për dallim prej djemve, vajzat në përqindje më të ulët regjistrohen në klasën e 10-të (rreth 16 % e vajzave që kanë përfunduar klasën e 9-të në vitin shkollor 2008/2009 nuk janë regjistruar në klasën e 10-të në vitin vijues), dhe në përqindje më të ulët e braktisin shkollën;



- Me gjithë përpjekjet e MASHT-it për të siguruar të dhëna statistikore të plota për nxënësit dhe përfshirjen e tyre në shkollën e mesme të lartë, akoma mungojnë të dhënat statistikore për të identifikuar saktësisht numrin e nxënësve që e kanë braktisur shkollën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë edhe arsimin profesional. Gjithashtu, mungojnë të dhënat e plota për rikthimin në shkollë të nxënësve braktisës, si dhe të nxënësve që e kanë përsëritur klasën - të dhëna për regjistrimin e tyre, apo mosregjistrimin e tyre;
- Numri i nxënësve që e humbin vitin shkollor në klasën e 10-të është shumë më i lartë se në klasat e tjera. Nxënësit që e humbin klasën dhe nuk e përsërisin klasën në vitin vijues nuk raportohen si nxënës braktisës;
- Lëvizjet e nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, të së njëjtës komunë dhe në komuna të tjera, nuk përcillen në formën e duhur dhe për pasojë në raste të veçanta, sidomos në klasën e 10-të, raportohen nxënësit si braktisës, edhe në rastet kur e kanë ndërruar shkollën në komunën e njëjtë apo edhe në komuna të tjera;
- Zyra e arsimit profesional në MASHT nuk ka person përgjegjës për përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore në arsimin profesional, pavarësisht se mbi 56 % të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë i takojnë arsimit profesional dhe pavarësisht specifikave që kanë profilet arsimore të arsimit profesional.

#### ***Gjetjet nga hulumtimi me nxënës tregojnë se:***

- Mbi 6 % e nxënësve të përfshirë në hulumtim shprehen se janë të pakënaqur me zgjedhjen e shkollës dhe të profilit arsimor, ndërsa 14 % e nxënësve janë mesatarisht të kënaqur me zgjedhjen e shkollës dhe të profilit arsimor. Pjesa tjetër shprehin shkallë të lartë të kënaqësisë.
- Aspektet që më së shumti reflektojnë shkallë të pakënaqësisë së nxënësve me procesin mësimor janë numri i madh i nxënësve në klasa dhe ambienti shkollor (sjelljet dhe dukuritë negative);

- Mbi 20% e nxënësve nuk mund të bisedojnë lirshëm me mësuesin e tyre. Po e njëjta përqindje në shkollë të lartë e kanë vlerësuar nevojshme të ndërrohen profesorët që aktualisht janë mësues të tyre, për shkak se janë të pakënaqur me punën e tyre;
- Mbi 21% e nxënësve kanë vlerësime të ulëta për profesorët që nuk i marrin seriozisht kërkesat e tyre. Kërkesat e tyre shpesh kanë të bëjnë edhe me problemet me të cilat ballafaqohen ata dhe që kanë nevojë të kërkojnë ndihmë për zgjidhjen e tyre;
- Mbi 33% e nxënësve kërkojnë që mësuesit të jetë më atraktive dhe të përfshihen më shumë në aktivitete të ndryshme. Kjo e dhënë tregon shkallën e pakënaqësisë së tyre me mësuesin;
- Mbi 22% e mësuesve vetëm në raste të veçanta përdorin mënyra alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim. Mosndërtimi i mësimit me forma alternative të komunikimit bën që të mos trajtohen në mënyrë të veçantë kërkesat e nxënësve, nevojat dhe interesimet e tyre;
- Nxënësit shprehen se më së shumti u mungon vlerësimi që ndihmon në intervenimin për përmirësim të rezultateve të tyre dhe për pasojë ata ndiejnë se nuk janë duke u përmirësuar dhe nuk dinë se si të përmirësohen, në mënyrë që të sigurojnë rezultate më të larta në të nxënë;
- Pritjet e nxënësve nga shkolla dhe mësuesit janë relativisht të ulëta,
- Djemtë ikin më shpesh sesa vajzat nga orët e mësimi;
- Arsyet kryesore të ikjes së nxënësve nga orët e mësimi lidhen me mospërgatitjen e nxënësve për orët e mësimi, pastaj me lodhjen e nxënësve paraprakisht, me orët mësimore të mërzitshme, me mospëlqimin e mësuesve etj;
- Ikjet nga orët e mësimi reflektojnë edhe në braktisje të shkollës. Edhe arsyet e braktisjes së shkollës lidhen me suksesin e dobët në mësim (këtë e kanë shprehur 42% e nxënësve) dhe me kushtet e vështira ekonomike ( 31% e nxënësve);

- Nxënësit (47% e tyre të përfshirë në hulumtim) reflektojnë se shkollat pak kanë bërë në parandalimin e braktisjes së shkollës dhe në kthimin në shkollë të nxënësve braktisës;
- Nxënësit më të rrezikuar (nxënësit potencialë) për ta braktisur shkollën janë ata që pas klasës së 10-të nuk dinë se çfarë do të bëjnë (11% e tyre) dhe nxënësit që pas klasës së 10-të do të kërkojnë punë (9% e tyre) për nevoja personale dhe familjare.

### ***Gjetjet nga hulumtimi me mësimdhënës tregojnë se:***

- Në përgjithësi mësimdhënësit reflektojnë shkallë mesatare të kënaqësisë me aspektet kryesore të lidhura me procesin mësimor. Mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim shkallën më të lartë të pakënaqësisë e kanë me aplikimin e teknologjisë në procesin mësimor, 35% e mësimdhënësve vlerësojnë me notën me të ulët (1) dhe 21% me notën minimale (2). Po ashtu mësimdhënësit shprehin pakënaqësitë e tyre me kushtet në të cilat realizohet mësimdhënia (21% e tyre vlerësojnë me notë të ulët), pastaj me sjelljet e nxënësve (19% vlerësojnë me notë të ulët);
- Format e bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindër nuk janë relevante në raport me adresimin e drejtë të braktisjes. Vetëm 30% e mësimdhënësve deklarojnë se mbajnë takime të rregullta me të gjithë prindërit e nxënësve, ku debatohet edhe për çështjet e braktisjes së shkollimit. Mbi 59% bashkëpunojnë me disa prindër, kurse mbi 10% bashkëpunojnë vetëm me prindërit e nxënësve që vetë marrin iniciativë për t'i kontaktuar, pra këta të fundit fare nuk tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar me prindër për parandalimin e braktisjes. Ndërsa prej të gjithë mësimdhënësve që bashkëpunojnë me prindër, vetëm 4% e tyre këtë e bëjnë përmes emailit/letërkëmbimeve;
- Mungon iniciativa e shkollave dhe mësimdhënësve për të ndërmarrë hapa të veçantë për parandalimin e braktisjes së shkollës. Mësimdhënësit nuk përdorin çdoherë mënyra *alternative të komunikimit me nxënës që kanë probleme në mësim*.

- Treguesit kryesorë të nxënësve potencialë për braktisje të shkollës të identifikuar nga mësimdhënësit janë: *kushtet ekonomike, migrimi, mungesa e perspektives, mosinteresimi i prindërve dhe mosvijeshmëria e rregullt e nxënësve në mësim*. Pra, si rezultat i indikatorëve të lartshënuar, arsyet e braktisjes së shkollës ndërlidhen edhe me kushtet ekonomike, migrimin, suksesin e dobët në mësim;
- Ka mungesë të konsiderueshme të komunikimit të mësimdhënësve me nxënës për pasojat e braktisjes. Për këtë aspekt *shpesh* diskutojnë 56% e mësimdhënësve, kurse *ndonjëherë* bisedojnë 44% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim. Nxënësit e klasave të 10-ta kanë nevojë të diskutojnë më shumë për pasojat e braktisjes, sepse ende nuk janë në fazën e adaptimit me një nivel të ri të shkollimit;
- Ka mungesë të konsiderueshme të komunikimit të mësimdhënësve me mësimdhënës/kolegë për parandalimin e braktisjes. Rreth 20% e mësimdhënësve nuk bisedojnë asnjëherë me kolegë për parandalimin e braktisjes, rreth 33% bisedojnë ndonjëherë, kurse përqindja tjetër shprehen se bisedojnë më shpesh me kolegë për parandalimin e braktisjes;
- Të dhënat e hulumtimit me mësimdhënës tregojnë se temat për parandalimin e braktisjes që më së shumti diskutohen në mes të mësimdhënësve janë: *nxënësit që kanë probleme me sjellje dhe në të nxënë, përshtatja e metodave të punës/mësimdhënies në funksion të reduktimit të braktisjes*. Ndërsa më pak diskutohen temat e veçanta, si: *nxënësit potencialë për ta braktisur shkollën, masat e tjera për parandalimin e braktisjes dhe nxënësit braktisës*.

Sipas këtyre gjetjeve, shihet se çështja e dukurisë së braktisjes së shkollimit nuk trajtohet seriozisht as nga ana e shkollës, por as nga mësimdhënësit dhe prindërit. Nga kjo del se shkaqet e braktisjes janë të shumta dhe se duan trajtim serioz, sidomos nga shkolla, prindërit dhe nga institucionet e tjera relevante.

## 8.4. Përfundime

Braktisja e shkollës në shkollimin e mesëm të lartë është prezente dhe shumë e shprehur në vendin tonë. Shkalla e braktisjes së shkollimit është e dukshme, sidomos në shkollat profesionale të Kosovës. Edhe në këto shkolla ka dallime në braktisje, sidomos në kalimin nga klasa e 10-të në klasën e 11-të. Pasi që kjo dukuri ka filluar të marrë masa brengosëse, institucionet dhe organizatat e tjera kanë filluar të brengosen seriozisht për zbutjen ose edhe parandalimin e braktisjes së shkollimit. Po për këtë qëllim, edhe IPK-ja kishte vënë në plan pune hulumtimin e kësaj dukurie. Me këtë hulumtim synuam që të njihemi me arsyet apo shkaqet kryesore të cilat ndikojnë në braktisjen e shkollës nga nxënësit e klasës së 10-të në shkollat profesionale të Kosovës.

Identifikimi i shkaqeve të mundshme pse nxënësit e kësaj moshe e braktisin shkollimin ishte qëllimi kryesor i hulumtimit. Nëpërmjet këtij hulumtimi arritëm të gjejmë disa tregues, për të cilët mendojmë se janë ndër më kryesorët pse nxënësit e klasës së 10-të të shkollave profesionale që e braktisin shkollimin.

Me treguesit kryesorë apo edhe faktorët e braktisjes kemi konsideruar të gjithë ata faktorë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të ndikojnë në dukurinë e braktisjes së shkollimit nga nxënësit e klasave të 10-ta të shkollave profesionale.

Njëri ndër faktorët apo shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit është përmendur ndikimi i faktorit ekonomik-social.

Të gjithë këta faktorë janë ilustruar në raportin dhe analizat e bëra gjatë përpunimit të rezultateve të fituara nga hulumtimi.

Ballafaqimi i dy shtresave të mostrës u bë me qëllim që të marrim të dhëna relevante nga të dyja palët lidhur me të njëjtin problem dhe mundësinë e krahasimit të tyre në funksion të nxjerrjes së rekomandimeve.

Nga pjesa e përgjigjeve të dhëna nga ana e nxënësve dhe nga mësimdhënësit kemi nxjerrë të dhëna me rëndësi edhe për faktorin mësimdhënie dhe për kënaqësinë e nxënësve në shkollë dhe në raport me mësimdhënësit.

Shkolla ka dal si një faktor që më së paku merret me çështjen e braktisjes. Nuk gjetëm se në shkolla debatohet dhe trajtohet kjo dukuri dhe se nuk ndërmerren masa për parandalimin e dukurisë së braktisjes në shkollat profesionale.

Problem më vete paraqet edhe niveli i ulët i bashkëpunimit midis faktorëve relevantë, siç është familja dhe shkolla.

Tjetër problem është niveli i njohurive të nxënësve në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët. Për shkak se një numër i nxënësve, kandidatë potencialë për ta braktisur shkollimin, kanë nivel të ulët të njohurive, ata ndihen inferiorë në raport me të tjerët. Kështu, në vend se të bëjnë përpjekje ose të ndihmohen që të përafrojnë nivelin e njohurive me nxënësit e tjerë, ata zgjedhin rrugën e braktisjes ose të ikjes nga orët e mësimi, si zgjidhje më e përshtatshme për ta.

## 8.5. Rekomandime

Nxjerrja e rekomandimeve për parandalimin e dukurisë së braktisjes është një përpjekje për të orientuar drejt bartësit e arsimit në nivel qendror dhe lokal, shkollat dhe mësimdhënësit me ndërhyrje më efektive në sferat e përgjegjësisë së tyre për të parandaluar braktisjen e shkollës nga nxënësit e arsimit profesional.

- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në bashkëpunim me komunat dhe shkollat, duhet të krijojë një bazë të qëndrueshme të të dhënave statistikore për të identifikuar saktësisht numrin e nxënësve që e kanë braktisur shkollën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë edhe arsimin profesional;
- Raportimi i nxënësve që e braktisin shkollën duhet të jetë i kompletuar me të dhëna personale të nxënësve si: emri dhe mbiemri, viti dhe klasa e regjistrimit, viti dhe data e braktisjes, arsyet kryesore të braktisjes dhe eventualisht propozimi i masave për rikthimin e tyre në shkollë. Adresimi i informatës për nxënësit braktisës duhet të bëhet me kohë dhe në institucionin përkatës;
- Lëvizjet e nxënësve duhet të menaxhohen në mënyrë të drejtë ligjore nga shkollat. Nxënësit të regjistrohen vetëm mbi bazën e dëshmisë së sjellë nga shkolla paraprake. Pastaj, shkolla prej nga vjen nxënësi të njoftohet me fletëdëshminë përkatëse të regjistrimit të nxënësit;
- Mbështetja në ndërtimin e kapaciteteve brenda MASHT-it, nivelit komunal, shkollës dhe mësimdhënësve për trajtimin me kohë dhe në mënyrë të drejtë të dukurisë së braktisjes, duhet të jetë pjesë e planit të veprimit të të gjitha subjekteve që kanë synim rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në të gjitha shkallët e shkollimit, veçmas

në arsimin profesional, kur dihet se ky nivel i arsimit i përgatit nxënësit për tregun e punës;

- Para së gjithash, cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies në shkollë duhet të përmirësohet, në mënyrë që nxënësit të gjejnë veten e tyre në shkollë, të shohin perspektivë nga shkolla dhe profili arsimor të cilin e përfundojnë etj. Po ashtu niveli i bashkëpunimit me nxënës, prindër dhe komunitet duhet të përmirësohet në funksion të ofrimit të ndihmës nxënësve jo vetëm atyre braktisës potencialë, por edhe të atyre të cilët kanë vështirësi të tjera në mësim e shkollim;
- Në mënyrë të veçantë duhet të monitorohen nxënësit me potencial braktisës. Duhet të ekzistojë një bashkëpunim i ngushtë në mes të kujdestarit të klasës, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve;
- Organizimi i debateve në nivel të ekspertëve të fushës së arsimit, mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe subjekteve të tjera, për trajtimin e dukurisë së braktisjes dhe gjetjes së masave adekuate për parandalimin e saj, është nevojë dhe domosdoshmëri e të gjitha institucioneve arsimore, sidomos tani, kur bëhen përpjekje për ta bërë arsimin e mesëm të lartë të obligueshëm.

## **8.6. Hulumtimet në të ardhmen në fushën e parandalimit të braktisjes**

Duke e shikuar dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit në një horizont më të gjerë, dalin nevoja edhe për hulumtime të tjera në fushën braktisjes së shkollës, veçmas në aspektet e parandalimit të braktisjes. Disa nga hulumtimet e ardhshme do të mund të jenë:

- Hulumtimi i faktorëve dhe treguesve të identifikuar në hulumtimin e braktisjes, me qëllim të gjetjes së formave më të përshtatshme të trajtimit të dukurisë së braktisjes dhe identifikimin me kohë të nxënësve potencialë që mund të braktisin shkollimin, me qëllim të parandalimit të dukurisë së braktisjes.
- Hulumtimi i ndikimit të qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj nxënësve, si faktorë ndikues për braktisje.

- Hulumtimi i formave efikase të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të faktorëve relevantë, në funksion të parandalimit ose të kthimit në shkollë të nxënësve braktisës ose potencialë për braktisje.

## Referencat

- Elke Shreiber (2006) : Chancen für Schulumde, Forschungsproject von Deutesches Jugendinstitut, München.
- Grillo, Prof.dr. Kozma (2002): Fjalor edukimi, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë.
- Grup autorësh ( 2004 ): Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë, UNICEF, Prishtinë.
- Grup autorësh ( 2008 ): Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë.
- Grup autorësh (2002 ): Disa aspekte të efikasitetit në Arsimin e Kosovës, KEC, Prishtinë.
- Grup autorësh (2003): Pasqyra gjinore në sistemin arsimor në Kosovë, UNICEF, Prishtinë.
- Grup autorësh (2005): Doracak – pako strategjish, Të gjithë në shkollë ...Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë, CRS, Prishtinë.
- Grup autorësh (2005): Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës, UNICEF, Prishtinë.
- Grup autorësh (2008): Drejtë Lisbonës – vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale, si dhe i krijimit të mundësive për punësimin e femrave në zonat rurale, UNICEF, Prishtinë.
- Grup autorësh (2010): Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
- GTZ (2008): Ripërtëritja e Arsimit dhe Trajnimit Profesional në Kosovë, GTZ, Prishtinë.
- Instituti RINVEST (2009): Arsimi joformal në Kosovë, hulumtim dhe analiza e braktisjes nga arsimi i obliguar dhe arsimi i mesëm i lartë në Kosovë, Prishtinë.
- Instituti Pedagogjik i Kosovës (2010): Kërkime Pedagogjike – përmbledhje punimesh”, Prishtinë.
- MASHT & UNICEF ( 2004 ): Regjistrimi dhe braktisja e vajzave në Kosovë, Prishtinë.
- MASHT (2005): Standardet Kombëtare për Arsim dhe Aftësim në Ndërmarrësi, Prishtinë.
- MASHT (2005): Udhëzimi administrativ nr. 7/2009: Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, Prishtinë.

- MASHT (2005): Udhëzimi administrativ nr. MASHT [I] 13/2005: Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk e vijnë në mësimin e obliguar, Prishtinë.
- MASHT (2006): Plani Aksional i punësimit të të rinjve në Kosovë, 2006-2009, Prishtinë
- MASHT (2007): Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, 2007-2017, Prishtinë.
- MASHT (2008): Treguesit dhe të dhëna statistikore në arsim, 2004/05, 05/06, 06/07, Prishtinë.
- MASHT (2009): Udhëzimi administrativ nr. 18/2009: Raporti nxënës mësimit, Prishtinë.
- MASHT(2004): Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Prishtinë.
- MASHT(2006): Ligji për Arsimin Profesional në Kosovë nr. O2/L-42, Prishtinë.
- MASHT(2008): Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Prishtinë.
- MASHT(2008): Vendimi nr. 258/01-B, Datë 17.09.2008: Të gjithë nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e XII të arsimit profesional kanë të drejtë të regjistrohen në klasën XIII, Prishtinë.
- MASHT(2008): Vendimi nr. 557/02-1, datë 22.08.2008: Rritet numri i nxënësve për paralele në shkollat e mesme të larta, Prishtinë .
- MASHT(2008): Plani Kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës, 2009-2014, Prishtinë.
- MASHT dhe Danida - Zyra bashkëpunuese (2009): Hulumtim mbi interesat, opinionet dhe qëndrimet e të rinjve në zhvillimin e karrierës së tyre profesionale në bujqësi, Prishtinë.
- Fondacioni Evropian për Trajnime - ETF (2007): Inkuadrimi social i grupeve etnike përmes arsimit dhe trajnimit – elemente të praktikës së mirë, Prishtinë.
- Robert Balfanz and Nettie Legters (2004): LOCATING THE DROPOUT CRISIS, Johns Hopkins University
- Ronald G. Sultana ( 2007): Sfida e implementimit të politikave: një analizë krahasuese e reformave shkollore vetë në Shqipëri, Kosovë dhe Turqi, draft i raportit përfundimtar, Fondacioni Evropian për Trajnime - ETF.
- Faqe të internetit:
1. <http://www.masht-gov.net>
  2. <http://www.edukimi.net>

Braktisja e shkollimit në arsimin e mesëm profesional në Kosovë

Botues  
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Lektura  
Mr. Sc. Hajrije Devetaku-Gojani & Haxhere Zylfiu

Përgatitja kompjuterike: IPK

Madhësia: 6.5 tabakë shtypi  
Formati: 13.5 x 20 cm

U shtyp më 2011

Shtypshkronja

“KGT” Prishtinë

Katalogimi në botim –(CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

377.36(496.51)(048)

Braktisja e shkollimit në arsimin e mesëm profesional në Kosovë, hulumtim / Ekipi hulumtues Hajrije Devetaku – Gojani...[et al.]. – Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2011 – 105 f. ;20 cm  
Instituti Pedagogjik i Kosovës  
Prishtinë, 2011.-105 f.; 20 cm

1. Devetaku-Gojani, Hajrije  
ISBN 978-9951-01-0